

Aftësia e kufizuar në median e shkruar: Si portretizohet aftësia e kufizuar dhe personat me aftësi të kufizuara nga media e shkruar në Bosnje Herzegovinë, Mal të Zi dhe Serbi në 2006

Dokument për diskutim



**Komisioni European
Iniciativa Europiane për
Demokraci dhe të
Drejtat e Njeriut***

* Ky dokument u publikua me mbështetjen financiare të Bashkimit European. Përmbajtja e Raportit është vetëm nën përgjegjësinë e Handicap International i Europës Jug-Lindore dhe në asnjë rast nuk duhet të konsiderohet si reflektim i këndvështrimit të Bashkimit European.

NJOFTIM

Materialet e publikuara në serinë e Inicativës së Monitorimit të Aftësisë së Kufizuar nuk janë publikime zyrtare të Handicap International. Ato janë përgatitur nga Zyra Rajonale e Handicap International i Europës Juglindore si pjesë e inicativës rajonale për të ndërtuar njohuritë mbi aftësinë e kufizuar në tranzicion. Raportet dhe dokumentat prezantojnë analizat paraprake që janë qarkulluar tek vendimarrësit, me qëllim nxitjen e diskutimeve dhe debateve. Rezultatet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura në këtë raport janë tërësisht ato të autorëve dhe nuk duhet ti atribuohen në asnjë mënyrë Handicap International, donatorëve apo partnerëve të tij. Për kopje të këtij raporti, ju lutem kontaktoni Zyrën Rajonale të Handicap International për Europën Juglindore, ose vizitoni faqen në internet të Inicativës së Monitorimit të Aftësisë së Kufizuar.

© Kopjet e publikimit janë falas, por Handicap International ka të drejtën e autorit mbi publikimin, prandaj burimi duhet të përmendet.

INICIATIVA E MONITORIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

www.disabilitymonitor-see.org
editor@disabilitymonitor-see.org

ZYRA RAJONALE E HANDICAP INTERNATIONAL PËR EUROPËN JUGLINDORE

Velisava Vulovica 11
11040 Belgrade (Beograd)
Serbia Serbi
office@hi-see.org

ZYRA E HANDICAP INTERNATIONAL NË EUROPËN JUGLINDORE

Belgrade, (Beograd), office.belgrade@hi-see.org
Pristina, (Prishtinë), office.pristina@hi-see.org
Sarajevo, (Sarajevë), office.sarajevo@hi-see.org
Skopje, (Shkup), office.skopje@hi-see.org
Tirana, (Tiranë), office.tirana@hi-see.org

FALENDERIMET

Autore

Lisa Adams

Studimi

Lisa Adams, Daniela Nikolić dhe Ivana Milinčić

Kontribues

Božidar Denda

Gordana Rajkov

Goran Pavlović

Indira Spiljak

Vanja Colić

Vesna Nestorović

Mbështetja logjistike dhe teknike

Ajhan Saraqi

Bojana Bego

Fredrik Stockhaus

Nexhat Shatri

Sonja Vasić

Përkthimi

Suzana Stojković, Etleva Bisha and Merita Myftari

Dokumenti për Diskutim u realizua në sajë të mbështetjes financiare të

Iniciativës Europiane për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR)* dhe Handicap International.

* Ku dokument u publikua me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Përmbajtja e raportit është vetëm nën përgjegjësinë e Handicap International të Europës Juglindore dhe në asnjë rast nuk mund të kuptohet si reflektim i këndvështrimit të Bashkimit Europian.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje	5
Fjalori	7
I. Hyrje	8
II. Terminologjia	10
III. Burimi i Lajmeve	22
IV. Si portretizohet aftësia e kufizuar nga media e shkruar	28
V. Si portretizohen nga media e shkruar personat me aftësi të kufizuara	37
VI. Këshilla nga terreni për një pasqyrim të suksesshëm mediatik	42
Rekomandimet.....	47
Bibliografia	49
Shtojca I: Burimet për raportim të përgjegjshëm mbi aftësinë e kufizuar dhe pasqyrimin me respekt të personave me aftësi të kufizuara në median e shkruar	50
Shtojca II: Klima e përgjithshme mediatike në shtetet e vëzhguara	72

PËRMBLEDHJE

“ Personat me aftësi të kufizuara varen kryesisht nga ndihma e personave të tjerë dhe ka shumë gjëra që ata nuk mund ti bëjnë dot vetë. Veçanërisht ata 3,500 persona që jetojnë pa pjesë të caktuara të trupit të tyre”
Vecernje novosti, “ NE NUK JEMI TË PADUKSHËM” (NISMO MI NEVIDLJIVI), 22.10.06

Ky lloj përshkrimi që u bën media personave me aftësi të kufizuara si të varur nga të tjerët, të paafte dhe depersonalizuar nuk është e pazakontë në të gjithë rajonin. Nuk ka dyshim, qëndrimet përbuzës, ofendues dhe plot stereotipe përforcohen nga një gazetari e papërgjegjshme. Një media demokratike i informon dhe fuqizon të gjithë pjestarët e shoqërisë dhe rrit vlerat demokratike. Ajo bazohet mbi tolerancën dhe duhet tu paraprijë të drejtave të njeriut dhe respektit për diversitetin. Ky lloj diskriminimi në media ndihmon në përçimin e këtyre vlerave diskriminuese në shoqëri.

Ka ardhur koha që profesionistët e medias të jenë më të përgjegjshëm në raportimet e tyre. Është gjithashtu përgjegjësi e shoqërisë që të kërkojë një media më demokratike dhe pjestarët e shoqërisë civile kanë përgjegjësinë ta përçojnë mesazhin e tyre tek shtypi në një mënyrë të tillë që zëri i tyre të dëgjohet në mënyrë të saktë. Ndërkohë që advokuesit e aftësisë së kufizuar po punojnë fuqishëm për të promovuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe ti japin fund diskriminimit institucional, ky lloj portretizimi negativ i personave me aftësi të kufizuara e shkatërron në një çast punën e tyre. Shformimi nga ana e medias e aftësisë së kufizuar kontribuon dukshëm në praktikat diskriminuese dhe qëndrimet negative ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Ky studim është përpjekje për të vëzhguar tendencat kryesore në raportimin e aftësisë së kufizuar në Bosnje Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi për të zbuluar disa nga problemet kryesore në trajtimin nga ana e medias të çështjes së aftësisë së kufizuar dhe vetë personave me aftësi të kufizuara.

Konkluzion i parë kryesor është se në të tre shtetet egziston një përdorim i papërshtatshëm i terminologjisë së aftësisë së kufizuar. Në shumicën e rasteve gazetarët përdorin gjuhë të papërshtatshme dhe herë pas herë terma ofendues gjatë përshkrimit të personave me aftësi të kufizuara. Bie në sy se mungesa e plotë e konsistencës në terminologji tregon se profesionistët e medias, si edhe aktorë të tjerë të intervistuar nga shtypi janë të paqartë mbi terminologjinë e përshtatshme ose të preferuar nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara.

Së dyti, ka shumë aktorë që gazetarët u drejtohen si burime informacioni mbi aftësinë e kufizuar, përfshirë këtu elitën qeveritare, profesionistët dhe advokuesit e aftësisë së kufizuar, si edhe prindërit. Megjithatë, kur artikulli ishte mbi temën e aftësisë së kufizuar nga pikpamja e rëndësisë politike, si për shembull reforma legjislativë, elita qeveritare dhe/ose profesionistët ishin burimi kryesor i lajmit. Edhe advokuesit e aftësisë së kufizuar ishin burime të lajmit, por kryesisht në artikuj që lidhen me aktivitete të organizatave të tyre. Ajo që bie në sy në mënyrë të qartë është se gazetarët nuk shkojnë drejtpërdrejtë tek personat me aftësi të kufizuara kur raportojnë, ndërkohë që ata rrallë herë intervistohen ose citohen në artikuj dhe si rrjedhojë zëri i personave me aftësi të kufizuara është pothuajse jo prezent në shtyp.

Një tjetër gjetje e rëndësishme është se raportimi mbi aftësinë e kufizuar është, në pjesën më të madhe, i kufizuar brenda modelit mjeksor, ndërkohë që aftësia e kufizuar prezantohet si çështje e mirëqënies sociale. Ka një numër të madh artikujsh mbi përfitimet e aftësisë së kufizuar dhe mbi se sa i kushtojnë shtetit personat me aftësi të kufizuara mbi bazën e kategorisë së aftësisë së kufizuar. Përveç të qënurit depersonalizues, theksi në shumë në këta artikuj bie mbi shërbimet dhe programet e specializuara të menaxhuara nga profesionistët duke përforcuar mitin se personat me aftësi të kufizuara varen nga të tjerët dhe nuk duhet të jenë pjesë e shoqërisë.

Gjëja më shqetësuese është se personat me aftësi të kufizuara shpesh përshkruhen si “të tjerët” përmes përdorimit të stereotipeve në media. Stereotipet janë diskriminuese dhe depersonalizojnë personat me aftësi të kufizuara. Këto imazhe stigmatizuese përsëriten në media duke mundësuar vazhdimin e opinionëve negative mbi personat me aftësi të kufizuara.

Megjithatë, egzistojnë shembuj të raportimit mbi aftësinë e kufizuar që janë dukshëm ndryshe nga këto tendenca. Ka artikuj që e shohin aftësinë e kufizuar nga prespektiva e modelit social duke përdorur terminologjinë e duhur dhe larg stereotipeve. Në këto raste gazetari përdor si burim informacioni aktivistët e aftësisë së kufizuar në komunitet. Në shumë raste, shkrimet më të fuqishme janë shkruar nga advokuesit e aftësisë kufizuar që kanë punuar në mënyrë të suksesshme me profesionistët e medias për ti përçuar mesazhet e tyre në media. Këto shkrime sfidojnë stereotipet më tipike në media dhe hedhin një dritë të re mbi çështjet e aftësisë së kufizuar. Megjithatë mbetet shumë për të bërë për të mbështetur lëvizjen e aftësisë së kufizuar në punën me median për ta ndryshuar mënyrën se si përshkruhen çështjet e aftësisë së kufizuar dhe personat me aftësi të kufizuara. Ky studim do të përpiqet të ilustrojë tendencat e zakonshme në praktikën mediatike gjatë raportimit mbi aftësinë e kufizuar, në mënyrë që të lehtësojë debatin mes advokuesve të aftësisë së kufizuar dhe profesionistëve të medias në gjetjen e mënyrave të mira të bashkëpunimit për të ndryshuar pasqyrimin mediatik të aftësisë së kufizuar dhe kalimin nga portretizimet negative që stigmatizojnë personat me aftësi të kufizuara në raportime që i trajtojnë çështjet e aftësisë së kufizuar në një mënyrë pozitive.

Transmetimi është shpërndarja e sinjalit audio dhe/ose video që përhap sinalin tek audienca. Audienca mund të jetë publiku i gjerë ose një nën-audiençë relativisht e gjerë, si për shembull fëmijë ose të rinj¹.

Gazetë me Format të Madh : Gazetë e printuar në format të madh letre (afërsisht 400 X 560 mm për *The Sydney Morning Herald*). Gazetat me Format të Madh shpesh konsiderohen se kanë raportim më të thellë².

Kopja e redaktorit: Punë editoriale për të ndryshuar formatin dhe për të përgatitur tekstin për botim.

Organizatave e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK). Një term që përdoret gjerësisht për të përkufizuar organizatat e personave me aftësi të kufizuara. Karakteristika kryesore e OPAK është se drejtuesit e organizatave (në postet drejtuese të organizatës) duhet të jenë persona me aftësi të kufizuara. Plus kësaj, misioni i organizatës duhet të orientohet drejt përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara dhe promovimit të të drejtave të tyre.

Redaktor: Gazetar që redakton dhe korrekton artikujt e shkruar nga gazetarët³.

Kryeredaktor: Redaktor drejtues

Redaksional: Artikull që shpreh opinionin e redaktorit⁴

Reportazh: Një ngjarje që fokusohet në një fakt me shumë se sa tek të bërit lajm.

Titujt: Titull i një lajmi⁵

Redaktori përgjegjës: Redaktori që drejton mbledhjen dhe redaktimin e përditshëm të lajmeve⁶

Modeli social i aftësisë së kufizuar: Modeli social i aftësisë së kufizuar kërkon që personat me aftësi të kufizuara nuk janë të kufizuar për shkak të dëmtimit, por janë barrierat sociale, kulturore, ekonomike dhe mjedisore që i pengojnë ata për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë me të tjerët. Kjo paradigmë nuk e sheh më aftësinë e kufizuar si një problem mjeksor individual, por si një problem social. Ky kuadër vë në zbatim një paketë të ndryshme politikash prioritare kryesisht të fokusuar mbi heqjen e barrierave dhe duke i vënë theksin të drejtave njerëzore dhe civile.⁷

Stereotip – Imazh i përgjithshëm dhe i thjeshtëzuar ose ide e krijuar mbi një lloj të caktuar personi⁸.

Tabloid: Gazetë me format të vogël⁹.

¹ <http://en.wikipedia.org/wiki/Broadcast>

² <http://www.classcoop.sunherald.com.au/terminology.asp>

³ <http://www.classcoop.sunherald.com.au/terminology.asp>

⁴ <http://special.thetimesnews.com/nie/terms.php>

⁵ <http://special.thetimesnews.com/nie/terms.php>

⁶ <http://special.thetimesnews.com/nie/terms.php>

⁷ Bill Albert, "Briefing note: The Social Model of Disability, Human Rights and Development", (Disability KaR Research Project: 2004):3.

⁸ Cooke, Caroline; Daone, Liz; Morris, Gwilym, "Stop Press: How the Press Portrays Disabled People" (Scope: London, 2000): 42.

⁹ <http://www.classcoop.sunherald.com.au/terminology.asp>

I. HYRJE

Media luan një rol thelbësor në kulturën e sotme dhe prej saj publiku merr shumicën e informacionit që formon opinionet dhe vlerat e tij. Masmmedia, e tillë si televizioni, radio, gazetat dhe tabloidët kanë ndikim të jashtëzakonshëm në mënyrën se si publiku formon opinionet dhe këndvështrimet e veta mbi çështje të ndryshme dhe grupe njerëzish. Siç shpjegon Todd Gitlin, ekspert i medias, “Masmmedia është, së paku, një forcë sociale e rëndësishme në formimin dhe në eliminimin e kufizime të hamëndësive, qëndrimeve dhe sjelljeve të publikut- të ideologjisë, me pak fjalë.”¹⁰ Kur flasim për përfaqësimin nga media të aftësisë së kufizuar, përsëri media luan një rol të fuqishëm në ndikimin e mënyrës se si mendon publiku mbi çështjen dhe se si publiku i sheh personat me aftësi të kufizuara. Kjo është veçanërisht sinjifikante kur merret në konsideratë fakti që në shumë pjesë të botës personat me aftësi të kufizuara janë realisht të padukshëm, ndërkohë që përballen me barriera të mëdha institucionale, arkitekturore, profesionale dhe të sjelljes ndaj tyre që e bëjnë pjesëmarrjen në shoqëri dhe në jetën publike më të vështirë. Prandaj, portretizimi mediatik i aftësisë së kufizuar në median e shkruar luan një rol të rëndësishëm në formimin ose ndryshimin e opinionit publik mbi çështjet që lidhen me aftësinë e kufizuar dhe ndikojnë në prezantimin kulturor të personave me aftësi të kufizuara. Padyshim që kjo është situata në Evropën Juglindore, ku personat me aftësi të kufizuara përballen me shumë barriera të mëdha që i kufizojnë ata nga pjesëmarrja në komunitet.

Portretizimi i aftësisë së kufizuar në Evropën Juglindore nga media vuan nga stereotipi diskriminues që e kufizon aftësinë e kufizuar në raportime si çështje mjeksore ose mirëqënies sociale dhe nënpërfaqësimi i thellë nga vetë personat me aftësi të kufizuara në raportime. Lajmet që përshkruajnë personat me aftësi të kufizuara shpesh janë provokuese dhe tejet sentimentale duke i portretizuar ata si të paaftë, të pambrojtur dhe për tu mëshiruar. Nga ana tjetër, shpeshherë gazetarët përdorin një ton tejet sentimental duke i përshkruar personat me aftësi të kufizuara si të ishin të mbinatyrshëm në përpjekjen e tyre për të arritur një jetë normale, si për shembull gjetja e një pune apo shkollimi. Megjithatë, ka shenja se axhenda e të drejtave të aftësisë së kufizuar po fillon të futet në median e shkruar falë punës së advokuesve të aftësisë së kufizuar.

Ndërkohë lëvizja e aftësisë së kufizuar në Evropën Jugperëndimore po forcohet, duke u konsoliduar rreth kërkesës për mundësi të barabarta dhe pjesëmarrje të plotë, po ndodhin ndryshime edhe në mënyrën e shikimit të aftësisë së kufizuar si çështje që lidhet me të drejtat e njeriut. Shumë advokues të aftësisë së kufizuar në rajon po i kërkojnë tashmë publikut të largohet nga shikimi i aftësisë së kufizuar si çështje mjeksore dhe e mirëqënies sociale dhe ta konsiderojnë atë si çështje sociale që kërkon dhënie fund të praktikave diskriminuese dhe të ndryshimeve kulturore me qëllim që ta bëjnë shoqërinë më përfshirëse. Në rrafshin ndërkombëtar, komuniteti i personave me aftësi të kufizuara së bashku me një numër në rritje të profesionistëve dhe politikëbërësve, veçanërisht pas miratimit kohë e fundit të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, theksojnë se nuk është “gjymtimi” – kufizim funksional individual, fizik, sensorail, intelektual ose i fshheur- i cili e pengon personin për arritjen e një stili jetese të dëshirueshëm, por janë mjediset kufizuese dhe barrierat që i kufizojnë. Prandaj, “aftësi e kufizuar” i referohet një sistemi kompleks kufizimesh sociale që u imponohen personave me aftësi të kufizuara nga një shoqëri tejet diskriminuese.¹¹

Kjo zhvendosje e paradigmës së aftësisë së kufizuar që njihet si modeli social i aftësisë së kufizuar rrezikohet megjithatë nga prezantimi diskriminues i aftësisë së kufizuar në median e shkruar.

Ky studim synon të japë një vështrim të përgjithshëm se si aftësia e kufizuar dhe personat me aftësi të kufizuara prezantohen në median e shkruar në Bosnje Hercegovinë (BH), Mal të Zi dhe Serbi në 2006 dhe fillimin e 2007. Ky studim u ndërmorr duke analizuar përmbajtjen e medias së shkruar kombëtare. Projekti nuk pretendon të realizojë një vlerësim përfundimtar të rolit që luan media në portretizimin e aftësisë së kufizuar. Në vend të saj, ai synon të fotografojë rrugët në të cilat pasqyrohet aftësia e kufizuar për një peiudhë të kufizuar, me qëllim që

¹⁰ Siç citohet në Beth Hellar, “News Coverage of Disability Issues: Final Report for The Centre for an Accessible Society” nga: Todd Gitlin, *The Whole World is Watching*. (Berkeley, Ca.: University of California Press, 1980): 9.

¹¹ Colin Barnes, “Disabling Imagery and the Media: An Exploration of the Principles for Media Representations of Disabled People” for the British Council of Disabled People (Rynborn Publishing: Halifax, 1992): 2.

të kuptohen më mirë tendencat në praktikat aktuale mediatike dhe të ilustrojë stereotipet që përsëriten në media gjatë prezantimit të personave me aftësi të kufizuara. Ky dokument do të japë gjithashtu edhe shembuj të praktikave të mira që tregojnë shenja të ndryshimit nga portretizimet standarte të aftësisë së kufizuar.

Objektivi i studimit

Dokumenti synon të kuptojë atë që është prezantuar në median e shkruar mbi aftësinë e kufizuar, llojin e gjuhës së përdorur lidhur me aftësinë e kufizuar, personat që sigurojnë informacionin mbi çështjet që diskutohen. Përveç kësaj, studimi përpiqet të bëjë vlerësimin e tipeve të modeleve të aftësisë së kufizuar, ose paradigmave të prezantuara nga media për të kuptuar më mirë tendencat që egzistojnë në mbulimin mediatik të aftësisë së kufizuar. Ky studim është i ndarë në pesë seksione në përpjekje për tu dhënë përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

Terminologjia: Çfarë terminologjie përdoret nga media e shkruar dhe cilat janë problemet me praktikat aktuale në lidhje me terminologjinë?

Burimet e lajmit: Kush është burimi kryesor i lajmeve kur flasim për çështjet e aftësisë së kufizuar: qeveria dhe elita të tjera, profesionistët, personat me aftësi të kufizuara ose organizatat e tyre përfaqësuese?

Si konturohen çështjet e aftësisë së kufizuar nga media e shkruar: Cilat çështje asociohen nga media e shkruar me aftësinë e kufizuar dhe cilat janë fushat kryesore që sigurojnë mbulim nga media e shkruar kur bëhet fjalë për aftësinë e kufizuar?

Cilat modele të aftësisë së kufizuar pasqyrohen në median e shkruar: A shkruajnë gazetarët mbi aftësinë e kufizuar brenda një paradigme specifike dhe nëse po, cilat janë modelet më të zakonshme?

Si portretizohen nga media e shkruar personat me aftësi të kufizuara dhe cilët janë stereotipet mbizotëruese: A ndikon media mbi stereotipet dhe nëse po, si ?

Metodologjia e studimit

Ky dokument bazohet mbi një studim të pasqyrave të medias në Bosnjë dhe Hercegovinë, Malin e Zi dhe Serbi për vitin 2006. Për Bosnjë Hercegovinën dhe Sërbinë patëm mundësi të përdorim një databazë të arkivave të shtypit të shkruar për të kërkuar të gjitha pasqyrat mediatike në lidhje me aftësinë e kufizuar gjatë vitit 2006. Për Malin e Zi, ne ndoqëm median nëpërmjet tre të përditshmeve kryesore për periudhën mars 2006 – janar 2007 duke mbledhur lajme për ti analizuar. Në Kosovë u kufizuam në një numër të vogël lajmesh nga dhjetori 2006 deri në mars 2007, të cilat nuk na dhanë të dhëna të mjaftueshme për realizimin e analizës. Për më tepër, artikujt e mbledhur përbëheshin nga një numër i madh ekstraktesh të marra nga një insert gazete mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe nuk pasqyronin mbulimin e përgjithshëm nga ana e shtypit të shkruar të aftësisë së kufizuar në Kosovë. Prandaj, nuk ishim në gjendje të identifikonim tendenca apo modele nga nja numër kaq i vogël dhe i kufizuar të dhënash. Përfundimisht, në Kosovë apo në Malin e Zi nuk kishte një databazë elektronike të artikujve të shtypit të shkruar gjatë kohës që u zhvillua ky studim.

Studimi ka disa kufizime. Së pari, për secilin vend, ne përdorëm mënyra të ndryshme të mbledhjes së burimeve mediatike në varësi të pasjes së aksesit ndaj shërbimeve të arkivave të shtypit. Për më tepër, çdo shërbim arkivi ishte i ndryshëm për sa i përket kërkimit të artikujve, gjë që e bëri të pamundur bërjen e krahasimeve sasiore midis vendeve (për shembull, numri i artikujve lidhur me aftësinë e kufizuar në një vend përkundrejt një tjetri). Së dyti, ky studim nuk mori në konsideratë mbulimin nga ana e shtypit lokal, por vetëm nga ai kombëtar. Së treti, artikujt u analizuan pasi u përkthyen në anglisht, që do të thotë se padyshim disa nuanca dhe tone të përdorura kishin humbur.

Metodologjia për mbledhjen e artikujve të mediave në BH

Baza e të Dhënave të përdorura për Bosnje Hercegovinën është INFOBIRO, një arkivë e medias së shkruar dhe tema të tjera që ka lidhje me çështjet, që vepron në Qendrën Mediatike të Sarajevës. Baza e të Dhënave përmban artikuj nga media të shkruara ditore, javore dhe periodike përfshirë: Dnevni avaz, Oslobođenje, Dnevni list, Nezavisne novine, Dani, Slobodna Bosna, Start, Novi Reporter, Ljiljan, Banke BH, ZIPS, Poslovne

novine, Business info, Sarajevske Sveske, Naši Dani, Agjensia e Lajmeve ONASA (Shërbimi i Përgjithshëm dhe Ekonomik) nga 2004 në vazhdim. Rreth 70% e përmbajtjes së këtyre mediave të shkruara përfshihen në arkivën dixhitale mbi baza ditore. Baza e të dhënave ofron artikuj në format të skanuar në të njëjtën mënyrë siç shfaqen në faqen e printuar. Përmban rreth 100,000 artikuj për 2006. Vëzhgimi i medias së shkruar nga HI mbulon periudhën nga 1 Janari deri në 31 Dhjetor 2006. Numri total i pjesëve të shkëputura nga media e shkruar në bazën e të dhënave INFOBIRO për 2006 është afërsisht 100,000, ndërsa numri total i artikujve mbi aftësinë e kufizuar është rreth 1,097.

Metodologjia për mbledhjen e artikujve të mediave në Serbi

Baza e të Dhënave në Serbi është EBART, arkiva e dokumentimit të medias, e cila mbledh dhe ruan artikuj të medias që prej 2003 (media elektronike monitorohet gjithashtu që prej vitit 2005). Mediat më prestigjioze elektronike dhe të shtypit të shkruar në Serbi janë rregjistruar në EBART, e cila ofron gjithashtu trainime për gazetarët mbi mënyrën se të përdorin bazën elektronike të të dhënave. Duke mbledhur artikuj nga 15 mediat kryesore ditore dhe javore, EBART ka tashmë një total prej 800 000 artikujsh, rreth 190 000 gjatë vitit 2006. baza e të dhënave është e thjeshtë për tu studiuar dhe është e mundshme që të gjenden kriteret për përzgjedhjen e artikujve. Gjithashtu gjenden disa kategori të gatshme të parapërcaktuara, sipas çështjes, institucionit, partisë politike, njësisë gjeografike, personit, etj. Fakti që aftësia e kufizuar është përfshirë si një prej çështjeve të përgjithshme që prej vitit 2007, flet gjithashtu për nivelin e ndërgjegjësimit mbi aftësinë e kufizuar.

Metodologjia për mbledhjen e artikujve të mediave në Malin e Zi

Në Malin e Zi, media e shkruar e monitoruar për qëllim të këtij studimi ishte ajo e tre mediave të shkruara të përditshme më të mëdha, Dan, Vijesti dhe Pobjeda, për periudhën mars 2006 deri në janar 2007. Numri total i artikujve të mbledhur ishte 89 të cilat u mbledhën me metoda tradicionale të mbledhjes së artikujve të medias. Gazetat u analizuan për çdo artikull që kishte lidhje me aftësinë e kufizuar dhe artikujt u grupuan në një material për tu analizuar.

II. TERMINOLOGJIA

Përse është e rëndësishme terminologjia?

Gjuha e përdorur në media luan një rol thelbësor në formimin e qëndrimit social mbi personat me aftësi të kufizuara. Terminologjia e përdorur për të përshkruar personat me aftësi të kufizuar është integrale, jo vetëm për të formuar qëndrimin social por edhe për të krijuar dhe përforcuar stereotipet. Konkluzioni kryesor i studimit në lidhje me terminologjinë është fakti se ka një mungesë totale të konsistencës së termave të përdorur nga gazetarët. Shumë shpesh një term përdoret në kuptime të ndryshme duke iu referuar si fëmijëve me nevoja të veçanta, nga një anë, vetë fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale dhe nga ana tjetër një grupi të gjerë të personave me aftësi të kufizuara. Termi “persona me aftësi të kufizuara”, që nënkupton personat me të gjitha tipet e aftësisë së kufizuar, shpesh përdoret vetëm për personat vetëm me dëmtime fizike. Ndërkohë, në raste të tjera ky term përdoret saktë duke iu referuar një grupi personash të ndryshëm. Akoma më konfuzues është përorimi i termave të ndryshëm brënda të njëjtit artikull. Nuk është e pazakontë të gjejmë të paktën pesë trema të ndryshme të përdorura në të njëjtin artikull për të përshkruar personat me aftësi të kufizura, duke i dërguar mesazhe çoroditëse publikut për shkak të terminologjisë.

Ka ende një numër të madh termash fyes të përdorura nga ana e gazetarëve pavarësisht nga shtimi i përdorimit të termit ‘persona me aftësi të kufizuara’, i cili mbështetet gjerësisht dhe përdoret nga ana e lëvizies së aftësisë së kufizuar në rajon. Termat tepër fyes, të tillë si antikap, çalaman, i vonuar, dhe rakitik dhe emërtime të tjera denigruese arrijnë të penetrojnë në median e shkruar. Ekziston gjithashtu një përdorim i gjerë i termave “ i

vonuar mendor” dhe “njerëz me zhvillim të pamjaftueshëm mendor”. Ka gjithashtu një tenencë në shtetet e studiuara për ti quajtur këta persona “i paafiti”, “i verbri”, “shurdhi” dhe për të përdorur terminologji që ka lidhje me dëmtimin, të tilla si “paraplegjik” dhe “personat me distrofi muskulare”. Përdorimi i këtyre mbiemrave në vend të emrave në këtë mënyrë është jashtë kohe dhe ka kohë që konsiderohet fyese në lidhje me personat e grupeve të ndryshme etnike (nuk është e përshtatshme për shembull, të përdoret termi “të zinjët”).¹² Për fat të keq, gjuha fyese dhe pezhorative duket se është normë, ndërkohë që atë e gjen rëndom në artikujt që kanë lidhje me aftësinë e kufizuar. Një përdorim i tillë i zakonshëm i terminologjisë fyese mund të jetë një tregues se publiku nuk është aspak i ndërgjegjësuar mbi faktin se një gjuhë e tillë është fyese.

Sipas Michael Nally, pedagog në departamentin e gazetarisë të Universitetit të Central Lancashire, gazetari duhet të jetë i ndërgjegjshëm se përdorimi i gjuhës diskriminuese ose të rëndë mund të ofendojë disa nga lexuesit, dëgjuesit dhe shkuesit e tij: “Gazetari e ka për detyrë të përpiqet të shmangë fjalët dhe fjalitë që mund të ofendojnë personat me aftësi të kufizuara”¹³. Kodet e sjelljes mund të nxisin gazetarët të përdorin terma jodenigrues ose fyese. Për shembull, në nenin 10 të kodit të praktikave të Unionit Kombëtar të Gazetarëve Britanikë, i ngjashëm me kodin e Këshillit të Medias së Shkruar për Bosnjën, thuhet: “gazetari duhet të përmendë moshën, gjininë, racën, ngjyrën, besimin, ilegjitimitetin, aftësinë e kufizuar, statusin martesor ose orientimin seksual vetëm nëse informacioni është padiskutim i nevojshëm. Gazetari nuk duhet as të inicojë e as të përgatisë material që nxit diskriminimin, përqeshjen, paragjykimin ose urrjtjen mbi bazën e cdonjërit prej elementëve të lartpërmendur. Neni 13 i Komisionit të Ankesave të Medias së Shkruar thotë se:” 1) media e shkruar duhet të shmangë referencat paragjykesë ose pezhorative ndaj racës, ngjyrës, fesë, gjinisë ose orientimit seksual të një personi apo ndaj çdo sëmundje fizike ose mendore ose aftësie të kufizuar. 2) duhet të shmangë publikumin e detajeve të racës, ngjyrës, besimit fetar, orientimit seksual, sëmundjes fizike ose mendore ose aftësisë së kufizuar, me përjashtim të rasteve kur kjo është e domosdoshme për lajmin.”¹⁴

Megjithatë, edhe pse përdoret kodi kundër diskriminimit në MB, terminologjia diskriminuese penetron në median e shkruar dhe madje edhe në media me profil të lartë kombëtar të tilla si “the Guardian, the Times, the Economist dhe BBC”.¹⁵

Disa gazetarë Anglezë u pyetën përse ndodhte kështu dhe ja se çfarë thanë ata:

- Gjuha e papërshtatshme dhe titujt tej emotivë vazhdojnë të përdoren në lajmet mbi personat me aftësi të kufizuara pasi kjo ka qenë formula për një kohë shumë të gjatë (Jackie Logue, gazetar dhe redaktor).
- Ka mungesë të mëdha njohurish mbi aftësinë e kufizuar si nga profesionsitët e medias ashtu dhe nga shoqëria në përgjithësi, pasi ata nuk e shonin një person me aftësi të kufizuara në rradhë të parë si një person që i ka ndodhur të ketë një aftësi të kufizuar (Jackie Logue, gazetar dhe redaktor).¹⁶
- Gazetarët janë trainuar për të përdorur gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme lehtësisht duke kopjuar kështu një term të tillë si “gjysëm i verbër” më shpejt se sa fjalia e vështirë ‘i gjymtuar vizualisht’ (Michael Nally, gazetar dhe pedagog).¹⁷

Megjithatë, gazetarët kanë detyrë të vështirë duke patur parasysh faktin se shumë persona të intervistuar përdorin forma të ndryshme të terminologjisë duke krijuar një mozaik fjalësh që mund të konfuzojnë përfaqësuesit e medias. Profesionsitët që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar, prindërit, përfaqësuesit qeveritarë dhe madje edhe personat me aftësi të kufizuara përdorin forma të ndryshme të terminologjisë përfshirë termat stigmatizues dhe kjo e bën të vështirë punën e gazetarit që duhet të dijë se cili është termi i përshtatshëm. Mund të jetë vështirë gjithashtu për një gazetar të gjejë terminologjinë e duhur që në të njëjtën kohë është lehtësisht e kuptueshme për publikun. Gazetarët e trainuar si dhe drejtuesit e gazetarëve duhet të ndërgjegjësohen mbi çështjet e aftësisë së kufizuar dhe redaktorët dhe zëvendës-redaktorët duhet gjithashtu të

¹² Cooke, Caroline; Daone, Liz; Morris, Gëilym, “Stop Press: How the Press Portrays Disabled People” (Scope: London, 2000): 3.

¹³ Cooke, Caroline; Daone, Liz; Morris, Gwilym, ibid: 24-26.

¹⁴ Ibid: 26.

¹⁵ Kjo sipas studimit të kryer nga studentët e gazetarisë të Universitetit Central Lancashire.

¹⁶ Jackie Logue, reporter dhe redaktor, siç citohet në: Cooke, Caroline; Daone, Liz; Morris, Gwilym, ibid: 24.

¹⁷ Cooke, Caroline; Daone, Liz; Morris, Gwilym, ibid: 25.

trainohen për të garantuar një kuptim të mirë të aftësisë së kufizuar. Përdorimi i gjuhës së saktë në media do të ndihmojë në përhapjen e mesazhit tek publiku në termat e duhura.

Në përgjithësi, termi më i përdorur në median e shkruar është “invalidi”

Termi “invalidi” (në gjuhën e Bosnje Hercegovinës), emër, përdoret në shumë vende të rajonit. Advokues të shumtë të aftësisë së kufizuar në rajon pranojnë se ky emër përkthen siç duhet nga anglishtja fjalën “the disabled”. Ndërkohë që disa media përdorin termin neutral të tillë si “personat me aftësi të kufizuara”, ka ende një numër të madh gazetarësh që përdorin termat depersonalizes, të tillë si “invalid”, ose “antikap” të cilat shumë i konsiderojnë, fyes pasi këto terma, siç shpjegon Colin Barnes, “u rrëmbejnë anën humane personave me aftësi të kufizuara, e për rrjedhojë i kthejnë ata në objekte.”¹⁸ Në të gjithë rajonin ky term gjendet shpesh me germa të mëdha në çdo titull shkrimi. Për rrjedhojë, si gazetatat e përditëshme dhe ato javore, si gazetatat cilësore dhe tabloidët, duket se preferojnë gjithë e paaftësisë, “invalidi” në titujt dhe nëntitujt e shkrimeve të tyre, dhe padyshim që kjo ndikon shumë në qëndrimet e publikut. Megjithatë, termi “personat me aftësi të kufizuara” që është terminologjia e preferuar e shumicës të lëvizjes së aftësisë së kufizuar, po fillon të përdoret më gjerë në median e shkruar përveç titujve ku shfaqet vetëm në raste të ralla¹⁹.

Termi “the disabled” (invalidi) në Serbisht dhe gjuhën boshnjake është në njëfarë mënyre problematik kur përpiqesh ta përkthesh në anglisht duke patur parasysh që rrënjja e fjalës mungon. Ja çfarë thotë Gordana Rajkov e Qendrës për Jetesë të Pavarur të Serbisë në lidhje me të: “Termi “invalid” u shfaq në gjuhën tonë (Serbisht) pas Luftës I Botërore dhe u përdor në masën dërmuese për veteranët e luftës me aftësi të kufizuara [ratni vojni invalidi]. Që prej atëherë do të thotë saktësisht person me dëmtime, që për rrjedhojë nënkupton jo i barabartë me të tjerët, por gjithashtu nënkuptonte një lloj dinjiteti pasi i referohej personave që kishin luftuar e sakrifikuar për vendin e tyre. Ai term persistoi në gjuhë që atëherë (...) dhe kurrë nuk pati kuptim negativ. S’ka nevojë të themi se kurrë nuk u përkthye në gjuhën tonë, kurrë nuk u përdor në kuptimin e tij të përkthyer, pothuajse gjithmonë në origjinalin anglisht (kështu ndodh shpesh). Kjo është arsyeja sipas mendimit tim se rregullat që zbatohen në gjuhët e tjera, si në anglisht, nuk mund të jenë tërësisht njësoj në gjuhë të tjera, sikurse termi “invalid” ka saktësisht të njëjtin konotacion si dhe termi “the disabled” në anglisht, edhe pse fjalët nuk janë përkthyer drejtpërdrejt”²⁰.

Përdorimi i terminologjisë në tituj

Për 2006, **“the disabled” (invalidi) është terminologjia më e përdorur e aftësisë së kufizuar e përdorur në kryetitujt e gazetave** në Bosnje Hercegovinë, Serbi dhe Mal të Zi. Në shumë raste, edhe me “invalid” në kryetitujt, terminologjia në shkrim është mikse dhe mund të përdoret termi “invalid” bashkë me një numër termash.

Duke vëzhguar median e shkruar në Bosnje, në artikullin e titulluar “Invalidët në periferi të shoqërisë” (Invalidi na margini društva) në Dnevni Avaz më 08.10.06, teksti i artikullit përdor termat: invalidët, invalidët dhe tç verbërit, ndërsa “invalidët” përdoret në titull. Ose në “Kompanitë private kundër punësimit të invalidëve” (Domaće tvrtke protiv zapošljavanja invalida) më Dnevni List, 16.06.06, gazetari përdor: invalidë, persona invalidë dhe persona me aftësi të kufizuara në vend të njëri tjetrit. Në një artikull tjetër me titull “Miting proteste: a kanë invalidët të drejtë për jetesë normale?” në gazetën Oslobođenje të datës 09.06.06, edhe pse termi “invalidë” është përdorur në titull, në brëndësi të artikullit, termat: invalid i plotë, invalid lufte, persona 100% invalidë dhe persona me vështirësi në lëvizje janë përdorur të gjithë.

Përveç titujve në të cilët shpesh preferohet të përdoret termi “invalidë”, **vetë titujt kanë natyrë shumë provokative**. Disa shembuj titujsh ku përdoret termi “invalidë” vijojnë më poshtë:

¹⁸ Colin Barnes, “Disabling Imagery and the Media: An Exploration of the Principles for Media Representation of Disabled People”, (Halifax: The British Council of Disabled People and Rynburn Publishing) 1992: 8.

¹⁹ Barnes, “Disabling Imagery and the Media: An Exploration of the Principles for Media Representation of Disabled People”, (Halifax: The British Council of Disabled People and Rynburn Publishing) 1992: 10.

²⁰ Gordana Rajkov, Centre for Independent Living, Some thoughts about disability language, 2003, Belgrade.

- “Invalidët përlejsh fundet për fëmijët”; (*Invalidi pojeli djeciji doplatak*), *Oslobođenje*, 22.07.06
- “Nuk ka vend për invalidët”; (*Nema mjesta za invalide*), *Dnevni List*, 01.06.06
- “Mijëra invalidë në nevojë për ndihmë”; (*Hiljadama Invalida Neophodna Pomoc*), *Nezavisne Novine*, 03.12.06
- “Të verbrit përplasen pas shtyllave të reklamave”; (*Slijepi udaraju u zeljezo od panoa*), *Nezavisne Novine*, 02.10.06
- “Invalidët: Shteti na ka plagosur më rëndë se lufta”; (*Država nas ranjava gore od rata*), *Dnevni List*, 30.06.06
- “Miting proteste: A kanë invalidët të drejtë për jetesë normale? (Protestni skup, imaju li invalidi pravo na normalan zivot), *Oslobođenje* 09.06.06
- “Invalidët të diskriminuar në të gjitha nivelet”; (*Invalidi diskriminansi na svim novoima*), *Oslobodjenje*, 30.06.06
- “U ngopëm me përfitime: Protestë nga ana e invalidëve veteranë të luftës përpara ndërtesës qeveritare në Tuzla; Qeveria po i lë pas dore invalidët”; (*Dosta nam je profitera: Protest RVI pred zgradom Vlade Tuzlanskog kantona; Vlada ignorise invalide*), *Oslobođenje*, 28.09.06
- “Ushtarët e harruar të Travnikut: Nuk mbahet fryma gjallë me llafë”; (*Zaboravljeni travnicki vojnici: Ne zivi se od rijeci*), *Oslobođenje*, 29.09.06
- “Një veteran invalid i luftës shkatërron një ndërtesë në Sapna (Ratni vojni invalid demolirao zgradu Općine Sapna), *Oslobođenje*, 20.07.06

Megjithatë, në përgjithësi, pjesa më e madhe e artikujve përdor termin “invalid” dhe është e qartë se ky është dhe termi dominues në median e shkruar. Termi tjetër i përdorur mjaft shpesh në shtypin e Bosnjë dhe Hercegovinës është “vetëranë Invalidë lufte”, i ndjekur nga “civilë viktima të luftës” dhe “invalidë jo-lufte”. Këto janë specifike vetëm për Bosnjë Hercegovinë pasi debati i vazhdueshëm mbi statusin e përfitimeve për invaliditet për vetëranët invalidë të luftës dhe viktimat civile të luftës është një çështje e rëndësishme politike. Numri i invalidëve vetëranë të luftës u rrit ndjeshëm në Bosnjë Hercegovinë pas luftës dhe rrjedhimisht u rrit edhe numri i përfituesve të pensioneve të vetëranëve invalidë të luftës. Përveç se kjo u bë një barrë e rëndë financiare për shtetin, këtu qëndron edhe një çështje tjetër e nxehtë, pasi egziston një ndryshim shumë i madh midis përfitimeve që marrin invalidët vetëranë të luftës dhe atyre që marrin të gjithë personat e tjerë më aftësi të kufizuara. Çështja e statusit të invalidit në lidhje me përfitimet nga invaliditeti është një çështje politike që po debatohet aktualisht në Bosnjë Hercegovinë dhe për këtë qëllim ka marrë edhe një nivel të lartë interesimi nga ana e medias së shkruar.

Në Serbi egziston një situatë e ngjashme ndërkohë që termi ‘invalid’ dominon titujt e gazetave, por në brendësi të artikujve egziston një përzjerje inkonsistente e terminologjisë:

- “Diskutime mbi konventën e ardhshme: Beogradi organizator i takimeve të aftësisë së kufizuar”; (*Razgovor o Budućoj Konvenciji: Beograd domačin skupa o invalidima*), *Politika*, 21.03.2006
- “Panair punësimi për invalidët” (*Sajam zaposljavanja invalida*), *Danas* 21.10.06
- “Edhe invalidëve u pëlqen sporti” (*I invalidi vole atletiku*), *Blic* 27.05.06
- “Punësim dhe jo mëshirë: Si ti zgjidhim problemet jetësore të invalidëve” (*Zaposlenje, a ne milostinja: Kako rešiti životni problem invalida*), *Politika*, 21.10.2006
- “Tre takime mbi problemet e invalidëve” (*Tri skupa o problemima invalida*), *Politika*, 02.03.2006

Ashtu si në Bosnjë Hercegovinë shpesh herë **titujt janë provokativë** në natyrë:

- “Handikapatët në parlament?” (*Hendikepirani u Parlamentu?*), *Blic*, 03.12.06
- “Fëmijë të vetmuar në jashtë vëmendjes” (*Usamljena deca: Na sporednom koloseku*), *Politika*, 16.10.2006
- “Jetë në kufirin e mbijetesës: Tryezë e rumbullakët në Parlamentin e Serbisë” (*Život na ivici egzistencije: Okrugli sto u Narodnoj Skupštini Srbije*), *Politika*, 18.10.2006
- “Edhe invalidëve u pëlqen sporti” (*I invalidi vole atletiku*), *Blic* 17.05.06

Megjithatë, egziston një përdorim më i gjerë i termit “persona me aftësi të kufizuara” (osobe sa invaliditetom) në shtypin e shkruar serb, madje edhe nëpër tituj, veçanërisht në gazetën Politika. Për shembull, “Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara” (Zaštita osoba sa invaliditetom) Politika, 05.01.2006, gjatë gjithë artikullit përdoret termi persona me aftësi të kufizuara. Në mënyrë të ngjashme në artikullin “Nxitje për jetesë të pavarur: Pozita e personave me aftësi të kufizuara (Podstrek za samostalni život: Položaj osoba sa invaliditetom) në Politika më 11.10.2006, si në titull edhe në artikull përdoret termi “persona me aftësi të kufizuara”. Artikulli, “Bizneset kundër paragjyqimeve” (Firmom protiv predrasuda), Politika 18.01.2007, është një shembull tjetër i përdorimit të terminologjisë së duhur. Në mënyrë të ngjashme artikulli “Në pritje të 20 firmave: finalizimi i konventës së Kombeve të Bashkuara për personat me aftësi të kufizuara” (Čekajući 20 potpisa: Završena Konvencija UN o Pravima Osoba sa Invaliditetom), Politika, 18.09.2006 është konsistent në përdorimin e termit persona me aftësi të kufizuara në të gjithë artikullin.

Në vijim disa shembuj të **artikujve të botuar në Politika ku përdoret termi “persona me aftësi të kufizuara”**:

- “E drejtë e paarritshme: Konferencë e Personave me aftësi të kufizuara (Nepristupačno pravo: Konferencija osoba sa invaliditetom), Politika, 23.02.2006
- “Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara” (Zaštita osoba sa invaliditetom), Politika, 05.01.2006
- “Nxitje për jetesë të pavarur: Pozicioni i personave me aftësi të kufizuara” (Podstrek za samostalni život: Položaj osoba sa invaliditetom), Politika, 11.10.2006
- “Kontrollet mjekësore për personat me aftësi të kufizuara: Qendra Shëndetësore ‘Dr Milutin Ivković’”(Pregledi osoba sa hendikepom: Dom Zdravlja Dr Milutin Ivković), Politika, 05.12.2006
- “Sirenat e alarmit: personat me aftësi të kufizuara në statistika” (Zvono za uzbunu: Osobe sa invaliditetom u statistici), Politika, 06.04.2006

Vijueshmëria e terminologjisë

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, në përgjithësi, një nga problemet më të mëdha në shtypin e shkruar është **mungesa e vijueshmërisë së termave** dhe në një artikull mund të gjenden 5 ose 6 terma të ndryshëm të përdorur për të përshkruar personat me aftësi të kufizuara. Praktikë e njohur është që brenda të njëjtit artikull përdoren lloje të ndryshme termash që demonstron se nuk është e qartë se cili term të përdoret. Përveç të qenit jokonsistentë, përdoren shpesh dhe terma tepër ofendues që përfshijnë: ‘persona të vonuar mendorë’, ‘persona me zhvillim të pamjaftueshëm mendor’, ‘shurdhë’, ‘fëmijë me shqetësime psiko-fizike’ dhe ‘antikapë mendorë’.

Në një artikull të Dnevni Avaz, 06.05.06, me titull “Punë në vend të bamirësisë” (Posao umjesto milostinje), në një shkrim redaksional të shkurtër prej 300 fjalësh, përdoren termat: invalidë, persona invalidë, persona me antikap fizik dhe mendor dhe qytetarë me kufizime fizike dhe mendore, të gjitha brenda të njëjtit artikull. Në një artikull tjetër me titull “Nuk ka vend për invalidët” botuar në Dnevni List, 01.06.06, (Nema mjesta za invalide), përdoret një numër il madh termash të ndryshëm që përfshijnë: persona më vështirësi lëvizje, invalidë lufte dhe civilë, invalidë veteranë lufte, invalidë në karrike me rrota, të gjymtuar, të tjerë invalidë me vështirësi në lëvizje, dhe së fundi, invalidët. Në artikullin “Qendra shëndetësore për të moshuarit, që strehon 80 persona, në mëshirë të fatit” (Oronula zgrada prijedorske Gerijatrije utočište za 80 lica Zaboravljeni od svih) botuar në Nezavisne Novine, 05/12/2006, termat, i gjymtuar, invalid, persona që nuk lëvizin, persona që nuk lëvizin plotësisht, të gjitha përdoren nga ana e gazetarit. Në një rast tjetër, termat: invalid, fëmijë me shqetësime në zhvillimin e tyre psikik dhe fizik, civilë invalidë të luftës, invalidë jo të luftës, vetëranë invalidë lufte, përdoren të gjitha brenda të njëjtit artikull. [“Invalidët përlajnë fondet për fëmijët”; (Invalidi pojeli djeciji doplatak), Oslobođenje, 22.07.06]. Në artikullin, “Miting proteste: A kanë invalidët të drejtë për jetesë normale?” (Protestni skup, imaju li invalidi pravo na normalan život?) Oslobođenje 09.06.06, në brendësi të artikullit gazetari përdor termat në vijim: invalidë të plotë, invalidë veteranë lufte, persona 100% invalidë dhe persona me vështirësi në lëvizje.

Megjithatë, pavarësisht përdorimit të shpeshtë të terminologjisë ofenduesë në shtypin boshnjak, **ka shembuj nëpër artikujt e botuar mbi veprimtaritë e OPAK ku gazetarët përdorin terma më të pranueshëm, si për shëmbull ‘persona invalidë’, si për shëmbull në artikullin, “Shoqata e të Amputuarve në fushatë për të drejtat e personave invalidë (Udruzenje amputiraca (UDAS) kampanja za prava osoba s invaliditetom) në Nezavisne**

Novine, 30.05.06. Në mënyrë të ngjashme në artikullin, "Përmbushja e të drejtave dhe parandalimi i diskriminimit" (Ostvarivanje prava i sprecavanje diskriminacije) në Oslobođenje, 31.10.06, mbi një program trainimi të OPAK-ve lokalë, në të gjithë tekstin përdoret termi, persona invalidë. Megjithatë, edhe në rastet e mbulimit të veprimtarive apo çështjeve që lidhen me OPAK, përsëri egziston një shumëllojshmëri termash në përdorim. Për shembull, në një artikull mbi një tryezë të rrumbullakët për themelimin e këshillit kombëtar të aftësisë së kufizuar, "Konferenca inicuese u zhvillua me qëllim themelimin e këshillit kombëtar për personat invalidë në Bosnjë Hercegovinë: diskriminimi i invalidëve ende vazhdon (Održana inicijalna konferencija s ciljem uspostave državnog vijeća za osobe sa invaliditetom U BiH i dalje prisutna diskriminacija invalida), termat: invalidë, persona invalidë, persona me vonim mendor dhe persona me zhvillim të pamjaftueshëm mendor ende përdoren në këtë artikull. Në mënyrë të ngjashme, në artikullin, " Pak Përkujdesje për të verbrit: Nesër është dita ndërkombëtare e Bastunit të Bardhë" (Malo brige za slijepe: Sutra Medjunarodni dan bijelog stapa), Oslobođenje, 14.10.06, të verbrit, invalidët dhe antikapët përdoren nga ana e gazetarit. Edhe në artikullin mbi një program të një OPAK-u për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, pavarësisht se zëdhënësi i shoqërisë civile në mënyrë të vazhdueshme përdorte gjatë intervistës termin "persona me aftësi të kufizuara", gazetari përsëri përdorte termin "invalidë" gjatë gjithë tekstit "Punësim për invalidët: Qendrat për ritrainim" (Zapošljavanje invalida: Centri za prekvalifikaciju) në Oslobođenje 06.10.06. Është e qartë nga analiza se advokuesit e aftësisë së kufizuar duhet të punojnë shumë për të përçarur mesazhin e tyre në media për përdorimin e terminologjisë së duhur. Është e qartë se vetë komuniteti i personave me aftësi të kufizuara nuk është i bashkuar për përdorimin e një terminologjie të preferuar pasi vetë ata përdorin një shumëllojshmëri termash që variojnë nga ofendues në autoritarë. Megjithatë nuk është e nevojshme për tu unifikuar rreth një termi të preferuar që mund të përdoret në mënyrë të vazhdueshme nga lobuesit e aftësisë së kufizuar me qëllim parandalimin e konfuzionit më të madh nga ana e merdias. Nga ana tjetër, shtypi i shkruar ka nevojë të zhvillojë një komunikim më të mirë me shoqërinë civile për të siguruar përdorimin e gjuhës së duhur mbi çështjet që lidhen me aftësinë e kufizuar.

Në shtypin serb egziston një situatë e ngjashme ku shumë terma të ndryshëm përdoren brënda të njëjtit artikull shpeshherë duke përdorur edhe terma ofendues e madje edhe të vjetëruar. Në artikullin, 'Viti i mundësive të barabarta: Parlamenti i Serbisë mbi ndalimin e diskriminimit të invalidëve' (Godina jednakih mogućnosti: Skupština Srbije o zabrani diskriminacije invalida), Politika, 04.04.2006, termat: antikapë, dëmtime fizike dhe psikologjike, persona me dëmtime, persona invalidë dhe invalidë përdoren të gjitha brënda të njëjtit tekst. Në artikullin, "Heqja e barrierave rrugore për invalidët" (Uklanjanje ulicnih barijera za invalide), Danas, 04.12.06, gazetari përdor dy lloje të ndryshme terminologjie brënda të njëjtës fjali: "Ai e miraton vendimin nga ana e shtetit për shtimin e pagesës së *invaliditetit* deri në 70% të pagës mesatare në Serbi, si edhe u lejon *personave invalidë* të importojnë makina të përjashtuar nga pagesa e taksës doganore. Edhe në artikullin mbi punësimin, "Punësim i barabartë për invalidët" (Sajam zaposljavanja invalida) Danas, 21.10.06, gazetari përdor herë termin "invalid" dhe herë termin "personat me aftësi të kufizuara". Në artikullin, "Jetë në kufij të egzistencës: Një tryezë diskutimi në parlamentin Serb" (Život na ivici egzistencije: Okrugli sto u Narodnoj Skupštini Srbije), Politika, 18.10.2006, "antikapët, "invalidët" dhe "të gjymtuarit" përdoret në të gjithë tekstin. Edhe më i dukshëm është në artikullin, "Viti i Mundësive të Barabarta: Parlamenti i Serbisë mbi ndalimin e diskriminimit të invalidëve" (Godina jednakih mogućnosti: Skupština Srbije o zabrani diskriminacije invalida), Politika, 04.04.2006, i cili flet për anti-diskriminimin dhe mundësitë e barabarta, por përdor terminologjinë vijuese fyese: antikapët, invalidët, dëmtime fizike dhe psikologjike, personat e dëmtuar, si edhe personat me paftësi. Në artikull citohet një qeveritar që thotë: " nëse shteti nuk u jep atyre (personave me aftësi të kufizuara) akses në edukim të barabartë me të tjerët, këta persona të dëmtuar do të mbeten antikapë dhe të marxhinalizuar." Jo vetëm kjo deklaratë është fyese, por vetë zyrtari qeveritar dukshëm nuk i njeh çështjet e aftësisë së kufizuar nga prespektiva e të drejtave të njeriut veçanërisht kur përdor terminologji të tillë të papërshtatëshme.

Pavarësisht nga fakti që po përdoret më shumë termi "personat me aftësi të kufizuara" në kryetitujt në Serbi, shumë prej artikujve u mungon qëndrueshmëria në terminologji në përmbajtjen e tekstit ku përfshihen terma fyese. Për shembull, në artikullin " Kujdes nga 2 në 15 ditë: Qendra e parë për strehimin afatshkurtër për personat me aftësi të kufizuara në Vojvodinë" (Nega od dva do 15 dana: Prvooobjekat za kratkotrajni smeštaj osoba sa invaliditetom u Vojvodini), Politika 13.09.2006, gazetari përdor një miks të termave që vijojnë: persona me të meta mendore, persona me aftësi të kufizuara, persona me një antikap. Po kështu në artikullin, "Përgatisin valixhet vetëm kur duhet: personat me aftësi të kufizuara si turistë" (Pakuju kofere samo kad moraju: Osobe sa invaliditetom kao turisti), Politika, 22.08.2006, përdoren një miks termash përfshirë personat me

antikape fizike dhe mendore. Pra, pavarësisht se në titull përdoret termi “personat me aftësi të kufizuara”, mungesa e vijimësisë në terminologji vijon në brendësi të tekstit.

Në artikujt në lidhje me aktivitetin e OPAK në Serbi, gazetari tenton të përdorë “personat me aftësi të kufizuara” në titull dhe në tekst terma të tillë si, “Një e drejtë e paaksesueshme: Konferencë e Personave me Aftësi të Kufizuara” (Nepristupačno pravo: Konferencija osoba sa invaliditetom) në Politika më 23.02.2006. Po kështu në artikullin “Tek Doktorit pas dy dekadash: Çfarë sjellin Shërbimet e asistencës personale” (Kod lekara posle dve decenije: Šta donosi služba personalnih asistenata), mbi një projekt të drejtuar nga OPAK, Politika e datës 4.01.2006, gazetari përdor të njëjtën terminologji. Një shembull tjetër pozitiv të përdorimit të së njëjtës terminologji në artikull, “Universitete të paaksesueshme: pozicioni i studentëve me aftësi të kufizuara” (Nedostupni Fakulteti: Položaj Studenata s Hendikepom) në Politika më 07.06.2006, që i referohet një studimi të ndërmarrë nga OPAK mbi aksesin në arsimin e lartë për studentët me aftësi të kufizuara. Përdorimi më i shpeshtë i terminologjisë gjatë pasqyrimin të aktivitetit të OPAK tregon se kur ka një komunikim të mirë mes medias dhe shoqërisë civile, ka edhe një përdorim më të mirë të terminologjisë mbi personat me aftësi të kufizuara.

Përdoret gjithashtu në median e shkruar termi “personat me një antikap” (osobe sa hendikepom), i cili është një term që preferohet nga disa pjestarë të lëvizjes së aftësisë së kufizuar, pasi ai nuk përdor fjalën “invaliditet” që ka në rrënjë fjalën “invalid”. Goran Plavlovic i Shoqatës së Studentëve me Aftësi të Kufizuara (ADS) të Serbisë shpjegon se përse ata preferojnë termin “personat me një antikap” (osobe sa hendikepom).

Shoqata e Studentëve me Aftësi të Kufizuara (ADS) ka realizuar 9 fushata mediatike. Në të gjitha ato ata targetuan median dhe përdorën të njëjtën terminologji. Drejtori Egzekutiv, Goran Pavlovic, është shumë i dukshëm në media, duke dalë shpesh në media, dhe sipas tij, përdor çdo mundësi që i jepet për të shpjeguar terminologjinë.

«Të dy termat 'personat me aftësi të kufizuara' dhe 'personat me antikap' janë të sakta, pasi të dyja e vënë theksin tek 'personi', dhe antikapi ose aftësia e kufizuar nuk kanë aq rëndësi. Personi është kryesori, qenia njerëzore me tërësinë e karakteristikave personale.

Termi që nuk rekomandohet absolutisht është «i paaftë/invalid», që përkufizohet si 'invalid, i pazakontë, pa vlerë'.

Përse antikap? Pasi ndërsa «aftësi e kufizuar» sinjalizon një mungesë të plotë ose të pjesshme të një funksioni, termi «antikap» nënkupton një gjendje në të cilën ndodhet personi, vetëm për shkak të aftësisë së kufizuar midis faktorëve të tjerë. E thënë kështu fokusi qëndron tek të drejtat e njeriut, tek barazimi i mundësive dhe tek përfshirja. Ne ndjejmë gjithashtu se ky term, personat me antikape, thekson më shumë aspektin e tij social, ndërsa termi 'personat me aftësi të kufizuara' thekson një aspekt më personal të situatës sonë'

Goran Pavlovic përdor zakonisht një paralelizëm për të nxjerrë në pah të drejtat e njeriut dhe barazimin e mundësive ashtu siç kuptohet nga publiku i gjerë. I pari përfshin basketbollistin Vladi Divac: ne të dy kemi një antikap: unë nuk mund të zëvendësoj llampën pa ndihmën e karriges, ndërkohë që ai nuk mund të hyjë në një Peglica (makinë e përmasave të vogla) dhe të ngasë atë në mënyrë komode.

Fjala antikap i ka fillesat në garat me kuaj që zhvilloheshin në shekullin e XVII. Kujt më të rinj dhe më të fuqishëm u jepeshin kalorësve më të rëndë, ndërkohë që kuajt më të vjetër dhe më të dobët konsideroheshin se kishin një antikap dhe u jepeshin kalorësve me peshë më të lehtë. Qëllimi ishte arritja e barazimit të mundësive në zyrat e basteve. Prandaj dikush me antikap nuk gëzon mundësi të barabarta dhe këtu nuk flasim vetëm për aspektin fizik.

Përsa i përket përfaqësuesve të medias, përpjekja ime e vazhdueshme është të arrijë një raportim sa më pozitiv lidhur me çështjet e aftësisë së kufizuar. Aktualisht, nëpër lajme përdoret modeli mjeksor, që e vë theksin tek dëmtimi, difektet dhe kufizimet, ajo çka ne nuk mund ta kemi, ndërkohë që kritikohen të tjerët për mos plotësimin e nevojave tona. Përkundrazi, duhet të ketë lajme më pozitive mbi atë çfarë ne kemi arritur, çfarë unë mund të bëj, gjëra apo vende ku unë mund të sjellë ndryshim.

Në Malin e Zi, ashtu si në Bosnje Hercegovinë dhe Serbi, shumica e titujve përdorin gjithashtu termin 'invalid', si për shembull në artikullin "Ndërtimi i aksesit për invalidët" (Uradjen prilaz za invalide) botuar në Dan, 16.12.06. Përveç përdorimit të gjerë të termit 'invalid' në tituj, jo ndryshe nga Serbia dhe Bosnje-Hercegovina, përdorimi i termave brenda artikujve është inkonistent. Për shembull "Qeveria nuk i dëgjon problemet e shurdhëve" (Vlast ne cuje probleme gluvih) botuar në Dan, 09.26.06, gazetari përdor termat: persona me dëmtime dëgjimi, persona shurdh, si edhe shurdh dhe persona me vështirësi dëgjimi. Në artikullin tjetër "Instalohet platformë e pjerrët për personat përdorues të karrigeve me rrota" "(Postavljena rampa za osobe sa kolicima), botuar në Pobjeda, më 10.11.06, gazetari krahason "studentët e zakonshëm" me "studentët me nevoja speciale". Në «Shteti duhet të kujdeset më shumë: Një seminar i realizuar për personat me aftësi të kufizuara» (Država da povede više računa: Održano predavanje za osobe sa invaliditetom), Dan, 21.11.06, pavarësisht nga fakti se termi persona me aftësi të kufizuara është përdorur në titull dhe të intervistuarit përdorin të njëjtën terminologji, gazetari gjithashtu përdor termin personat me nevoja të veçanta, dhe persona me zhvillim të frenuar psiko-fizik në të gjithë tekstin.

Sikurse dhe në BH dhe Serbi, titujt janë shpesh bombastik duke i trajtuar personat me aftësi të kufizuara si objekte:

- "Shëtitje në det për 260 invalid", (Krstarenje Bokom za 260 invalida) Vijesti, 11/04/200
- "Shfaqje në video për antikapatët", (Video bima za hendikepirane) Pobjeda, 28/07/200
- "Invalidët filluan grevën e urisë", (Invalidi počeli štrajk glađu) Vijesti, 31/03/200
- "Taksa më të ulëta kur punëson një invalid", Vijesti, (Manji porez ako se zaposli invalid) 07/04/200
- "Shurdhmecët përgatisin kartolina", (Gluvonemi prave čestitke Dan), 16/11/2006
- "Invalidët përgatisin suvenire", (Invalidi prave suvenire), Dan, 14/06/200
- "Në tre vjet kanë vdekur 40 punonjës invalidë", (Za tri godine umrlo 40 invalida rada), Dan, 22/04/2006

Në Malin e Zi, megjithatë, kishte një prezencë më të lartë të terminologjisë mjeksore në median e shkruar, të tillë si: 'pacientët' dhe 'fëmijët në institute' dhe termat si 'çrregullime' të përdorura për të përshkruar dëmtimet. Për shembull në artikullin mbi edukimin përfshirës «Kopshte për të Gjithë» (Obdaniste za sve) in Dan on 20.01.06, difektologu shpjegon procesin e tranzicionit drejt një klase të zakonshme si një "trajtim që duhet të jepet nga difektologu, terapisti i të folurit dhe psikologu". Në një artikull tjetër mbi edukimin përfshirës, një ekspert kombëtar i kësaj fushe shpjegon se ka katër 'ç'rregullime' për tu vlerësuar dhe identifikuar me qëllim përfshirjen në sistemin shkollor dhe ato janë: *verbëria, mungesa e dëgjimit, antikapi mendor dhe intelektual*.

Fëmijët me aftësi të kufizuara: Konfuzioni me termat

Në të tre vendet, ka një konfuzion të madh me termat që lidhen me fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht kur shkruhet për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale. Për ta ilustruar me tej këtë konfuzion, listat e termave që përdoren më shpesh është e gjatë dhe e shumëllojshme dhe përbëhet prej:

- Fëmijë me nevoja speciale arsimore
- Fëmijë me zhvillim të frenuar psiko-fizik
- Fëmijë me vështirësi në zhvillim
- Fëmijë me çrregullime dhe difekte
- Fëmijë me dëmtime të lehta në zhvillimin mendor
- Fëmijë dhe të rinj me vështirësi në zhvillim
- Fëmijë me mungesa dhe shqetësime

Një konkluzion i rëndësishëm lidhur me terminologjinë në BH është shpeshtësia e madhe e termit "fëmijë me nevoja speciale". Termi përdoret më shpesh në artikuj që lidhen me arsimin dhe reformat e arsimit përfshirës ose në artikuj për Qendrat e Kujdesit Ditor. Kur iu referohen fëmijëve me aftësi të kufizuara egziston tendenca që në vend të saj të përdoret termi "fëmijë me nevoja speciale." Tendencë tjetër është përdorimi i termit fëmijë me nevoja speciale për t'ju referuar fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale. Në disa artikuj termi përdoret në lidhje me terma të tillë si, vështirësi zhvillimi dhe persona me zhvillim të pamjaftueshëm mendor. Në artikullin "Kopshti i parë për fëmijët me nevoja speciale" (Prvi vrtić za djecu s posebnim potrebama), Nezavisne novine,

09.09.06, termat 'fëmijët me nevoja speciale' dhe 'personat me zhvillim të pamjaftueshëm mendor' përdoren në vend të njëra tjetrës në të gjithë tekstin. Në një artikull tjetër për një kopësht për fëmijë me aftësi të kufizuara, "Kopshti Marija Mazar është bosh" (Vrtic Marija Mazar prazan), Nezavisne novine, 12.10.06, përdoret termi të vegjël me nevoja speciale, fëmijë me nevoja speciale dhe fëmijë me vështirësi zhvillimi. Në një artikull tjetër, "Kush ka nevojë për të?" (Kome to odista treba?), Oslobođenje, 29.10.06, mbi arsimin përfshirës, terminologjia është shumë mikse dhe përfshin: fëmijë me nevoja speciale, fëmijë me vështirësi të mësuar, fëmijë me vështirësi të caktuara, fëmijë me një nivel të caktuar kapaciteti dhe fëmijë me vështirësi në zhvillim dhe në mësim.

Megjithatë, ka konfuzion lidhur me termin pasi është e paqartë se si përdoret ky term dhe kujt i referohet. Për shembull, në artikullin mbi arsimin përfshirës, "bëjmë një punë të përgjegjshme, por edhe shpërblyese" (Radimo odgovoran ali i prekrasan posao), në Reporter, 27.09.06, ndërkohë që në njërin anë është i qartë se termi "fëmijë me nevoja speciale" në këtë artikull i referohet fëmijëve me vështirësi të mësuar, mësuesi i intervistuar shpjegon se fëmijët me nevoja speciale përfshijnë fëmijët me dëmtime të foluri dhe fëmijët që nuk dëgjojnë. Edhe pse në shumicën e artikujve termi nënkupton se fëmijët me nevoja të veçanta janë fëmijë me vështirësi në të mësuar, nuk bëhet e qartë nëse termi përdoret për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara apo vetëm për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale.

Në mënyrë të ngjashme, në artikullin me titull "Ndihmë familjeve" (Pomoc obiteljima), në Dnevni Avaz, 29.10.06, termat Autizëm, shqetësime komplekse zhvillimi dhe fëmijë me vështirësi zhvillimi përdoren në të njëjtin artikull. Në artikullin, "Një dhomë e veçantë për fëmijët me autizëm" (Specijalna soba za decu sa Autizmom), Blic, 17.02.08, përdoren shumë terma të ndryshëm brënda një pasazhi shumë të shkurtër që përfshijnë: fëmijë me aftësi të kufizuara, fëmijë invalidë, fëmijë me nevoja speciale, fëmijë me vështirësi në zhvillim. Në artikullin, "Fëmijë të vetmuar jashtë vemendjes" (Usamljena deca: Na sporednom koloseku), Politika, 16.10.2006, në artikull përdoren termat e mëposhtëm: fëmijë me shqetësime në zhvillim, fëmijë me anticap, fëmijë me shqetësime të shumëllojshme dhe fëmijë të shëndetshëm. Në mënyrë të ngjashme në artikullin, "Sirenat e alarmit: personat invalidë në statistika" (Zvono za uzbunu: Osobe sa invaliditetom u statistici), Politika, 06.04.2006, termat: fëmijë me shqetësime psiko-fizike, dhe fëmijë me funksione mendore të dëmtuara përdoren për të përshkruar fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale.

Lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale në Serbi, terminologjia është tepër mikse dhe nuk ka terma konsistentë të përdorur në shtypin e shkruar. Plus kësaj, terminologjia e përdorur nga gazetarët është tepër poshtëruese. Terma të tillë si vonim mendor, personat me zhvillim mendor të pamjaftueshëm, dhe shqetësime zhvillimi komplekse përdoren si nga gazetarët ashtu edhe nga profesionistët, autoritetet dhe madje edhe nga prindërit e intervistuar nga shtypi i shkruar. Për shembull, në artikullin, "Fëmijë të vetmuar jashtë vemendjes" (Usamljena deca: Na sporednom koloseku) in Politika on 16.10.2006, nëna e një fëmije me aftësi të kufizuara intelektuale citohet të përdorë termat: fëmijë me ç'rregullime në zhvillim dhe fëmijë me ç'rregullime të ndryshme në zhvillim. Ose në artikullin, "Për hyrjen e defektologëve në shkolla: nga nën komiteti parlamentar për të drejtat e fëmijëve" (Za ulazak defektologa u škole: Sa skupštinskog pododbora za prava deteta) të gjitha termat e mëposhtme janë përdorur: fëmijë me vështirësi zhvillimi, persona me nevoja speciale, fëmijë me anticap, invalidë, fëmijë me nevoja normale, fëmijë me ç'rregullime të sjelljes, fëmijë me ç'rregullime të lehta në zhvillim dhe fëmijë me ç'rregullime të sjelljes.

Egziston gjithashtu një konfuzion mjaft i madh lidhur me termat që përdoren për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale edhe në shtypin e Malit të Zi. Në të 89 artikujt e shqyrtuar egziston një numër mjaft i madh termash që përdoren nga ana e gazetarëve për të përshkruar fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale dhe shpesh mund të gjenden disa terma të ndryshëm edhe brënda të njëjtit artikull. Për shembull, në artikullin, "Seminar edhe për prindërit" (Predavanja i za roditelje), Vijesti, 30.10.06, fëmijë me vështirësi në zhvillim, fëmijë me nevoja speciale dhe fëmijë me deficienca dhe shqetësime përdoren në vend të njëra tjetrës brënda këtij artikulli të shkurtër. Në mënyrë të ngjashme në artikullin, «Integrimi i fëmijëve me nevoja speciale» (Integracija djece sa posebnim potrebama) në Pobjeda, 03.06.06, në tekst përziehen fëmijët me nevoja speciale, fëmijët me aftësi të ulura intelektuale dhe fizike, fëmijë me vështirësi në zhvillim.

Egziston gjithashtu tendenca në median e shkruar në Bosnjë, Serbi dhe Malin e Zi për të krahasuar personat me aftësi të kufizuara me "personat e shëndetshëm" ose "personat normalë". Terma të tillë si "invalid" dhe "popullsia e shëndetshme" përdoren shpesh në lidhje me njëra tjetrën. Për shembull, në një shkrim nga

Bosnja të titulluar "Ju luani për atdheun" (Za domovinu se igra), transkript i një interviste radiofonike në Dani i datës 08.07.05, me anëtarë të ekipit kombëtar të volejbollit të personave me aftësi të kufizuara të Bosnjës, gazetarja pyeti një prej lojtarëve: "A jeni persona normalë?". "A keni bashkëshorte, familje dhe miq? Ajo më pas vazhdoi të pyesë, " Nëse ju mund tia dilni, a mund të themi të njëjtën gjë për personat e shëndetshëm, për ata pa antikap." Disa tekste përshkruajnë marrëdhënien mes "Popullsisë së shëndetshme" dhe popullsisë "jo të shëndetshme" siç ndodh në shkrimin nga Serbia "Antikapët në Parlament? (Hendikepirana u Parlamentu?), në Blic të datës 03.12.06?" ku në këtë shkrim gazetari përshkruan një shkollë për fëmijët me aftësi të kufizuara: "Në Beograd, për shembull, ka vetëm një shkollë për të mbështetur fëmijët e verbër dhe ata që nuk lëvizin duke iu ofruar atyre mundësinë për ta kaluar fëmijërinë e tyre në shoqërinë e fëmijëve të tërësisht të shëndetshëm. Për ta, kjo është e vetmja mundësi për tu ndierë të barabartë në të ardhmen, gjë që përbën bazat e një jetë të shëndetshme sociale." Ose, në shkrimin "Fëmijë të vetmuar jashtë vemendjes" (Usamljena deca: Na sporednom koloseku) në Politika të datës 16.10.2006, autori shkruan "Jeta me një fëmijë me handicap është jashtëzakonisht e vështirë.... Ky fëmijë ka shumë të ngjarë të flakë objektet që i dalin përpara dhe të krijojë një rrëmujë të pakontrolluar. Një fëmijë i shëndetshëm dhe aktiv është diçka, por hipeaktiviteti i një fëmije me shqetësime të shumëfishta në zhvillimin e tij është diçka krejt tjetër". Një tjetër shembull ilustrues e gjejmë në shkrimin "Mungesa e të kuptuarit nga ana e prindërve: "Më shumë fëmijë romë me nevoja të veçanta në kopshtë" (Nerazumevanje roditelja: Više Roma i dece sa posebnim potrebama u vrtićima), Politika, 24.08.2006, në të cilin drejtoresha e një OJQ-je që punon mbi një iniciativë për arsimin përfshirës i përshkruan fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollë së bashku me "fëmijët plotësisht të shëndetshëm". Më pas ajo vazhdon të shpjegojë se është e nevojshme që fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë klasat e tyre, pasi ata janë shumë agresivë dhe duhet të shoqërohen me "bashkëmooshatarët e tyre të shëndetshëm" për një orë në ditë.

Në raste të tjera, personave me aftësi të kufizuara u referohen në shkrime si, "ata persona". Përdoren gjithashtu terma të tjerë pavetorë të tillë si "100% invalidë" ose "60% invalidë" duke iu referuar një individi ose një grupi. Kështu ndodh në shkrimin e titulluar "Një invalid 100% trainon polivcin për tu zhytur " (Stopostotni invalid obučava i policijske ronioce) në Dnevni Avaz nga 04.09.06. përveç se është shumë pavetore, kjo terminologji jep një model shumë mjekësor të aftësisë së kufizuar, pasi kjo është mënyra se si klasifikohen personat me aftësi të kufizuara sipas komisionit mjekësor që vlerëson kapacitetin e tyre për të punuar dhe përfitimet që rrjedhin prej tij.

Në të tre këto vende duket qartë mungesa e vijmësisë së përdorimit të terminologjisë së aftësisë së kufizuar në median e shkruar, por termi "invalid" është përdorur më shpesh sesa të tjerët, veçanërisht në titujt e shkrimeve. Ndërsa disa media përdorin terma neutralë të tillë si "persona me aftësi të kufizuara" ka ende një numër të madh gazetarësh që përdorin terma depersonalizues të tillë si "të paaftë" ose "handikapë". Duke qenë se titujt shihen më shumë, kjo praktikë mund të ndihmojë për të futur përdorimin e këtij termi në media edhe nga publiku i gjerë. Niveli i lartë i terminologjisë ofenduese ose depersonalizuese nxjerr në pah nevojën që gazetarët të jenë më të ndërgjegjshëm për gjuhën e përshtatshme për aftësinë e kufizuar. Megjithatë, më shqetësuese është mungesa e përgjithshme e vijmësisë mbi termat, gjë që tregon për një konfuzion të dukshëm mbi gjuhën për aftësinë e kufizuar dhe mungesën e konsensusit publik mbi terminologjinë e duhur.

Ndryshimi i gjuhës që përdoret në media

Ka një numër shembujsh pozitivë të shkrimeve që përdorin terminologjinë e duhur. Praktikant e mira janë zakonisht të shkruara nga advokuesit e aftësisë së kufizuar ose nga ata që kanë intervistuar pjesëtarë të lëvizjes së aftësisë së kufizuar, ose kur gazetari ka një njohuri të përgjithshme mbi çështjet që lidhen me aftësinë e kufizuar nga perspektiva e modelit social. Advokuesit e aftësisë së kufizuar në rajon kanë përgjegjësinë e madhe për ti treguar medias se çfarë gjuhe ata duan që të përdoret dhe të këmbëngulin që kjo gjuhë të përdoret gjithmonë. Në këtë mënyrë ata do të ndihmojnë për të realizuar ndryshime afatgjata në mënyrën se si përdoret nga media e shkruar terminologjia mbi aftësinë e kufizuar. Nga ana tjetër, është e qartë që gazetarët, redaktorët dhe profesionistët e tjerë të medias kanë nevojë të trainohen rreth terminologjisë së aftësisë së kufizuar për të ditur se cila terminologji është e saktë. Përgatitja e një pakete informuese që targeton profesionistët e medias do të ishte një zgjedhje e mençur. Përveç kasaj, ka nevojë për investime në trainimin e zëdhënësve të medias brënda lëvizies së aftësisë së kufizuar për të garantuar përdorimin e terminologjisë së duhur.

Më poshtë jepen disa praktika të mira në përdorimin e terminologjisë së duhur:

“PËR LËVIZJE TË LIRË DHE PAVARËSI” (ZA SLOBODNO KRETANJE I SAMOSTALNOST), Danas, 16.10.06

Bastuni i Bardhë, Shoqata e Personave të verbër dhe dëmtime shikimi, organizoi një veprimtari ditën e shtunë të titulluar “Të ecim së bashku” me synim nxitjen e të drejtave të barabarta për lëvizje të lirë dhe pavarësi. Iniciativa u organizua me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Bastunit të Bardhë, me qëllim që të nënvizonte rëndësinë e integritet të personave me aftësi të kufizuara në komunitetin e gjerë social. Presidentja e Shoqatës “Bastuni i Bardhë” Vesna Nestorović, tha për median se motivi i kësaj veprimtarie është të nxjerrë në pah partneritetin midis personave me aftësi të kufizuara dhe shtetit në zgjidhjen e problemeve të personave me aftësi të kufizuara. Nestorović tha se veprimtaria “Të ecim së bashku” kërkon të tërheqë vëmendjen ndaj harresës gjatë rikonstruktimit të rrugës Nemanjina në Beograd. Ajo theksoi se shoqatat e personave me aftësi të kufizuara u përpoqën të shpjegojnë se si trotualet për personat e verbër duhej të ishin ndërtuar në një mënyrë të tillë që të ishin të përdorëshme nga e gjithë popullata, por askush nuk i kushtoi vëmendje dhe për shkak të lartësisë së tyre personat me aftësi të kufizuara nuk mund ti përdorin këto rrugë për të ecur të pavarur. Ajo përmendi gjithashtu edhe një problem tjetër me të cilin përballen personat e verbër dhe me dëmtime shikimi – është mungesa e personelit që do të mund të asistonte për të trainuar personat për të lëvizur në mënyrë të pavarur- Instruktorët e Orientimit dhe Lëvizjes. Ajo tha gjithashtu se ishte bërë një propozim për të realizuar një training të personelit lokal në Kroaci. Veprimtaria nisi në sheshin Slavia ku u mbledhën rreth 50 persona me aftësi të kufizuara. Përballë Qendrës Kulturore të Studentëve në Beograd ata organizuan simulimin e kalimit të rrugës me sy të lidhura dhe me shkop, ecjen e pavarur në trotuar për personat e verbër dhe me dëmtime shikimi dhe kalimin e rrugës me karrocë.

“GJITHSHKA VARET NGA DËSHIRA E MIRË E AUTORITEVE LOKALE” (SVE ZAVISI OD DOBRE VOLJE LOKALNE VLASTI), Danas, 25.10.06.

Motivimi për Punësimin dhe Vetë-punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara

Arsimimi i personave me aftësi të kufizuara është i orientuar kryesisht drejt shkollave speciale ku kurikula nuk është e njëjtë me atë që zbatohet në shkollat e zakonshme. Shumë shkolla dhe fakultete nuk kanë platforma të pjerrëta për personat me aftësi të kufizuara, gjë që komplikon më shumë mundësinë e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor, prandaj kur punësohen këta persona niveli i pabarabartë arsimor bëhet problem.

Ky është një prej konkluzioneve të “Studimit Motivim për Punësim dhe Vetë-Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuara”, që u realizua nga Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Përfshirëse, Qendra për Monitorimin dhe Vlerësimin dhe Handicap International, ndërsa prisnin miratimin e Ligjit mbi Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Sipas Marko Savić nga Qendra për Montorim dhe Vlerësim, Shteti nuk ka një zgjidhje me sistem të gjerë për këtë problem, prandaj gjithshka varet nga dëshira e mirë e autoriteteve lokale. Në territorin e Serbisë, sipas të dhënave të marra nga Zyra Kombëtare e Punësimin, janë 25.744 persona me aftësi të kufizuara të rregjistruar.

– Shteti ynë nuk ka përcaktuar ende çështjen më thelbësore, se cili është përkufizimi i një personi me aftësi të kufizuara. Në numër ligjesh në këtë fushë ende presin të miratohen dhe ata që janë egzistues, të tillë si Ligji që Ndalon Diskriminimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, nuk zbatohen. Në Britaninë e Madhe personat e verbër mund të kryejnë rreth 93 punë , ndërsa në vendin tonë ky numër është vetëm dy- tha dje Savić, në një konferencë për shtyp të organizuar pas përfundimit të studimit dhe publikimit të “Motivimi për Punësimin dhe Vetë-Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Në artikullin që vijon nga Mali i Zi, shohim një përdorim të mirë të termit “personat e verbër” dhe “personat me dëmtime në shikim” edhe pse “i verbëri” është përdorur në titull. Megjithatë, pavarësisht nga përdorimi i vazhdueshëm i terminologjisë së duhur, në fund të artikullit gazetari bën një shënim të quajtur: “Personat e verbër janë Shumë të Guximshëm”, që është për të ardhur keq, pasi e ul vlerën duke i përshkruar personat e verbër si persona që duhet të konsiderohen me kurajo pasi jetojnë në shtëpitë e tyre.

**“NGA 198 TË VERBËR VETËM 15 MUND TË LËVIZIN NË MËNYRË TË PAVARUR” (OD 198 SLIJEPIH SAMO SE 15 KRECE SAMOSTALNO), DAN, 08.07.06
PODGORICA – QYTETI I BARRIERAVE**

Nuk ka trainime të organizuara për të ecur me shkopin e të verbërve, dhe vetëm një person nga Serbia është specialist i çertifikuar i orientimit dhe lëvizjes, thotë Bozidar Denda.

Zonat publike, rrugët, parqet dhe urat nuk janë të përshtatura për lëvizjen e pavarur të personave të verbër. Platformat e pjerrëta me kënde duhet të jenë të paktën dy centimetra mbi rrugë dhe në asnjë mënyrë në të njëjtin nivel me rrugën, siç ndodh në shumë raste. Kur përdor shkop në raste të tilla është shumë e vështirë të kuptosh ku është kufiri midis trotuarit dhe rrugës. Makinat e parkuara në mënyrë të çrregullt mbi trotuare janë pengesa të mëdha, sikurse edhe rastet e mos respektimit të rregullave të trafikut. Pavarësisht nga të gjitha njoftimet, nuk ka ende sinjalistikë të dëgjueshme dhe pusetat e hapura janë të rrezikshme edhe për ata që shikojnë shumë mirë. Trotualet në ura janë gjithashtu shumë të ngushta.

Është fakt i dhimbshëm që nga 198 persona të verbër vetëm 15 mund të lëvizin me ndihmën e shkopit.

- Rreth 60% e anëtarësisë është 55 vjeç e lart. Për ta është shumë e vështirë të mësojnë se si të lëvizin. Numri i fëmijëve me dëmtime shikimi është i vogël, diçka më pak se 5% dhe pjesa tjetër e popullsisë së verbër në Podgoricë është në moshat 20-40 vjeç- thotë Bozidar Denda i shoqatës së personave të verbër në Podgoricë.

Ata rrallë lëvizin në distanca të mëdha dhe kur e bëjnë një gjë të tillë, e arrijnë kryesisht me ndihmën e miqve ose familjarëve, thotë Denda. Ai nënvizoi se mungesa e trainimeve për lëvizjen me ndihmën e një shkopi është problem serioz dhe vetëm një person nga Serbia është çertifikuar si Specialist i Orientimit dhe Lëvizjes (një person që trainon personat e verbër për të lëvizur duke përdorur shkopin dhe u mëson atyre të orientohen vetë.)

Për të organizuar trainimet e orientimit dhe lëvizjes duke përdorur shkopin, ndihma e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës është e nevojshme, tha Milos Vujcic, Drejtori i Institutit për trainimin dhe rehabilitimin profesional të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në Zabjela.

- Ne nuk kemi realizuar trainime mbi lëvizjen duke përdorur shkopin as për fëmijët dhe as për të riturit dhe ky kurs nuk egziston në Institut. Duke qenë se kjo është e nevojshme në jetën e përditëshme të përfituesve tanë, ne përpiqemi të organizojmë kurse tremujore çdo vit. Në Mal të Zi askush nuk është i kualifikuar për të dhënë këtë lëndë. – thotë Vujcic.

Ai vlerëson se kopshti i Institutit është i sigurtë për kurset mbi orientimin por rrugët nuk janë të sigurt.

Radenko Lacmanovic, gazetar, beson se Bordi Menaxhues i Unionit të të Verbërve të Republikës dhe Administrata e Qytetit janë përgjegjës për pengesat që vështirësojnë lëvizjen e personave të verbër. Në kryeqytet nuk është bërë asgjë për të lehtësuar lëvizjen e personave që nuk shohin, përkundrazi, duket se ecja nëpër rrugët e qytetit çdo ditë është e pamundur. Pengesat janë të shumta, nuk ka sinjalistikë të dëgjueshme, problemi i parkimit nuk është zgjidhur siç duhet, lëvizja në trotuare është e vështirë edhe për ata që shohin, jo më për ata që janë të verbër- tha Lacmanovic.

Në Podgoricë nuk ka mundësi për personat e verbër të trainohen që mund ti ndihmonte ata për të lëvizur.

Orientimi autodidakt dhe Trainuesit e Lëvizjes

Në çdo proces trainimi, të rinjtë mësojnë më shpejt ndërkohë që të moshuarit e kanë të vështirë duke përdorur bastunin e bardhë. Frika është një problem i madh që i pengon personat më dëmtime shikimi. Në fillim ne organizojmë programin e trainimit në një mjedis të sigurt dhe më pas, gradualisht, ne e kryejmë praktikën në një teren më të vështirë. Në qendër të qytetit, udhëkryqi më i rrezikshëm është ai ngjitur me Hotel Montenegro. Ne patëm një sërë trainimesh dhe teknikash përgatitore me qëllim që studentët tanë të kishin më tepër guxim

dhe të fillonin të lëviznin në mënyrë më të pavarur – thotë Igor Tomic, mësues i edukatës fizike dhe Trainer i orientimit dhe Lëvizjes së Pavarur, i cili trainon të verbrit në lëvizje dhe orientim.

Të verbrit janë veçanërisht të guximshëm

Lacmanovic thotë se më vështirë është gjatë verës kur pronarët e restorantëve vendosin tavolina dhe karrike në trotuare.

- Më pas të duhet ta gjesh me vështirësi rrugën mes tavolinave, karrikeve dhe klientëve. Makinat e parkuara në trotuare përbëjnë gjithashtu problem. Lëvizja e pavarur është rezultat i kurajos vetiake edhe për shkak se nuk ka alternativa – thotë Lacmanovic.

III. BURIMET E LAJMIT

Në këtë pjesë të këtij dokumenti ne pyesim: nga i marrin lajmet gazetarët për shkrimet e tyre në lidhje me aftësinë e kufizuar?

Përse janë të rëndësishme burimet e lajmit?

Në këtë studim është e qartë se:

- Pjesa më e madhe e lajmit në lidhje me aftësinë e kufizuar vjen nga zyrtarët shtetëror dhe autoritetet lokale.
- Të dytët renditen profesionistët që punojnë në fushën e mbrojtjes sociale të tillë si defektologët, mësuesit dhe punonjësit social.
- Zyrtarët e organizatave të aftësisë së kufizuar renditen më pas dhe përbëjnë një pjesë të rëndësishme të burimeve të lajmit dhe citohen gjithnjë e më shumë në shkrime.

Sipas studimeve të mëparëshme mbi median, media preferon burimet e lajmit që vijnë nga qeveria dhe burime të tjera elitë²¹. Në SHBA, me rastin e Aktin e Amerikanëve mbi Aftësinë e Kufizuar, gazetarët dhe mediat kishin njohuri aq të pakta mbi aftësinë e kufizuar, sa që iu desh të fillonin të zhvillonin burimet nga vetë komuniteti i aftësisë së kufizuar²². Po kështu është edhe për Ballkanin. Ndërkohë që shumë çështje të aftësisë së kufizuar në rajon janë në varësi të qeverive dhe legjislacionit mbi aftësinë e kufizuar, burimet nga qeveria dhe zyrtarë të tjerë priten si lajme mbi çështjet që kanë të bëjnë me aftësinë e kufizuar. Megjithatë, marrja e lajmit nga komuniteti i aftësisë së kufizuar nuk është e vetmja çështje. Gazetarët, në përgjithësi, nuk janë të sensibilizuar ndaj çështjeve të aftësisë së kufizuar dhe, ndoshta pa vetëdije, e shohin aftësinë e kufizuar nga një prespektivë pezhorative. Në fakt, sipas teoristes së komunikimit Pamelas Shoemaker, kur raportimi mbi një grup të marxhinalizuar çon në etiketim, gazetari vepron sikur të ishte gjyqtar duke i dhënë audiencës së tij apo të saj gjykime mbi normat e sjelljes²³.

Kur aftësia e kufizuar raportohet nga personat pa aftësi të kufizuara, vihet re tendenca për të shkruar mbi aftësinë e kufizuar dhe personat me aftësi të kufizuara si “të tjerët”. “Është bërë i zakonshëm besimi se kjo është e vetmja mënyrë që lexuesit të kenë akses tek lajmi. Duke u fokusuar në eksperiencën e familjes, miqve dhe profesionistëve dhe përgjigjeve të tyre një person me aftësi të kufizuara ndihet pranë eksperiencave të lexuesve, ata do të ndihen më mirë me eksperiencën e një mesatareje lexuesish dhe për rrjedhojë ata do të ndihen mirë me këtë reportazh “shokësh”²⁴.

²¹ Beth Hellar, “News Coverage of Disability Issues: Final Report for The Centre for an Accessible Society”: 4.

²² Hellar, Ibid: 4.

²³ Pamela Shoemaker, “The Communication of Deviance” in B. Dervin (Ed.) Progress in Communication Science (Norwood, NJ: Albex, 1987): 172.

²⁴ Scope, ibid: 6.

Gjatë dhënies së një lajmi, biseda me sa më shumë persona me aftësi të kufizuara është mënyra më e mirë sipas Wailim Wong, Korespondent i Çështjeve Sociale në MB. Siç shpjegon ai, “shkrimet mbrojtëse mbi personat ‘antikap të guximshëm’ që kapërcejnë këto sëmundje ende shfaqen në median e shkruar” Për ta ndryshuar këtë, ai sygjeron, se komuniteti i aftësisë së kufizuar duhet të komunikojë me gazetarët mbi mënyrën se si dëshirojnë të pasqyrohen çështjet e aftësisë së kufizuar. Megjithatë, shton ai, gazetarët duhet të flasin me sa më shumë persona me aftësi të kufizuara, duke patur parasysh faktin se ai nuk është një grup njerëzish uniform. Egzistojnë çështje të ndryshme dhe opinione të ndryshme mbi atë çfarë është fyese dhe atë çfarë nuk është e tillë²⁵.

Tendencat kryesore të identifikuar:

Vihet re një miks burimesh dhe në studim tregohet se gazetarët marrin lajmet e tyre nga tre burime kryesore: qeveria, OPAK, dhe profesionsitet. Në BH është evidente se në shumë prej shkrimeve që kanë të bëjnë me aftësinë e kufizuar, gazetari përdor një miks burimesh. Shkrimi, “Invalidët: shteti na plagosi më shumë se lufta” (Invalidi: Država nas ranjava gore od rata) nga Dnevni List, 30.06. 2006, në tekst citohen disa burime të ndryshme, përfshirë Unionin e veteranëve invalid të luftës, si dhe zyrtarë qeveritarë. Në “Kompanitë lokale kundërshojnë punësimin e invalidëve” (Domaće tvrtke protiv zapošljavanja invalida) Dnevni List, 16.06.06, mbi legjislacionin e punësimit, si anëtarët e shoqatës së punonjësve ashtu edhe përfaqësues të ndryshëm të OPAK citohen në shkrim. Po kështu, në “Përfshirja e 407 fëmijëve në nevojë” (Uključeno 407 djece s posebnim potrebama) në Nezavisne Novine më datë 19.10.06, janë intervistuar drejtori i një shkolle speciale dhe një zyrtar i ministrisë.

Kur trajtohen reformat ligjore ose strategjitë qeveritare në lidhje me aftësinë e kufizuar, burimi kryesor i lajmit janë përfaqësuesit qeveritar. Kështu, për shembull, në një shkrim mbi legjislacionin e përfitimeve sociale, “Zbatimi i ligjit mbi personat me aftësi të kufizuara civilë dhe invalidëve të luftës” nga (Implementacija zakona o civilnim invalidima i zrtvama rata) Dnevni Avaz 14.09.06, në tekst citohet vetëm burimi qeveritar. Edhe në shkrimin “Personave me aftësi të kufizuara në RS u janë dhunuar të drejtat e tyre” (Invalidii u RS obespravljeni) në Nezavisne Novine, datë 11.10.06, gazetari përdor burime nga ministria si dhe nga zyra kombëtare e punësimit, por askush nga shoqëria civile nuk citohet në shkrim. Në një shkrim mbi detyrimet ligjore të qytetit në lidhje me aksesueshmërinë, arkitekti i qytetit dhe një përfaqësues i ministrisë janë të vetmit burime lajmi dhe askush nga komuniteti i aftësisë së kufizuar nuk citohet në tekst.

Situata është e njëjtë në Serbi kur bëhet fjalë për lajme mbi reformën ligjore. Në një shkrim mbi miratimin e strategjisë kombëtare të aftësisë së kufizuar, “Krijimi i kuadrit për jetesë të barabartë: strategjia për përmirësimin e jetës të personave me aftësi të kufizuara” (Stvaranje okvira za ravnopravan život: Strategija za unapređenje položaja osoba sa invaliditetom), zyrtarët e ministrisë janë burimi kryesor i lajmit. Po kështu në “Viti i Mundësive të Barabarta: Parlamenti i Serbisë mbi ndalimin e diskriminimit të personave me aftësi të fkuziaura” (Godina jednakih mogućnosti: skupština srbije o zabrani diskriminacije invalida), Politika, 04.04.2006, që hedh një vështrim mbi reformat më të fundit ligjore për të lehtësuar barazi më të madhe, qeveria është i vetmi burim i lajmit, pasi vetëm një ministër dhe anëtarë të parlamentit janë cituar duke folur për rëndësinë e legjislacionit anti-diskriminim. Është ironik fakti që, pavarësisht nga tema e shkrimit, një zyrtar qeveritar është cituar duke përdor gjuhë pezhorative: “ nëse shteti nuk u siguron atyre (personave me aftësi të fkuziaura) akses në edukim të barabartë me të tjerët, këta persona të dëmtuar do të mbeten handicap dhe të marxhinalizuar.”

Në shkrimet në të cilat një OPAK ka realizuar një veprimtari ose fushatë dhe ka kontaktuar median, ata prezantohen në shkrim si burimi kryesor i lajmit. Për shembull, në shkrimin “të përdorësh biznesin për të luftuar paragjykimet” (Firmom protiv predrasuda), Politika, 18.01.2007, në lidhje me një OPAK që hapi një biznes të vogël për të punësuar personat me aftësi të kufizuara, e tregon historinë sipas këndvështrimit të organizatës. Shkrimi artikulon qartë këndvështrimin e OPAK mbi mundësitë e barabarta dhe zhvillimin e të drejtave të njeriut. Në një shembull tjetër, kemi një shkrim të përgatitur sipas këndvështrimit të advokuesve të aftësisë së kufizuar mbi turizmin e aksesueshëm në “Përgatisin valixhet vetëm kur duhet: personat me aftësi të kufizuara si turistë” (Pakuju kofere samo kad moraju: Osobe sa invaliditetom kao turisti), Politika, 22.08.2006.

²⁵ Cooke, Caroline; Daone, Liz; Morris, Gwilym, “Stop Press: How the Press Portrays Disabled People” (Scope: London, 2000): 28.

Shkrimi bazohet në një aktivitet të realizuar nga OPAK mbi turizmin e aksesueshëm dhe ka një ton të qartë advokacie mbi barrierat me të cilat ndeshen personat me aftësi të kufizuara. Në “të arrish pavarësinë e personit me aftësi të kufizuara: premierë filmi në një qendër kulturore” (Osamostaljivanje invalida: Premijera filma u kulturnom centru), Politika, 07.12.06, shkrim mbi një premierë filmi të organizuar nga një OPAK në përkujtim të 3 Dhjetorit, gazetari citon përfaqësuesin e OPAK që organizoi veprimtarinë dhe zyrtarët e ministrisë që e ndoqën aktivitetin. Ata flasin për rëndësinë e shërbimeve të asistencës personale për të arritur jetesën e pavarur. Për pjesën më të madhe, OPAK janë burimet e lajmit kur kanë realizuar evenimente që gjejnë pasqyrim në media. Në Serbi shumë OPAK kanë arritur të komunikojmë një axhendë të gjerë të aftësisë së kufizuar kur gazetarët ndjekin veprimtaritë e tyre.

Nuk ndodh gjithnjë kështu në BH kur OPAK janë burime kryesore të lajmit. Për shembull në shkrimin e datës 3 Dhjetor, “Mijëra persona me aftësi të kufizuara kanë nevojë për ndihmë” (Hiljadama invalida neophodna pomoć), Nezavisne Novine, 03.12.06, gazetari interviston disa OPAK që shpjegojnë se personat me aftësi të kufizuara në BH kanë nevojë për asistencë. Në këtë shkrim gazetari gjithashtu citon një individ me aftësi të kufizuara që flet mbi arritjet e jetës së tij. Në “Ndarja mes tyre i çoi në pozicion edhe më të vështirë” (Podjele ih dovele u još teži položaj), Oslobođenje, 03.12.06, dy OPAK janë intervistuar në 3 Dhjetor për të shpjeguar rëndësinë e krijimit të një organizate ombrellë në BH. Të dy shkrimet janë neutral në tonet e tyre dhe nuk përmendin as fuqizim, barazi apo çështje të tjera mbi axhendën e të drejtave të njeriut.

Megjithatë, ka shembuj të OPAK-ve që mbulohen nga shtypi i shkruar nga një këndvështrim më pozitiv lidhur me të drejtat e njeriut. Në artikullin, “Në rrezik të drejtat e grave invalide në Bosnjë dhe Hercegovinë” (Ugrožena prava hendikepiranij žena u BiH), Nezavisne Novine, 25.11.04, intervistohet përfaqësuesja e një OPAK, e cila në mënyrë të qartë artikulon diskriminimin e dyfishtë me të cilin përballen femrat kur thotë se: “Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara..... u dërgojnë një mesazh urgjent ministrive që të ndalin dhunën ndaj këtyre femrave në familje dhe ti bëjnë klinikat gjinekologjike të aksesueshme sa më shpejt që të jetë e mundur me qëllim që të gjitha femrat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi për kontrolle mjekësore”. Në “Kampanja zagovaranja prava osoba s mentalnom retardacijom u FBiH”, një artikull që mbulon një fushatë mediatike të organizuar nga një OPAK, advokuesi i aftësisë së kufizuar i intervistuar në mënyrë të qartë prezanton një këndvështrim nga ana e të drejtave të njeriut lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara intelektuale. Në, “Kujdes il paket për të verbërit: Nesër është dita ndërkombëtare e Bastunit të Bardhë” (Malo brige za slijepe; Sutra je Medjunarodni Dan Bijelog Stapa”, OPAK-u i intervistuar diskutoi mbi barrierat me të cilat përballen të verbërit për të patur të ardhura të qëndrueshme. Gazetari citon përfaqësuesin të thotë: “Personat me aftësi të kufizuara dhe handikapatë janë kategoria më e rrezikuar e popullsisë në Bosnjë Hercegovinë pasi të drejtat dhe liritë e tyre bazë shkelen çdo ditë dhe kjo u ndodh edhe në nivelet më të larta të qeverisë. Hapi i parë duhet të jetë barazimi i të drejtave dhe përfitimeve financiare bazuar në mbrojtjen sociale në të gjithë teritorin e Bosnjë Hercegovinës.

Në Malin e Zi, përfaqësuesve të OPAK-ve u kërkohet të jenë burime lajmi, por zakonisht lidhur me një ngjarje apo projekt me të cilin ata po merren. Në Malin e Zi ka një numër tepër të pakët artikujsh që i përdorin OPAK-ët si burime lajmesh. Në artikullin, “Shteti të kujdeset më shumë” (Država da povede više računa), Dan, 21.11.06, mbi një iniciativë lokale për krijimin e shërbimeve dhe mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara, OPAK-u që merrej me zbatimin e projektit citohet së bashku me përfaqësuesin e një organizate ndërkombëtare të përfshirë në projekt. Ditën ndërkombëtare të Bastunit të Bardhë, një person me aftësi të kufizuara është burimi kryesor i lajmit mbi barrierat që hasin të verbërit dhe personat më vështirësi shikimi në «Nga 198 të verbër, vetëm 15 mund të lëvizin lirisht» (Od 198 slijepih samo se 15 krece samostalno), Dan, 08.07.06. Megjithatë, në një tjetër artikull mbi veprimtaritë e OPAK-ve, kuadri i artikullit i përket modelit mjekësor: “Veprimtaritë pakësojnë errësirën” (Aktivnosti “smanjuju mrak), Dan, 20.06.06. Pavarësisht titullit tepër emocionues, personat me vështirësi shikimi paraqiten si për tu mëshiruar: “Ashtu siç u tha edhe më parë, shoqëria jonë është ende e vonuar me pishtarin njerëzor në drejtim të këtyre personave invalidë”. Prireja e përgjithshme është që OPAK-ët janë burimi kryesor i artikujve të shkruar për veprimtari apo projekte që ata i menaxhojnë, ose si në ditët ndërkombëtare si për shembull 3 dhjetori ose Dita e Bastunit të Bardhë.

Në artikujt mbi arsimin përfshirës si edhe arsimin special, egziston një model i qartë ku ekspertët të tillë si defektologë, mësues apo drejtorë shkollash janë aktorët kryesorë që intervistohen dhe citohen. Për shembull, në artikullin, “Dashuria nxjerr në pah anët më të mira të fëmijëve” (Ljubavlju izvlace najbolje iz dece) në Blic të datës 13.06.06, mbi një shkollë speciale, u intervistuan dhe u cituan në artikull vetëm defektologët që

punojnë në këtë shkollë. Kjo prire egziston edhe në Bosnjë Hercegovinë. Në artikullin mbi vështirësitë për vënien në jetë të arsimit përfshirës, "Prindërit padi kundër ministrit" (Roditelj podnose krivičnu prijavu protiv ministra Turkušića), Oslobođenje, 14.10.06, zërat kryesorë që debatonin mbi çështjen e arsimit përfshirës vinin nga: drejtori i shkollës speciale, menaxheri i shkollës speciale, psikologu dhe një numër mësuesish. Vetëm një prind citohet në fund të artikullit dhe asnjë fëmijë me aftësi të kufizuara apo advokues i aftësisë së kufizuar nuk u intervistua; ai u shkrua plotësisht sipas këndvështrimit të profesionistëve. Ky elitizëm përforcohet edhe nga fjalët denigruese të drejtorit të shkollës speciale: "Mund të ishte më mirë që të gjithë fëmijët të ishin të shëndetshëm, por situata nuk është afër as me atë që do të dëshironin (qeveria) të paraqitej." Edhe në një artikull të plotë mbi reformën e arsimit përfshirës në Malin e Zi, ngjarja tregohet plotësisht sipas këndvështrimit të ekspertit kombëtar të arsimit përfshirës dhe donatorit. Në artikull nuk përfshihen pjesëtarë të komunitetit të aftësisë së kufizuar.

Zëri i vetë personave me aftësi të kufizuara rrallë përdoret si burim lajmi. Zëri i personave me aftësi të kufizuara regjistrohet në reportazhe që profilizojnë jetën e një personi të caktuar me aftësi të kufizuara. Siç do të tregohet edhe në vijim të këtij materiali, këto janë zakonisht portretizime stereotipike që i përshkruajnë personat me aftësi të kufizuara ose si për tu mëshiruar ose si superheronj. Në Malin e Zi, në vetëm 7 nga 89 artikuj gazetarë intervistojnë personat me aftësi të kufizuara (pa përfshirë përfaqësuesit e OPAK-ve), por secili lajm tregonte mbi arritjet në jetë dhe asnjëri prej tyre nuk përbënte lajm. Pothuajse e njëjta tendencë egziston edhe në Serbi. Megjithatë, ka një numër artikujsh ku personat me aftësi të kufizuara citohen si burim lajmi, por nuk përmendet fakti se ata ishin persona me aftësi të kufizuara. Për shembull, në artikullin, "Si ti zgjidhim problemet jetësore të personave me aftësi të kufizuara", citohet personi me aftësi të kufizuar, por në vend që të thuhet se ai është person me aftësi të kufizuara ai përmendet si ekspert ligjor. Përsëri në "Mbrotjtje për personat invalidë" (Zaštita osoba sa invaliditetom) Politika, 05.01.2006, personi me aftësi të kufizuara citohet, por aftësia e tij e kufizuar nuk nënvijëzohet, përkundrazi ata përcaktohen vetëm në bazë të profesionit. Jo gjithmonë është me vend të përmendet aftësia e kufizuar e dikujt, sikurse mund të mos ketë kuptim të përmendet ngjyra e lëkurës apo etnia e një personi.

Shtypi në Bosnjë Hercegovinë duket të ketë zhvilluar një disiplinë në kërkimin e personave me aftësi të kufizuara si burim lajmi. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur bëhet fjalë për vetëranët e luftës me aftësi të kufizuara, që japin çerekun e citimeve (koment mbi një çështje ose ngjarje, duke i lënë vend vetëm një zëri të vetëm) për shtypin. Si rregull, burimi kryesor nga sektori i shoqërisë civile është një zyrtar i lartë i sindikatës ose i një shoqate (p.sh. presidenti apo sekretari i përgjithshëm), i cili zakonisht tërheq vëmendjen mbi këtë çështje. Në artikullin e Nezavisne novine, "Skedimi i 750 Ankesave Legale kundër Qeverisë Federale", (Podneseno 750 tuzbi protiv Federalne Vlade) presidenti i Unionit Federal të Personave me Aftësi të kufizuara kërcënon: "ne do të vazhdojmë ti skedojmë këto ankesa ndaj qeverisë federale. Me çdo përgjigje negative të dhënë për kërkesat për pension të aftësisë së kufizuar, ne do të përgatisim një ankesë tjetër legale. Ose, në të njëjtin artikull, sekretarja e përgjithshme e Unionit federal të paraplegjikëve dhe atyre me pasoja nga poliomyeliti, kërkon vëmendje ndaj çështjes, ndërkohë që citohet të ketë thënë: "vetëranët e luftës me aftësi të kufizuara favorizohen në krahasim me personat me aftësi të kufizuara jo vetëranë lufte, dhe egziston edhe diskriminimi gjeografik." Në "Rritje e numrit të pensionistëve që përfitojnë në bazë të invaliditeti: në Bosnjë Hercegovinë, një në katër pensione është pension invaliditeti", (Povecan broj penzionera koji su prava ostvarili na osnovu invalidnosti: U BiH svaka četvrta invalidska penzija), shkrim mbi reformën e pensioneve të aftësisë së kufizuar, gazetari flet me pensionistët dhe punonjësit e zyrave të pensioneve. Në mënyrë të ngjashme, në artikullin "invalidët diskriminohen në të gjitha nivelet" (Invalidi diskriminirani na svim nivoima), Nezavisne Novine, 29.10.06, gazetari interviston dhe citon tre përfaqësues të ndryshëm të OPAK-ve, së bashku me një anëtar të qeverisë mbi çështjen e reformës së përkrahjes sociale.

Ka shumë shkrime në Serbi që kombinojnë burimet, kur gazetari kontakton përfaqësues qeveritarë, përfaqësues të OPAK dhe aktorë të tjerë të fushës për të marrë prespektiva të shumëllojshme mbi çështjen. Ka evidenca se një numër shkrimesh marrin në konsideratë zërin e advokuesve të aftësisë së kufizuar dhe se ata janë përfshirë në shkrim, gjë që është shenjë e mire. Në një shkrim mbi punësimin, "Punësim dhe jo bamirësi: Si të zgjidhësh problemet e jetës së një personi me aftësi të kufizuara" (Zaposlenje, a ne milostinja: Kako rešiti životni problem invalida), Politika, 21.10.2006, gazetarja interviston një numër aktorësh të ndryshëm në një lloj raporti investigues për të marrë një pamje më të plotë mbi këtë çështje. Gazetarja nis shkrimin me një intervistë të dy përfaqësuesve të ndryshëm të OPAK. Më tej ajo vijon me një hulumtim të iniciativave aktuale qeveritare mbi punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe përfundon shkrimin me një intervistë të një eksperti ligjor,

i cili kishte qenë pjesë e një studimi të mbështetur nga qeveria mbi punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe që ai vetë ishte person me aftësi të kufizuara, por kjo nuk përmendet në këtë shkrim. Po kështu, në një shkrim mbi një tryezë mbi uljen e varfërisë, si pjestarët qeveritarë, agjensitë ndërkombëtare donatore dhe pjestarët e shoqërisë civile citohen, përfshirë një advokues të lëvizjes së aftësisë së kufizuar ("Jeta në limitet e mbijetesës: seminar në palamentin e Serbisë", (Život na ivici egzistencije: Okrugli sto u Narodnoj Skupštini Srbije), Politika, 18.10.2006). Edhe pse gazetari përdor burime të ndryshme për lajmin advokuesi i aftësisë së kufizuar është cituar gabim.

Në Mal të Zi, ka pak shembuj të modelit shumë-vendimarrës në raportimin e aftësisë së kufizuar. Megjithatë në një shkrim mbi diskriminimin, "Diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara në aeroport" (Diskriminacija hendikepiranih na aerodromima), Pobjeda, 27.12.06, burimi kryesor i lajmit janë disa përfaqësues të shoqatës së të rinjve me aftësi të kufizuar, por gazetari kontakton gjithashtu zyrtarët e aeroportit për një reagim të tyre. Rezultati: gazetari realizon një vështrim të thellë tek problemet me të cilat ndeshen personat me aftësi të kufizuara gjatë udhëtimit, ndërkohë që prezanton praktikatat aktuale diskriminuese në udhëtimin ajror të personave me aftësi të kufizuara.

Duke vështruar mënyrat e ndryshme që gazetaret përdorin burimet e lajmit është e qartë se **mënyra më e mirë për një prespektivë më të gjerë mbi çështjet e aftësisë së kufizuar është ajo që gazetaret të bisedojnë me sa më shumë persona me aftësi të kufizuara që të jetë e mundur**. Duke marrë këndvështrimin e vetë personave me aftësi të kufizuara gazetaret e kanë më të lehtë të kuptojnë çështjet e aftësisë së kufizuar dhe të marrin një mesazh të qartë nga advokuesit e aftësisë së kufizuar. Megjithatë, kjo nuk vlen gjithnjë, pasi ka shumë raste që gazetari mund të intervistojë një përfaqësues të OPAK ose një person me aftësi të kufizuara në lidhje me një ngjarje, por zgjedh ti interpretojë fjalët e tyre ndryshe nga si janë thënë. Një rast i tillë vjen nga Goran Pavlivic, ish Drejtori Egzekutiv i ADS në Serbi. Ai shpjegon se kur ishte intervistuar nga një gazetar mbi çështjen e fuqizimit, në vend që të merrte foton e tij, gazetari donte të fotografonte dikë në karrigen me rrota me një gomë të shpuar. Në vend që të kapte thelbin e mesazhit të Goran, gazetari donte një foto dramatike ku të tregohet një person me aftësi të kufizuara në një pozicion të vështirë. Për rrjedhojë është thelbësore për advokuesit e aftësisë së kufizuar që të tregohen vigjilent në përhapjen e mesazheve të tyre përmes medias dhe në në qënurit të sigurtë se interpretohet dhe raportohet saktë.

Në shkrimet që fokusohen në prespektivën e qeverisë, prindërve ose profesionsitëve apo kujdestarëve dhe jo mbi personat me aftësi të kufizuara, këto shkrime nuk janë realisht mbi aftësinë e kufizuar, por mbi mënyrën se si personat pa aftësi të kufizuara trajtojnë çështjet e aftësisë së kufizuar. Kur një person me aftësi të kufizuara është personazhi kyç i shkrimit është edhe një person jo me aftësi të kufizuara që përfshihet në shkrim, sikur kjo të ofronte vërtetësi. Është inkurajuese, megjithatë, kur sheh se ka një rritje të numrit të shkrimeve të shkruara sipas prespektivës së advokuesve të aftësisë së kufizuar. Megjithatë, ka ende shumë punë për ta bërë zërin e personave me aftësi të kufizuara të përfaqësohet tërësisht në median e shkruar.

Në vijim është një shembull i praktikave të mira në drejtim të përdorimit të burimeve të shumëllojshme:

"BOBIĆ: QARTËSIM I DETYRIMEVE LIGJORE" (BOBIC: POJASNITI ZAKONSKE OBAVEZE), Danas, 22.11.06

Departamenti për mbrojtjen sociale dhe të fëmijës dhe arkitekti i qytetit studiojnë zhgjidhje për kapërcimin e barrierave që pengojnë lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara.

Problemet me të cilat ndeshen personat me aftësi të kufizuara në lëvizien e tyre të përditëshme kur ecin në trotuare, nënkalime, transportin publik, ose në hyrjen në institucione të cilave u mungojnë platformat e pjerrëta dhe ashensorët, shpejt do të jenë të kapërcyera.

–Pengesat me të cilat ndeshen personat me aftësi të kufizuara gjatë aktivitetit të tyre të përditëshëm dhe në institucione duhet të hiqen në periudhën afatshkurtër, dhe për rrjedhojë të lehtësohet e drejta e tyre bazë për të marrë pjesë të barabartë në jetë. Ne do të hartojmë plane veprimi në bashkëpunim me shoqatat e personave me aftësi të kufizuara, të cilat do të përcaktojnë prioritetet si edhe institucionet që duhet të përmirësojnë aksesueshmërinë e tyre. Bashkia do të fillojë të instalojë platforma të pjerrëta dhe ashensorë në ndërtesa që

janë në juridiksionin e saj, por bashkëpunimi me shtetin që është përgjegjës për institucionet administrative do të jetë i nevojshëm- tha Ljiljana Lučić, sekretare e bashkisë për mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve.

Ajo shtoi se ishte arritur marrëveshja me disa kompani të shërbimeve publike dhe se gjatë 2007 do të përshtaten 17 qendra të kujdesit shëndetësor për të qenë të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara; GSP (kompania e transportit publik të qytetit) gjatë blerjes së autobuzëve të rinj do të blejë vetëm autobuzë me dysheme të ulët dhe "shërbimi i parkimit" ka lehtësuar tashmë parkimin për personat me aftësi të kufizuara.

Arkitekti i Bashkisë Đorđe Bobić tha se gjatë projektimit të ndërtesave të reja egziston dëshira e mirë për të përfshirë nevojat e personave me aftësi të kufizuara në këto projekte, por ai përmend gjithashtu që rregullat përkatëse nuk janë mjaftueshëm të forta dhe nuk praktikojnë sanksione.

–Me qëllim që një projekt të marrë lejen e ndërtimit dhe të shfrytëzimit duhen edhe 42 leje të tjera që duhet të merren nga "shërbimi i parkimit" dhe kompanitë e shërbimeve publike, etj, por nuk shkruhet diku që lejet duhet të mirratohen nga një departament i mbrojtjes sociale ose nga ndonjë njësi tjetër që do të përfaqësonte nevojat e personave me aftësi të kufizuara.

Në buxhetin e bashkisë ka disa fonde me qëllim kapërcimin e barrierave, por duhet të ndërmerren aktivitete të përshtatshme.- nënvijëzon Bobić.

Gjatë ndërtimit të rrugëve dhe ndërtesave të reja, këto çështje janë marrë kryesisht në konsideratë, thotë Bobić, por problemi qëndron tek ndërtesat e vjetra dhe rrugët ku nuk janë planifikuar projekte rindërtimi. Sipas fjalëve të tij, atje duhet të ndërtohen platforma të pjerrëta dhe ashensorët e duhur, pragjet e trotuarëve duhet të ulen në nivelin e rrugës dhe sinjalet akustike duhet të vendosen gjithashtu.

Në emër të unionit të pesonave me disrtofi muskulare Ivanka Jovanović thekson se të drejtat e personave me aftësi të kufizuara aktualisht rregullohen nga vetëm një ligj – ai mbi ndalimin e diskriminimit mbi bazën e aftësisë së kufizuar, dhe se edhe ky duhet të ndryshojë.

– Në fushën e arsimimit ka gjithashtu probleme lidhur me aksesueshmërinë në shkolla dhe fakultete, të cilat duhet të zgjidhen së shpejti – thonë Vesna Mirović-Pjevač, zëvendës sekretare për arsimin dhe përfaqësuesit e studentëve me aftësi të kufizuara.

të verbrit dhe personat me dëmtime shikimi i jknë harruar nga të gjithë.

Tihomir Nikolić, një nga bashkë-qytetarët tanë që ka dëmtime shikimi na kujtoi se kur personat flasin për personat me aftësi të kufizuara ata zakonisht mendojnë në kuptimin e dëmtimeve fizike dhe kanë tendencën të harrojnë të verbërit. Ai thotë se ka probleme gjatë levizjes së përditshme- si për shembull në gjetjen e stacionit të autobuzit apo hyrjen në disa institucione, gjetjen e kalimit për këmbësorët, ose hyrjen e nënkalimeve dhe e gjithë kjo për shkak të mosegzistencës së seksioneve për të verbrit dhe sinjalistikës audio".

IV. SI PORTRETIZOHET AFTËSIA E KUFIZUAR NGA MEDIA E SHKRUAR

Në masë të gjerë, aftësia e kufizuar shihet nga media e shkruar si një çështje e mirëqënies sociale që kërkon reforma ligjore, shërbime tejet mbrojtëse, dhe ndryshime në përfitimin e mbrojtjes sociale. Megjithatë, aftësia e kufizuar rrallë diskutohet nga media e shkruar nën këndvështrimin e vetë personave me aftësi të kufizuara mbi çështjet që janë në interesin e tyre. Në shumicën e rasteve është një vështrim i aftësisë së kufizuar përmes lenteve të popullsisë pa aftësi të kufizuara që e sheh aftësinë e kufizuar si “të tjerët”. Kështu për shembull, rrallë gjen një shkrim mbi një çështje të jetës së përditshme me të cilën ndeshet popullsia, të rëfyer sipas këndvështrimit të një personi me aftësi të kufizuara (psh, reportazhe, sporti, kultura, arti, etj...)

Përse është e rëndësishme zgjedhja e temës?

Shqyrtimi i temave specifike që zgjedhin gazetarët për të pasqyruar kur raportojnë mbi çështje që lidhen me aftësinë e kufizuar është e rëndësishme të kuptohet se si prezantohet aftësia e kufizuar për konsumim nga publiku i gjerë. Nëse gazetarët shkruajnë për pensionet e aftësisë së kufizuar dhe përfitimet sociale që u nevojiten personave me aftësi të kufizuara ose zgjedhin të raportojnë mbi Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si edhe arritjeve nga lëvizja e aftësisë së kufizuar, kjo mund sjell një ndryshim të madh në mënyrën se si publiku e percepton aftësinë e kufizuar. Ashtu siç shkruan Beth A. Haller, “mënyra se si lajmet që lidhen me aftësinë e kufizuar luhen në media mund të ndikojë mbi opinionin publik rreth çështjeve që lidhen me aftësinë e kufizuar dhe në drejtim të përfaqësimit kulturor të personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi.”²⁶ Me fjalë të tjera, mënyra se si prezantohet aftësia e kufizuar nga gazetarët është thelbësore për ti treguar publikut se si të mendojë lidhur me çështje të caktuara. Në fakt, disa analistë të medias besojnë se mënyra se si gazetarët e prezantojnë një çështje dhe temat që zgjedhin për të shkruar kur i adresohen kësaj çështje lidhen me hartimin e axhendës: “Si përzgjedhja e temave për axhendë e lajmeve dhe përzgjedhja e llojit të lajmit lidhur me këto tema janë role të rëndësishme në hartimin e axhendës dhe përgjegjësi të mëdha etike.”²⁷

Fokusi i artikujve mbi aftësinë e kufizuar në të tre vendet është rreth:

- Përfitimet nga aftësia e kufizuar
- Reforma ligjore (p.sh. amendamentet ligjore lidhur me mbrojtjen sociale, pensionin e aftësisë së kufizuar, punësimin dhe anti-diskriminimin)
- Arsimi përfshirës, shkollat speciale dhe qendrat e kujdesit ditor
- Veprimtaritë e OPAK-ve
- Ndhurma humanitare

Cilat modele të aftësisë së kufizuar përdoren nga shtypi i shkruar?

Modeli mjekësor apo modelim i mirëqënies sociale

“Personat me aftësi të kufizuara kanë nevojë jo vetëm për karantinë mjekësore por edhe mundësitë për të qenë pjesë e shoqërisë.”

²⁶ Beth Haller, ibid: 2.

²⁷ Siç citohet nga Beth Haller, Maxwell McCombs, “Explorers and surveyors: Expanding strategies for agenda-setting research,” 69:4, *Journalism Quarterly*, (1992): 813-824.

- Drejtuesi i një OPAK-u citohet në "Punësim dhe jo bamirësi: Si të zgjidhim problemet jetësore invalidëve" (Zaposlenje, a ne milostinja: Kako rešiti životni problem invalida), Politika, 21.10.2006

Pjesa dërmuese e artikujve në të tre vendet fokusohen në modelin mjekësor ose në atë të mirëqënies sociale në kërkim të shërbimeve speciale për përkujdesje ndaj personave me aftësi të kufizuara, si për shembull institucionet rezidenciale dhe shkollat speciale ose preokupim për përfitimet nga aftësia e kufizuar. Është një numër i madh artikujsh të botuar në shtyp mbi qendrat e kujdesit ditor dhe arsimin përfshirës, por ato shihen përgjithësisht përmes lenteve të modelit të bamirësisë ndërsa profesionistët dhe autoritetet lokale i përshkruajnë fëmijët me aftësi të kufizuara si përfitues në nevojë të iniciativave bamirëse. Në shtypin e shkruar mund të gjenden disa modele të modelit social, por ato përgjithësisht vijnë nga OPAK-ë dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile.

Në të tre vendet, **aftësia e kufizuar diskutohet gjerësisht në shtypin e shkruar si çështje e mbrojtjes sociale** me shumicën e artikujve që mbulojnë pensionet, përfitimet nga aftësia e kufizuar dhe rishikimin e legjislacionit për mbrojtjen sociale. Artikuj si, "120 kërkesa në muaj: Importimi i automjeteve për personat invalidë" (Za mesec dana 120 zahteva: uvoz automobila za osobe sa invaliditetom), Politika, 12.03.2006, në të cilin gazetari e përshkruan procesin për çlirimin nga pagesa e taksës doganore për disa kategori të personave me aftësi të kufizuara mbi makinat e importuara, e pasqyrojnë këtë tendencë në mënyrë të qartë. Në tekst, gazetari përdor terma tepër mjekësorë si: "persona me dëmtime fizike nga 70 – 100%" dhe "kategoria më e rëndë e invalidëve".

Çështja e aftësisë së kufizuar që ka mbulimin më të gjerë në Bosnjë Hercegovinë është debati mbi pensionin e aftësisë së kufizuar dhe përfitimet për veteranët e luftës me aftësi të kufizuara dhe të personave me aftësi të kufizuara që nuk bien në këtë kategori (termi i përdorur në kontekstin lokal është "Invalidë jo të luftës").

Artikulli "Zbatimi i ligjit mbi invalidët civilë dhe invalidët e luftës" nga (Implementacija zakona o civilnim invalidima i zrtvama rata) Dnevni Avaz 14.09.06, është një shembull i mirë mbi fokusin e rëndë mbi përfitimet nga aftësia e kufizuar që publikohen në shtyp si lajm i mirë. Artikulli prezantohet nga këndvështrimi qeveritar dhe fillon me një citim nga Ministri i Ministrisë Federale për Çështje Sociale që shpjegon se ka shumë më shumë përfitues të përfitimit të invaliditetit nga ç'ishte parashikuar. Artikulli vazhdon të shpjegojë se si punojnë komisionet mjekësore për të vlerësuar përqindjen e dëmtimit të individit për të përcaktuar përfitimin e invaliditetit që u takon. Gjuha e përdorur në tekst për të përshkruar këtë çështje është tejet mjekësore duke përfshirë terma të tillë si: komisione mjekësore të përbëra nga mjekë, vlerësimi i invalidëve dhe dëmtimeve. Mesazhi i dhënë nga ministri është se kjo rritje e numrit të përfituesve do të ketë ndikim në buxhet. Në artikull nuk citohen të tjerë dhe gazetari e prezanton çështjen vetëm nga këndvështrimi qeveritar.

Në Serbi ka një numër të konsiderueshëm artikujsh që fokusohen mbi reformën e mbrojtjes sociale nga perspektiva e modelit mjekësor. "Manipulime me tenderin për pajisje mjekësore" (Namestaju tender za medicinska pomagala), 15.02.06, Blic, mbulon debatin mbi tenderat për pajisje ndihmëse të zhvilluar nga Instituti Republikan i Sigurimeve Shëndetësore. Në mënyrë të ngjashme, në "Errësira është edhe më e erët: të drejtat e refugjatëve të verbër dhe me dëmtime shikimi" (Mrak još mračniji: Prava slepih i slabovidih izbeglih lica), Politika, 29.01.06, gazetari tregon se si refugjatët me aftësi të kufizuara nuk mund të marrin përfitim të aftësisë së kufizuar. Të dy artikujt i paraqesin këto çështje nga këndvështrimi i mirëqënies sociale duke përdorur terminologji mjekësore si për shembull kategorizimet dhe përqindjet e dëmtimit dhe përforcojnë idenë se personat me aftësi të kufizuara varen nga këto përfitime. Megjithatë, në Serbi, ka patur më shumë artikuj mbi reformën legjislative, veçanërisht lidhur me adoptimin e legjislacionit kundër diskriminimit dhe hartimin e Strategjisë Kombëtare të aftësisë së kufizuar, të cilat ndodhën që të dyja në vitin 2006.

Ka artikuj të ngjashëm edhe në Malin e Zi, si për shembull, "Kapaciteti për punë i vlerësuar në përputhje me kriteret mjekësore" (Ocjena radne sposobnosti po medicinskim kriterijumima), Pobjeda, 14.01.06, ku përshkruhet se si grupet e vlerësimit për vlerësimin e kapacitetit për punë përdorin metoda plotësisht mjekësore gjatë vlerësimit të tyre. I intervistuari thotë se këto Komisione u vënë rëndësi kriterëve mjekësore sa më shumë që të mundin kur bëjnë vlerësimin e kapacitetit për punë të një personi me aftësi të kufizuara. Gjuha e përdorur në tekst përdor terma mjekësorë që përfshijnë "60% invalid" dhe "100% invalid".

Aftësia e kufizuar si kosto

Këta artikuj evokojnë një mesazh të qartë se aftësia e kufizuar është kosto ose barrë për shtetin. Kjo gjë i jep jetë stereotipit se personat me aftësi të kufizuara janë të paaftë për të marrë pjesë në jetën e përditëshme dhe se ata kanë nevojë për kujdes të veçantë ose të ardhura shtesë. Ai nuk njeh faktin se me mbështetjen e duhur, personat me aftësi të kufizuara mund të arrijnë autonomi dhe pavarësi, por përkundazi fokusohet në harxhimet e burimeve shtetërore. Artikulli “Me mijëra invalidë kanë nevojë për ndihmë” (Hiljadama invalida neophodna pomoc) Nezavisne Novine, 03.12.2006 është një shembull i shkëlqyer i këtij stereotipizimi pasi i përshkruan personat me aftësi të kufizuara si plotësisht të varur nga shteti. Në një artikull të ngjashëm, “Mbrojtja sociale në federatë: Të moshuarit dhe të dobët janë përgjegjësi e kantonit” (Socijalna zaštita u Federaciji: Stari i iznemogli su obaveza kantona), Oslobođenje, 13.01.07, rreth të drejtës së përfitimit për personat të cilët janë të dëmtuar në masën “60%”. Në shumë nga këta artikuj, aftësia e kufizuar dhe personat me aftësi të kufizuara paraqiten si barrë për shtetin ose si kosto ndaj shoqërisë. Ka shumë shembuj artikujsh ku çështja e aftësisë së kufizuar shoqërohet me një kosto të caktuar ndaj shtetit dhe taksa-paguesve si për shembull përfitimet që vijnë nga aftësia e kufizuar. Për të ilustruar këtë paradigmë, shumë nga titujt e mëposhtëm e artikulojnë në mënyrë të qartë aftësinë e kufizuar si kosto:

- “Shteti u detyrohet invalidëve 180 milion dinarë” (Država duhuje invalidima 180 miliona dinara), Danas, 04.10.06
- “Për invalidët 180 milion dinarë” (Za invalide 180 miliona dinara), Danas, 23/06/200
- “1.6 milion euro për transformimin e institucioneve” (Za transformaciju ustanova 1,6 miliona evra), Danas, 20.06.06
- “Më pak pensione invaliditeti pasi shteti i ka harxhuar burimet” (Manje invalidske penzije zato što je država potrošila sredstva), Oslobođenje, 06.06.06
- “Parlamentarët fusin në xhep paratë e invalidëve” (Parlamentarci opljačkali džeparac invalida), Glas Javnosti, 25.06.06
- “Invalidëd gllabëruan të gjitha fondet për fëmijët” (*Invalidi pojeli dječiji doplatak*) Oslobođenje, 22.07.06

Në artikullin, “Numri i kërkesave për përfitime po rritet: Vënia në zbatim e ligjit për invalidët civilë dhe të atyre të plagosur gjatë luftës” (Povećava se broj zahtjeva za priznavanje prava: Implementacija zakona o civilnim invalidima i žrtvama rata), in Dnevni Avaz, 14.09.06, fokusi i artikullit bie mbi numrin në rritje të përfituesve të pensionit të aftësisë së kufizuar dhe se si kjo do të ndikojë mbi buxhetin e shtetit. Artikulli është shkruar nga këndvështrimi i qeverisë dhe thekson se rritja e numrit të përfituesve të pensionit të aftësisë së kufizuar do të ketë rol negativ mbi buxhetin. Në artikull është edhe një tabelë në të cilën gjendet lista me numra të përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe impakti i drejtpërdrejtë që ata do të kenë mbi buxhetin federal. Në të njëjtën mënyrë, artikulli, “120 kërkesa në muaj: Importi i automjeteve për personat invalidë”, (Za mesec dana 120 zahteva: Uvoz automobila za osobe sa invaliditetom), Politika, 12.03.2006, është një shembull i qartë se si aftësia e kufizuar shihet si çështje e mirëqënies sociale ndërsa personat me aftësi të kufizuara klasifikohen jo vetëm nga dëmtimi i tyre, por edhe nga përqindja e dëmtimit. Artikulli përcakton qartë sasinë e lehtësimit nga taksat që duhet të paguajë personi në varësi të tipit dhe përqindjes së dëmtimit duke përdorur gjuhë të tillë si, persona me dëmtime fizike nga 70 –100%, invalidë lufte, civilë viktimë të luftës, të verbër, persona që vuajnë nga distrofia muskulare, prindër të fëmijëve me dëmtime të shumëfishta dhe invaliditet tepër i rëndë.

Në shkrimin “Duke dëmtuar personat me aftësi të kufizuara” (Opstrukcija invalida) in Oslobođenje, 12.01.07, një përfaqësues i OPAK shpjegon se përfitimet nga aftësia e kufizuar nuk shpërndahen njësoj mes veteranëve të luftës me aftësi të kufizuara kundrejt “personave me aftësi të kufizuara jo për shkak të luftës” ose personave me aftësi të kufizuara që nuk i përkasin kësaj kategorie. Gazetari prezanton sasinë e fondeve që qeveria investon për secilin prej dy grupeve duke cituar këto shifra:

- 60 milion KM ishin planifikuar për veteranët e luftës me aftësi të kufizuara
- 30 milion KM u shpenzuan në total për të përballuar nevojat e 12.000 personave me aftësi të kufizuara jo për shkak të luftës që ishin rregjistruar zyrtarisht gjatë vitit të kaluar
- Instituti i Vlerësimit Mjekësor analizoi 16000 kërkesa
- 42000 kërkesa për vlerësim prisnin në institut për vlerësimin mjekësor

Thelbi i shkrimit qëndron qartësisht në shpërndarjen e pabarabartë të përfitimeve, por duke listuar shpenzimet qeveritare dhe numrin e përfituesve, mesazhi që nënvizohet është se aftësia e kufizuar është e shoqëruar me kosto.

Protestat e veteranëve të luftës me aftësi të kufizuara shpesh prezantohen në medianë shkruar si në shkrimin “Protesta: A kanë veteranët e luftës të drejtën e një jete normale?” (Protestni skup: imaju li invalidi pravo na normalan život?) në Oslobodjenje, 09.06.06, shkrim që përqëndrohet tek një protestë e organizuar nga veteranët e luftës me aftësi të kufizuara që kërkonin përfitimet që u takonin. Edhe në shkrimin “Ish luftëtarët për një qeveri që nuk duket: shumë kolltuqe, shumë kandidatë!” (Bivši borci o vlasti koje nema: Fotelja malo, kandidata previše!) në Oslobodjenje, 25.12.06, Presidenti i Bashkimit të ushtarëve me aftësi të kufizuara dhe pjestarë të ndryshëm të veteranëve të luftës me aftësi të kufizuara, përfshirë anëtarët e luftëtarëve të verbër të ushtrisë boshnjake, citohen në shkrim gjatë diskutimit të përfitimeve të aftësisë së kufizuar dhe ankesave për korrupsion për shkak të të cilave ata nuk kanë marrë ato çfarë u takojnë. Toni i shkrimit është akuzues dhe një përfaqësues i unionit citohet të ketë thënë: “Politikanët nuk janë aspak të interesuar se egziston mundësia që personat me aftësi të kufizuara të mos marrin ato çfarë i takojnë dhe arsye e këtij mosinteresi është fakti që ata i kanë llogaritë e tyre të majme nëpër banka. Kur i shoh ata dhe ato çfarë bëjnë, më vjen në mend shprehja popullore: është më mirë të kesh një gram pushtet se sa një kunjta liri”

Shumë shkrime japin shifra se sa i kushtojnë shtetit personat me aftësi të kufizuara në drejtim të përfitimeve dhe/ose papunësisë. Për shembull, në shkrimin “Për aftësinë e kufizuar të plotë: 13900 dinarë” (Puna invalidska penzija 13,900 dinara) në Politika, thuhet, “Në Serbi ka 100000 persona me aftësi të kufizuara, por vetëm 5-10% e tyre pritet të kenë të drejtën e rritjes së përfitimit, pasi kriteri bazë është që personi duhet të jetë 100% me aftësi të kufizuara”

Ose në një shkrim tjetër, “Duke penguar personat me aftësi të kufizuara” (*Opstrukcija invalida*) Oslobodjenje, 12.01.07, gazetari liston kostot e përfitimit të aftësisë së kufizuar duke përdorur shifrat:

- 60 milion KM ishin planifikuar për veteranët e luftës me aftësi të kufizuara
- 30 milion KM u shpenzuan në total për të përballuar nevojat e 12.000 personave me aftësi të kufizuara jo për shkak të luftës, që ishin rregjistruar zyrtarisht gjatë vitit të kaluar.

Me kaq shumë shkrime që fokusohen tek kostot ekonomike të aftësisë së kufizuar, është e thjeshtë për publikun që të marrë mesazhin se aftësia e kufizuar është barrë financiare. Për më tepër, ky nocion thjesht nxit stereotipin se personat me aftësi të kufizuara janë të paaftë për të qenë pjestarë produktivë të shoqërisë dhe për rrjedhojë, në nevojë për përfitime shtetërore. Së fundi, duke qenë se personat me aftësi të kufizuara portretizohen nga numra dhe shifra, u jep atyre një rol pasiv në debat si objekte të planifikimit të buxhetit të shtetit.

Arsimi

Një nga temat që trajtohet më shumë në medianë shkruar është arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe në veçanti, debati mbi arsimin përfshirës. Ajo që është e qartë nga konkluzionet është egzistenca ende e një modeli tepër mbrojtës në arsimim. Edhe kur aktorët diskutojnë për arsimin përfshirës ka konfuzion mbi atë çfarë nënkupton ai dhe se si do të zbatohet me tendencën për tu kthyer tek nevoja për klasa speciale dhe shkolla speciale me shqetësimin se si duhet të kujdesen profesionistët për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Kjo tendencë duket qartë në shkrimin, “Me dashurinë e tyre: u japin më të mirën fëmijëve” (Ljubavlju izvlace najbolje iz dece), Blic, 13.06.06, drejtori i një shkolle speciale shpjegon se si punojnë punonjësit e tyre social: “Rreth dhjetë fëmijë nuk kanë zhvilluar ende edukatën bazë higjienike dhe infermieret kujdesen për ta çdo ditë... Janë 17 defektologë, një psikolog, një pedagog i veçantë, një terapist i të folurit, dy profesorë të edukimit fizik dhe tre inferimere që punojnë në shkollë me fëmijët...Ne i japim më të mirën çdo fëmije.” Gazetari citon një nga mësuesit që përshkruan jetën e fëmijës në shkollë: “Jo më larg se dhjetë vjet më parë Vule, shtatë vjeçar që vinte nga Shtëpia e Rrugës Zvečanska u rregjistrua në shkollën tonë. Pas kategorizimit u vendos që ai të dërgohej në Shtëpinë për Fëmijët dhe të Rinjtë me aftësi të kufizuara në Sremcica për shkak të një tipi të

veçantë autizimi. Kishte diçka të veçantë në sytë e atij fëmije që më siguroi se nëse do të qendrote në shkollën tonë ai do të kishte një shans.”

Në të njëjtin shkrim, ka një nëntitull “Vule brenda një qeseje” ku gazetari shkruan: “Mësuesit e vjetër ende tregojnë historinë mbi Vulen e vogël që e kishin futur në qesen plastike dhe e kishin lënë pranë koshit të plehrave, i cili përfundoi shkollën fillore me sukses në Anton Skala... Vule nuk i takoi kurrë prindërit e tij, në moshën shtatë vjeçare ai kishte ndërruar shtatë familje dhe nuk i jepte fare rëndësi botës përreth. Ishte gjithnjë i uritur, fshihte bukë në këmbë dhe nëpër xhepa dhe sillej si një kafshëzë e vogël. Në klasën e dytë ai filloi të flasë dhe arriti të mësojë të gjithë tabelën e shumëzimit vetëm për dy ditë.” Përveçse ka një model tepër mjeksor, toni i shkrimit nënvizon idenë se profesionistët e dinë se çfarë është më e mirë dhe se ata janë në gjendje të “trajtojnë” ose “zbusin” personat me aftësi të kufizuara për ti bërë ata më pak të egër dhe më “normal”.

Në “Prindërit po përgatisin një ankesë kundër Ministrit Turkušić” (Roditelji podnose krivičnu prijavu protiv ministra Turkušića), Oslobođenje, 14.10.06, pavarësisht se është një shkrim mbi arsimin përfshirës, një psikolog, një difektolog dhe një drejtor i një shkolle speciale janë të vetmit persona të intervistuar për të diskutuar vështirësitë në zbatimin e “kësaj situatë të çuditëshme të quajtur përfshirje” siç thotë njëri prej difektologëve. Një defektolog tjetër citohet të ketë thënë “...duket se kjo përfshirje është kafshatë e madhe për ne...”

Është e qartë se në shkrim ka një konfuzion mbi kuptimin e arsimit përfshirës dhe kjo çështje ende shihet me sytë e një modeli mjeksor tepër mbrojtës. Ky konfuzion mbi arsimin përfshirës theksohet në shkrimin “Ne kemi një punë me përgjegjësi, por të bukur” (Radimo odgovoran ali i prekrasan posao) në “the Reporter”, 27/09/2006. Gazetari interviston dy mësues të një shkolle që është pjesë e programit mbi përfshirjen, ku fëmijët janë një një klase speciale brenda një shkolle të rrymëzuar. Mbi përfshirjen një nga mësuesit thotë: “Ju them si një person që ka punuar në klasë speciale për 20 vjet se ju duhet të zgjidhni mirë se cili fëmijë mund të përfshihet në arsimin përfshirës.”

Ka gjithashtu një numër shkrimesh mbi qendrat e kujdesit ditor që kanë një këndvështrim mjeksor ose tepër proteksionist. “Një ndërtesë e re për personat me nevoja të veçanta” (*Novi objekat za osobe s posebnim potrebama*) *Nezavisne Novine*, 30.09.06, është një shkrim mbi planet për të ndërtuar një kopësht special për fëmijët me aftësi të kufizuara për ti veçuar nga shkollat fillore të rrymëzuara. Kryetari i Bashkisë Brčko tregohet duke u shpërndarë dhurata fëmijëve të identifikuar si në nevojë për këtë qendër speciale. “*Nega od dva do 15 dana: Prvi objekat za kratkotrajni smeštaj osoba sa invaliditetom u Vojvodini*”, *Politika*, është shkrim mbi hapjen e një qendre kujdesi ditor që do të përdoret kur familjet me një pjestar me aftësi të kufizuara shkojnë për pushime dhe ata mund ta lënë këtë pjestar në qendrën ditore. Gazetari e fillon shkrimin duke thënë: “Familjet nga Bačka Topola që kanë pjestarë me aftësi të kufizuara dhe që kanë nevojë për kujdes ditor, më së fundi do të kenë mundësinë të mendojnë edhe për pushime.” Në shkrimin “Dhoma speciale për fëmijët me autizëm” (*Specijalna soba za decu sa Autizmom*), *Blic*, 17.02.06, profesionistët flasin mbi rëndësinë e krijimit të qendrave ditore speciale për fëmijët me autizëm. Sërisht, vihet theksi tek mendimi i profesionistëve dhe se pse masat e specializuara janë të rëndësishme pa përmendur mundësinë e përfshirjes.

Megjithatë ka disa shembuj të mirë të arsimit përfshirës. Për shembull, në «Si të gjesh një shkollë që u përshatet të gjithë fëmijëve: takim mbi arsimin përfshirës» (Kako do škole po meri deteta: Skup o inkluzivnom obrazovanju), *Politika*, 24.05.2006, që prezanton një tryezë të zhvilluar mbi arsimin përfshirës, gazetari jep një prespektivë të gjerë të kësaj çështje. Shkrimi prek rezistencën ndaj përfshirjes pasi një profesor në këtë veprimtari paralajmëron për qëndrimet negative të profesionistëve të tjerë, të tillë si mësues, psikologë dhe defektologë që janë kundër reformës. Për fat të keq asnjë nga komuniteti i aftësisë së kufizuar nuk citohet në tekst. E njëjta gjë vlen për shkrimin “Aftësia e kufizuar është arsye për vëmendje dhe jo për izolim” (*Hendikep je razlog za paznju, a ne izolaciju*), *Pobjeda*, 13.08.06. Ndërkohë që jep një vështirësi të shpejtë mbi reformat e arsimit përfshirës në Maqedoni, vetëm profesionistët e arsimit dhe ekspertët citohen në tekst dhe nuk ka ndonjë vështrim mbi atë çfarë thonë advokuesit e aftësisë së kufizuar mbi këtë çështje.

Në Malin e Zi, kishte mbulim shumë të dukshëm mbi arsimin përfshirës dhe egziston një ton pozitiv mbi reformën e arsimit përfshirës. Artikuj të tillë si, “Fëmijët me handicap përfitojnë mësues” “Djeca sa hendikepom dobijaju nastavnike”, *Dan*, 16.09.06 flasin pozitivisht mbi reformat arsimore në Malin e Zi dhe gazetari bën një

vëzhgim të gjerë mbi këto çështje. Në mënyrë të ngjashme, në, "Të drejtat e fëmijëve duhet të jenë më të rëndësishmet" (Djecija prava neka budu najvaznija), Pobjeda, 25.08.06, gazetari diskuton mbi arsimin përfshirës në kuadrin e të drejtave të fëmijëve. Në, "Diversiteti si pasuri, jo si handicap" (Razlicitost kao bogatstvo, a ne hendikep), Pobjeda, 21.11.06, artikulli diskuton mbi rëndësinë e arsimit përfshirës në Malin e Zi në referencë të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. Një tjetër shembull vjen nga artikulli, "Integrimi i fëmijëve me nevoja speciale" (Integracija djece sa posebnim potrebama), Pobjeda, 03.06.06, mbi reformat në arsimin përfshirës, por gazetari përdor terminologji ofensive dhe citon vetëm profesionistët e arsimit përkundrejt personave nga lëvizja e aftësisë së kufizuar.

Fëmijët me aftësi të kufizuara si barrë

Shumë shpesh në shtypin e shkruar në artikujt që lidhen me fëmijët me aftësi të kufizuara, **fëmija apo pjesëtari i familjes me aftësi të kufizuara përshkruhet si barrë**. Përdoren shpesh metafora për të përshkruar se si familjes i krijohet një barrë nga një pjesëtar i tillë dhe se si përbuzet nga komuniteti. Për shembull, në artikullin për nënën e një fëmije me aftësi të kufizuara, "Fëmijë të vetmuar jashtë vemendjes" (Usamljena deca: Na sporednom koloseku), Politika, 16.10.2006, flitet për një nënë të cilës fëmija i saj i është bërë barrë. Në këtë artikull, nëna citohet të thotë "Jeta me një fëmijë me probleme në zhvillim është punë e vështirë...kam një fëmijë me çregullime të shumëfishta në zhvillim, mendoni se pyet njeri për këtë? Jo, ky është problem vetëm i imi dhe i familjes sime. Kështu ndodh në praktikë. E ndiej se është barrë që duhet ta mbaj unë dhe familja ime." Ajo vazhdon, "Familjet me fëmijë me handicap janë gjithmonë në periferi... Është si një lloj destini apo fati që i ndjek ata çdo ditë dhe që nuk i kë kurrë të qetë.... Ato (familjet) marxhualizohen dhe shqetësimet e tyre i ndjekin ata dhe nuk i lënë kurrë të qetë." Gazetari më pas citohet të thotë: "Jeta me një fëmijë me handicap është tejet e vështirë.... Ky fëmijë i hedh sa andej këndeje gjithshka që gjen dhe bën shumë rrëmujë. Një fëmijë i shëndetshëm dhe aktiv është tjetër gjë, dhe tjetër gjë është të kesh një fëmijë hiperaktiv me shqetësime të shumëllojshme në zhvillimin e tij". Në mënyrë të ngjashme në artikullin "Kopështi i parë për fëmijë me nevoja speciale" (Prvi vrtić za djecu s posebnim potrebama), Nezavisne Novine, 03.07.06, të gjithë aktorët e intervistuar përfshi prindin e një fëmije me aftësi të kufizuara, nënvijëzojnë rëndësinë e këtij kopështi për ti lehtësuar prindërit nga kjo "barrë". Kjo temë gjen jehonë në "Nga mospranimi drejt integritit" (Od neprihvatanja do integrisanja), "the Reporter", 07.06.06 ku pasqyrohej shoqata e fëmijëve dhe të rinjve me nevoja speciale. Edhe pse presidenti i shoqatës flet për rëndësinë e integritit, ai citohet të ketë thënë: "Nëse ke një fëmijë me nevoja speciale, duhet ti dedikosh të paktën 3 herë më shumë fonde sesa për një fëmijë të shëndetshëm, prandaj çdo mbështetje financiare është e mirëpritur." Këto artikuj si shumë të tjerë që lidhen me përkujdesjen nga ana e prindërve për fëmijët me aftësi të kufizuara e thekson aftësinë e kufizuar si barrë për familjen dhe përshkruajnë marxhualizimin që përjetojnë familjet nga ana e komunitetit.

Modeli i bamirësisë

Ka një numër të madh **artikujsh të shkruar nga këndvështrimi i modelit të bamirësisë kryesisht duke evokuar keqardhjen e njerëzve** dhe dëshirën e mirë për të dhuruar para ose asistencë për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara. Për shembull, "Dhuratat janë të vogla por dashuria është e madhe" (Darovi mali, ali ljubav neizmerna) Danas, 06.01.06 përshkruan një parti politike që jep dhurata për personat që jetojnë në një institucion rezidencial. Në fund të artikullit, përfaqësuesi i partisë politike citohet të thotë:

"Pakot e ndihmave përbëhen nga artikujt më të nevojshëm për jetën e përfituesve në këtë institucion... Dhuratat janë modeste, por dashuria është e madhe. Këto mbledhje dhuratash përpara krishtlindjes janë bërë tashmë traditë. Objektivi i kësaj veprimtarie është të informojë publikun mbi gjendjen relativisht të varfër të fëmijëve në këtë institucion rezidencial – dhe në të njëjtën kohë është një lutje për të gjithë njerëzit zemërmirë që kanë mundësi të japin ndihmë..."

Në mënyrë të ngjashme, në shkrimin "Për ndërtimin e një institucioni për aftësinë e kufizuar pranë Travnik, fondet ishin të mjaftueshme vetëm për të hedhur themelet" (Izgradnja doma invalida u Turbetu kod Travnika Novac trajao samo do prve ploče), Oslobođenje, 20.02.06, një pjesëtar i shoqatës lokale kërkon fonde për të përfunduar ndërtimin e institucionit rezidencial. Drejtuesi i shoqatës që do ta ndërtojë institucionin kërkon fonde nga donatorët dhe përdor një ton tepër emocional për të rritur keqardhjen e lexuesve.

Në një tjetër shkrim “Personat me aftësi të kufizuara nuk kanë ku të akomodohen (Invalidi nemaju smjestaj) në Oslobodjenje²⁸, drejtuesi i një OPAK citohet:

“Unë shpresoj se ka njerëz që kanë shpirt të madh dhe të mirë dhe që do të na ndihmojnë të zgjidhim problemet që na shqetësojnë, pasi duke gjetur zgjidhjet për fëmijët tanë ne do të arrijmë të përmbushim misionin e jetës sonë dhe misioni ynë është të krijojmë mjedis dhe kushtet në të cilat këta fëmijë do të jetojnë gjatë jetës me prindërit e tyre dhe akoma më shumë pas vdekjes së tyre”.

Në Malin e Zi egziston një numër veçanërisht i madh shkrimesh që fokusohen tek donacionet dhe veprimet e bamirësisë gjatë shkrimeve mbi aftësinë e kufizuar. Shkrimi, “Një platformë e pjerrët e instaluar për personat përdorues të karrikeve me rrota” (Postavljena rampa za osobe sa kolicima) Pobjeda, 10.11.06, trajton instalimin e një platforme të pjerrët në përkujtim të Ditës Barazisë. Në këtë shkrim mbetet për tu diskutuar nëse në të ka ose jo një model bamirësie. Megjithatë, toni i shkrimit e paraqet ndërtimin e një platforme të pjerrët si një akt bamirësie.

Secila nga historitë e mëposhtme përshkruan disa lloj donacionesh për organizatat e personave me aftësi të kufizuara:

- “U dhanë dy kompjutera” (Dobili dva kompjutera), Dan, 22.08.06
- “Për qytetarët me nevoja speciale 82.000 euro” (Za gradjane s posebnim potrebama 82.000 Eura), Dan, 27.12.06
- “Promonte dhuroi një mijë euro” (Promonte poklonio hiljadu Eura), Pobjeda, 17.01.06
- “Veshje si dhuratë për rezidentët”(Odjeca na poklon sticenicima), Pobjeda, 19.03.06
- “Tavolinë tenisi dhuratë” (Sto za tenis na poklon), Pobjeda, 01.03.06.

Ideja e aftësisë së kufizuar si çështje bamirësie në mënyrë të vazhdueshme në median e shkruar është problematike. Në të gjitha këto shkrime theksohet keqardhja dhe tërhiqet vëmendja e lexuesit përmes toneve tejet emotive. Mesazhi i të gjithë shkrimeve është se personat me aftësi të kufizuar kanë nevojë për ndihmë.

Modeli social

Lajm i mirë është se ka shembuj të prezantimit të aftësisë së kufizuar në median e shkruar si një çështje e të drejtave të njeriut përmes këndvështrimit të modelit social. Kjo vjen zakonisht për shkak të punës së madhe të advokueve të aftësisë së kufizuar për ta përhapur mesazhin në media.

Tendenca e përgjithashme është se artikujt që paraqesin aftësinë e kufizuar nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut shkruhen nga advokuesit e aftësisë së kufizuar. Artikulli, “Kundër diskriminimit” (Protiv Diskriminacije) nga Gordana Rajkov në Blic, 04.12.06, është një shëmbull i shkëlqyer i një artikulli që hedh dritë mbi aftësinë e kufizuar nga këndvështrimi i modelit social duke sfiduar në këtë mënyrë stereotipin që personat me aftësi të barabarta janë të varur:

“Egziston një opinion dhe paragjykim i përgjithshëm se personat me aftësi të kufizuara nuk mund të jetojnë të pavarur dhe se ata kanë nevojë për asistencë nga të tjerët. ...Ne të gjithë varem tek njëri tjetri për të bërë punëra të ndryshme. Për të pasur një jetë të pavarur nuk do të thotë të jetosh vetëm dhe ti bësh të gjitha punët vetëm, por përkundrazi do të thotë të marrësh vendime të pavarura se kur dhe sa asistencë të nevojitet dhe se si të të jepet kjo asistencë....Prandaj është e rëndësishme që shteti të zhvillojë një politikë sociale të qëndrueshme që do të promovonte potencialin e personave me aftësi të kufizuara dhe të krijonte kushtet për ti përmbushur këto potenciale, dhe shërbimet e duhura mbështetëse që marrin në konsideratë nevojat individuale të përdoruesve, që janë disa nga parakushtet kyç në këtë proces.”

Në, “Nuk jemi koleksionistë bamirësie” (Reagovanja: Nismo sakupljaci milostinje), në një letër drejtuar redaksisë shkruar nga përfaqësuesi i një OPAK, autori thotë: “Ne nuk përdorim termin “handikapatë” por

²⁸ Nuk ka të dhëna për datën

persona me aftësi të kufizuara. Nuk është e vërtetë që çdo bamirësi është pasuri. Në nuk jemi lypësa dhe koleksionistë bamirësie, por persona me të drejta.”

Artikulli, “Për personat që nuk dëgjojnë dhe me vështirësi dëgjimi, Podgorica është një qytet me barriera” hedh dritë mbi çështjet me të cilat përballlet komuniteti i personave që nuk dëgjojnë, “Për shkak të mungesës së interpretuesve të gjuhës me shenja, personat që nuk dëgjojnë ndihen të izoluar dhe të vetmuar pasi nuk i kupton njeri në qytetin e tyre... është e nevojshme hartimi i një ligji mbi gjuhën e shenjave me qëllim që të ndalojë izolimin e personave që nuk dëgjojnë e që vazhdon prej dhjetra vitesh.”

Në artikullin, “Nxitje për jetesë të pavarur: Statusi i personave me aftësi të kufizuara” (Podstrek za samostalni život: Položaj osoba sa invaliditetom), Politika, artikulli jo vetëm përdor terminologji të përshtatshme në titull, por edhe diskuton reformat ligjore të nevojshme për të parandaluar diskriminimin.

Në vijim është një artikull që ilustron se si një organizatë mund ta përçojë në shtypin e shkruar mesazhin mbi aftësinë e kufizuar të parë në këndvështrimin e të drejtave të njeriut:

“DITË MË TË MIRA DO VIJNË PAS 15 VJETËSH” Intervistë me Goran Pavlović, Drejtor Ekzekutiv, Shoqata e Studentëve me Aftësi të Kufizuara, Danas, 06.11.2006

Asnjë fakultet i universitetit nuk është i aksesueshëm për studentët me aftësi të kufizuara në të gjithë territorin e Serbisë. Kjo nuk do të thotë se ata janë plotësisht të paaksesueshëm. Disa fakultete kanë instaluar platforma të pjerrëta, aty këtu mund të gjesh tualete të aksesueshme, po askund nuk mund ti gjesh dot të dyja bashkë. Fakulteti juridik në Beograd ka bërë ndoshta më shumë. Atje është instaluar një ashensor i cili e bën pjesën më të madhe të godinës të aksesueshme, por është tepër i vogël për disa përdorues të karrikeve me rrota, pra nuk mund të përdoret nga të gjithë studentët. Fakulteti i Matematikës dhe i Shkencave të Natyrës instaloi një platformë të pjerrët, por ajo është tepër e pjerrët dhe kështu praktikisht e paaksesueshme. Kjo do të thotë se qëllimi ishte i mirë, por mosnjohuri e mjaftueshme për këtë çështje. Sipas projektit të rikonstruksionit të rrugës Nemanjina në Beograd, parashikohej që të arrihej aksesueshmëri e plotë për personat me aftësi të kufizuara, por, tani që është përfunduar, ajo është e papërdorshme. Është një situatë absurde, për shembull, në fakultetin Teknik të Beogradit – është një platformë e pjerrët që të çon te salla qendrore, por prej aty asnjë pjesë tjetër e godinës nuk është e aksesueshme – thotë Goran Pavlović, Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës së Studentëve me Aftësi të Kufizuara për të përditëshmen Danas.

A mund të bëjë diçka shoqata për të bashkuar dëshirën dhe qëllimet e mira për të sjellë rezultate konkrete?

- Ne kemi filluar një iniciativë që do të zbatohet në partneritet me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Universitetin e Beogradit dhe Fakultetin e Arkitekturës për të përfunduar në fillim vlerësim e situatës aktuale në godinat universitare të Serbisë, dhe gjatë fazës së dytë të projektit, do të përgatitet një iniciativë mbi aksesueshmërinë, që do të planifikojë në detaj gjithçka që duhet bërë me qëllim që të gjitha fakultetet të bëhen të aksesueshme për të gjithë. Pas kësaj faze do të jetë e mundur për të llogaritur edhe shpenzimet. Kjo është një ndërmarje gjithëpërfshirëse- vetëm vlerësimi kërkon një periudhë tre vjeçare dhe më pas do të fillojë mbledhja e fondeve duke aplikuar si në donatorë lokalë dhe në nivel ndërkombëtar. Ne besojmë se për të qenë realistë duhet të presim që ky projekt të përfundojë pas 10 deri 15 vjetësh, kur të paktën, të gjithë fakultetet do të jenë me të vërtetë plotësisht të aksesueshëm për të gjithë studentët dhe që si rrjedhojë edhe mundësitë e barabarta për arsimim tu ofrohen të gjithëve pa përjashtim.

Sa i ndihmon legjislacioni vendas personat me aftësi të kufizuara?

–Praktika në të gjithë botën, por edhe këtu në Serbi ka treguar se hapi më i lehtë për tu ndërmarrë është adoptimi i ligjeve të përshtatshme, por pjesën më të vështirë e kemi ende përpara – për ti aritur këto në praktikë. Janë miratuar disa ligje në fushën e arsimit –ligji mbi arsimin e lartë për herë të parë në Serbi i merr në konsideratë personat me aftësi të kufizuara – që do të thotë se mjediset shkollore shtetërore detyrohen të sigurojnë mundësi të barabarta për studentët me aftësi të kufizuara. Ligji mbi Parandalimin e Diskriminimit ndalon diskriminimin në arsim, dhe është i nevojshëm miratimi edhe i ligjeve të tjera me qëllim printimin e librave në formate të përshtatshme me qëllim që edhe literatura të bëhet e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Mos ndoshta kjo do të thotë se adoptimi i këtyre ligjeve tregon se ka ndryshuar në njëfarë mënyre qëndrimi i shtetit kundrejt personave me aftësi të kufizuara?

– Në njëfarë mënyre fakti që shoqata jonë filloi punë gjashtë vjet më parë koinçidon me ndryshimet që ndodhën në Serbi. Ne besojmë se kemi kontribuar shumë për të sjellë ndryshime konkrete, të paktën në fushën që lidhet me arsimin e personave me aftësi të kufizuara. Ka ndryshim lidhur me qëndrimin e shtetit ndaj personave me aftësi të kufizuara – ne jemi bërë partnerë në inicimin e disa strategjive, jemi përfshirë promovimin e disa strategjive, dhe në komisione të ndryshme dhe bashkësive keshillimore me institucionet shtetërore ndërkohë që Shoqata është përfshirë drejtpërdrejt në hartimin e disa ligjeve.

Cili është qëndrimi i kolegëve dhe profesionistëve në drejtim të studentëve me aftësi të kufizuara?

–Vjet ne zhvilluam një anketim lidhur me situatën e studentëve me aftësi të kufizuara brënda projektit të Promovimit të Arsimit Përfshirës në Evropën Juglindore, ku u morrëm me problemet e aksesueshmërisë në fakultete si edhe qëndrimin e studentëve dhe pedagogëve në drejtim të personave me aftësi të kufizuara. Konkluzioni është se – gjithçka varet rast pas rasti. Përgjithësisht nuk ka probleme në marrëdhëniet me kolegët dhe profesorët. Një qëndrim disi më negativ vihet re në faktin që shumë pak kolegë janë të gatshëm tu ofrojnë asistencë personave me aftësi të kufizuara në çfardolëj fushe jashtë asaj të arsimit.

Një shtetër shembull pozitiv në raportimin e lajmeve lidhur me aftësinë e kufizuar nga pozicioni i të drejtave dhe antidiskriminimit është artikulli i mëposhtëm. Ai është një shembull pozitiv i pasqyrimin të lajmit lidhur me çështjen e aftësisë së kufizuar larg paradigmes mjekësore dhe të bamirësisë.

ASNJË GJOBË E VENDOSUR PËR DISKRIMINIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Tëtë muaj pas miratimit Ligji ka mbetur thjesht fjalë në letër

Glas Javnosti, 06.12.2006

Ligji ende nuk është zbatuar gjerësisht pasi publiku si dhe persona me aftësi të kufizuara nuk e dinë se në cilat raste mund ti drejtohen gjykatës, dhe se çfarë konsiderohet “situatë diskriminuese”.

BEOGRAD – Edhe pse kanë kaluar 7 muaj nga miratimi i ligjit mbi ndalimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, asnjë akuzë nuk është ngritur mbi bazën e këtij ligji. Ligji ende nuk është zbatuar gjerësisht në praktikë pasi sipas Violeta Kočić, avokate e organizatës joqeveritare Iz Kruga (Jashtë rrethit), qëllimi i të cilës është të ndihmojë personat me aftësi të kufizuara dhe publikun që nuk e di se në cilat raste mund ti drejtohet gjykatës dhe se çfarë konsiderohet “situatë diskriminuese”.

–Gjatë vitit në vazhdim ne do të takojmë të gjitha shoqatat e personave me aftësi të kufizuara për t’ua shpjeguar këtë ligj si dhe të gjitha situatat që mund të konsiderohen si veprime diskriminuese. Në praktikë diskriminimi i drejtpërdrejtë është shumë i rrallë dhe diskriminimi indirekt është më i shpeshtë, por është e vështirë të provohet në gjykatë. Në rastet kur është vendosur se një veprim i paligjshëm diskriminues është kryer kundër një personi me aftësi të kufizuar, ligji parashikon gjoba nga 5000 deri 50 000 dinarë për individët dhe nga 10 000 deri në 500 000 dinarë për entitetet ligjore, tha Kočić.

Ligji mbi ndalimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara parashiikon ndalimin e diskriminimit, mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara, sanksione për shkelësit, respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe rrit gjithashtu përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në proceset vendimmarrëse.

–Ka rreth 800 000 persona me aftësi të kufizuara në Serbi dhe mesatarisht një në katër persona preket direkt ose indirekt nga kjo gjëndje. Personat me aftësi të kufizuara nuk janë ndërr ata që vendosin për fatin e të drejtave të tyre, ata janë më të varfrit e të varfërve, nuk shkojnë në shkollë dhe nuk kanë kushte për tu përfshirë në arsimim dhe për rrjedhojë e kanë të vështirë të gjejnë punë. Shkollat janë të detyruara për tu ofruar kurikulën në Braille apo për të mësuar gjuhën me shenja. Egzistojnë kudo pengesa arkitekturore, ndërtesat nuk janë të aksesueshme, personat me aftësi të kufizuara janë viktima më shpesh sesa pa aftësi të kufizuara...E gjitha kjo tregon se duhet bërë diçka urgjentisht.- tha Lepojka Carević-Mitanovski e organizatës joqeveritare Iz Kruga.

Ndërkohë që është mirë të shohësh shembuj pozitivë të modelit social të prezantuar në median e shkruar, është e qartë se duhet bërë më shumë për ti qarkulluar shkrime të tilla në media. Edhe pse lëvizja e aftësisë së kufizuar ka shumë më tepër punë për të bërë me qëllim përhapjen e mesazheve të saj në media, gazetarët dhe profesionistët e medias duhet të kërkojnë më mirë lajme të tilla për të prezantuar sesa raportimin e përfitimeve tradicionale të aftësisë së kufizuar, të cilat siç e pamë mbizotëronin në median e shkruar.

V. SI PORTRETIZOHEN NGA MEDIA E SHKRUAR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Për këtë seksion të dokumentit ne ngremë pyetjen: Si i portretizon media e shkruar personat me aftësi të kufizuara? Përgjigja së pari nxjerr në pah se personat me aftësi të kufizuara në pjesën më të madhe nuk prezantohen në median e shkruar si individë; zakonisht ata grupohen në kategori dhe stereotipe. Në fakt shumë shpesh personat me aftësi të kufizuara identifikohen në shtypin e shkruar përmes dëmtimeve të tyre. Kjo vihet re edhe në Suedi, sipas studiuesit të medias Karin Ljuslinder, e cila në studimin e saj “Parë nga afër askush nuk është normal” shpjegon, “metoda gazetareske e portretizimit të së ndryshmes dhe jonormales” ka një ndikim negativ mbi personat me aftësi të kufizuara... ata identifikohen më shumë nga dëmtimet e tyre, aftësia e kufizuar, trupi tyre i ndryshëm dhe nga mosmundësia, sesa si nëna të fëmijëve të vegjël, pasagjerë, taksapagues ose konsumatorë.”²⁹

Stereotipet që përdoren në media shpesh mbizotërojnë këtë nocion të jonormales dhe ndryshimit. Sipas Colin Barnes, “pranimi i stereotipeve mbi personat me aftësi të kufizuara bazohet tek supersticioni, mitet dhe besimet nga epokat më pak të qytetëruara. Ato janë trashëguar në kulturën tonë dhe vazhdojnë të egzistojnë pjesërisht pasi riprodhohen vazhdoimisht përmes mediave”³⁰. Vazhdimi i përdorimit të stereotipeve nga media e shkruar vazhdon ti prezantojë personat me aftësi të kufizuara nga pozita të pabarabarta dhe vijon me etiketime diskriminuese.

Dokumenti nuk pretendon tu bëjë një analizë të thelluar të gjitha tipeve të ndryshme të stereotipeve që egzistojnë në median e shkruar në lidhje me aftësinë e kufizuar. Raporti përpiqet të tregojë disa nga stereotipet kryesore që shfaqen në median e shkruar. Disa nga stereotipet kryesore që shfaqen në median e shkruar nuk janë të ndryshme nga ato që gjenden në mediat perëndimore dhe ato përfshijë:

- Personat me aftësi të kufizuar si të paaftë ose si barrë
- Personat me aftësi të kufizuar si për tu mëshiruar
- Super Crip - personi me aftësi të kufizuar si super-hero

Personat me aftësi të kufizuara si për tu mëshiruar

Ky stereotip, shpjegon Colin Barnes, nxit publikun që të ndjejë mëshirë për personat me aftësi të kufizuara shpeshherë duke i përshkruar ata si në nevojë për ndihmë nga pjesa e popullsisë pa aftësi të kufizuara.

Në artikullin, “Godina e shkatëruar e spitalit geriatrik në Prijedor, strehon 80 persona: Të harruar nga të gjithë” (Oronula zgrada prijedorske Gerijatrije utočište za 80 lica Zaboravljeni od svih ih) Nezavisne Novine, 05.12.06, gazetari përdor një ton tejet sentimental për të përshkruar rezidentët që jetojnë në këtë institucion. Gazetari i interviston rezidentët drejtpërdrejt, por theksi i intervistës është për të nxitur mëshirë. Një rezident i institucionit citohet të thotë, “Askush nuk na mëshiron dhe askush nuk na i hedh sytë – njerëzit nuk duan të shohin një të

²⁹ Karin Ljuslinder siç citohet në “People with Disabilities: As Depicted by the Media” (Swedish Disability Federation: Stockholm): 9.

³⁰ Colin Barnes, ibid: 5.

gjymtuar. Ne të gjymtuarit po vdesim këtu dalëngadalë” një tjetër rezident i institucionit në fjalë është cituar të thotë: “Askush nuk na do...veçanërisht shoqëria. Gjithçka është e mbushur me dhimbje dhe probleme...”

Ose gazetari përdor një ton patetik kur përshkruan një person me aftësi të kufizuara, gjë që është tepër emotive si në shkrimin “Ngado që hedh sytë – errësirë” (Gde god se okreneš – mrak) në Večernje novosti: “Njeriu nuk sheh me sytë e tij por me sytë e zemrës. Këtë thonë për Shoqatën e të verbërve dhe personave me dëmtime shikimi “Bastuni”, e cila është një nga organizatat në Serbi me 12 000 anëtarë që nuk mund të shohin. Por është e vështirë të shohësh me zemër kur ka pengesa në çdo hap”.

Super Crip:

Ky steriotip, siç shpjegon Colin Barnes, portretizon një person me aftësi të kufizuara sikur ai të ishte super-njeri ose të kishte cilësi magjike në përpjekjen për të fituar respektin e publikut dhe shpesh e portretizon një person me aftësi të kufizuara si një super hero në plotësimin e nevojave të përditëshme të tilla si, përfundimi i universitetit, sigurimi i një vendi pune ose krijimi i familjes. Shpesh historia tregohet nga një gazetar dhe jo nga këndvështrimi i një individi apo individëve që janë portretizuar. Shpeshherë tekstet janë tepër emotive në natyrë.

Shembuj të tillë përfshijnë:

“Eshtë më e vështirë të sigurosh një diplomë kur je në karriker me rrota” (“Teže do diplome kad si u kolicima) në Blic, 04.07.06, Një artikull që i portretizon personat me aftësi të kufizuara si guximtarë në përpjekjen e tyre për tu arsimuar, i përshkruan studentët me aftësi të kufizuara gati si super-njerëz në përpjekjen për të përfunduar univeristetin pasi gazetari shkruan: “Studentë të guximshëm që nuk i lejojnë aftësisë së tyre të kufizuar ti pengojë në përmbushjen e ëndrrës së tyre, ndeshin një numër barrierash për ditë.”

Në shkrimin “Një person 100% me aftësi të kufizuara trainon policët për tu zhytur” në DNEVNI AVAZ, 04.09.06, është një shkrim mbi një person me aftësi të kufizuara që trainon policët për tu zhytur. Ky person përshkruhet si një krijesë e rrallë dhe si dikush që ka aritur të pamundurën pasi është në gjëndje të zhytet edhe me aftësinë e kufizuar që ka dhe të trainojë persona pa aftësi të të kufizuar. Në një shkrim tjetër “Talent në qetësi” (Talenat u carstvu tišine), Vecernje Novosti, 05.11.06, gazetari përshkruan dy gra që nuk dëgjojnë si të jashtëzakonshme, pasi ato ndjekin kurs vizatimi bashkë me studentët pa aftësi të kufizuara”.

“Ana dhe Maja janë të vetmet studente me nevoja speciale që ndjekin kurse të rregullta në shkollën teknike-artistike “Tehnoart”. Pavarësisht nga aftësia e madhe e kufizuar dhe jeta e heshtur, këto dy vajza që nuk dëgjojnë dhe nuk flasin patën fatin të mësojnë dhe zhvillojnë teknikat e vizatimit së bashku me bashkëmoshatarët e tyre. Ato ulen bashkë dhe komunikojnë me të tjerët përmes “Leximit të buzëve”.

Në një shkrim mbi dy pjestarë të ekipit kombëtar të volejbollit të personave përdorues të karrigeve me rrota, “Ju luani për vendin tuaj, loja juaj vjen nga shpirti juaj” (Za domovinu se igra) Dani, 08.07.06, gazetari pyet të intervistuarit: “A jeni si gjithë të tjerët? Me bashkëshorte, fëmijë, familje, miq familjarë etj...?” Më pas ajo vijon me pyetjen: “Si ju erdhi ideja të bëheshit djemtë fitues të medajes së artë prej disa vitesh tashmë, ndërkohë që “të shëndetshmit” fshihen pas justifikimeve të tilla si kushte jetese të pamundura?”

Në shkrimin që vijon, “Moda është e ardhmja e mbretëreshës së heshtjes” (Shtëpia modeste e mbretëreshës së heshtjes) (Moda je budućnost kraljice tišine) (“Skroman dom kraljice tišine)), Vijesti, 24.07.06, gazetari përdor një ton patetik për të përshkruar fituesen e konkursit Mis Bota pët titullin e gruas më të bukur që nuk dëgjon. Fituesja e konkursit citohet në fillim të shkrimit me emrin e saj të plotë, por gjatë tekstit asaj i referohet vetëm me emrin. Arritjet e saj si studente e mirë me talent në stilimin e veshjeve glorifikohen në të gjithë shkrimin si diçka e jashtëzakonshme dhe gazetarja merr një ton jashtëzakonisht emotiv kur tregon historinë e jetës së saj.

IVANA NOVELJIĆ PASI FITON KONKURSIN E BUKURISË NË PRAGË I KALON PUSHIMET ME FAMILJEN E SAJ NË SUTOMORE

Sutomore- Një shtëpi njëkatëshe në Noveljićs' in Mirošica colony no. 1 është shtëpia e Misit të parë në Botë nga Bashkja Bar. Ivana Noveljić (17) e Institutit për arsimimin e personave me dëmtime shikimi dhe dëgjimi në Kotor, e cila fitoi titullin e vajzës më të bukur në botë që nuk dëgjon mes 30 konkurrenteve në "Top Hotel" në Pragë. Gjatë vizitës së djeshme të stafit të gazetës Vijesti, motra e saj e vogël Sara, që ndihmon në komunikim, ishte në plazh, prandaj xhaxhai i saj Darko dhe gjyshja Branka Noveljić na ndihmuan.

– Asgjë e madhe nuk ka ndryshuar në jetën time. Më pret viti i katërt i shkollës dhe ende nuk e di se çfarë do të bëj kur të mbaroj shkollën. Do të doja të bëhesha modele dhe shpresoj të kem shansin të përpiqem për këtë- ne e kuptuam njëra tjetrën për ato çfarë donte të thoshte kjo brune bukuroshe.

Përkthyesja e saj Sara, nxënëse e klasës së tetë të shkollës "Kekec" në Sutomore është e vetmja në këtë familje modeste prej katër pjestarësh Noveljić që flet: mamaja Ljubinka dhe babai Dragan janë të dy me dëgjim dhe të folur të dëmtuar dhe kanë qenë nxënës të Institutit Kotor.

– Prej një muaji u përgatita për prezantimin në Pragë, duke praktikuar një koreografi të një stili të veçantë etnik, e cila zgjatë një minutë e gjysëm dhe u përgatit nga profesori im i edkuimit fizik. Në Republikën Çeke më pëlqeu Qyteti i Vjetër dhe shëtitjet në Pragë. Ishim të mirëpirura kudo- Ivana vazhdoi me gjuhën e shenjave, duke shtuar se pasi të mbaronte shkollën dëshironte të bëhej stiliste veshjesh. Interesi në botën e veshjeve dhe stilimit pa dyshim është ndikim i mamasë së saj që është robaqepëse. Me një buzëqeshje të lumtur Ljubinka tregon se është shumë e lumtur që vajza e saj u bë Miss Bota.

– Ivana është një vajzë kaq e mirë, kaq inteligjente – xhaxha Darkoja përkthen fjalët e Ljubinkës, ndërsa ajo përqafton vajzën e saj të presferuar. Ajo që mund të arrijmë në përfundim nga kjo vizitë e shkurtër është se sytë janë mënyra më e mirë për të kuptuar njëri tjetrin në këtë familje, larg turmës së pushuesve në Sutomore. Nuk ka fjalë që të përshkruajnë krenarinë dhe dashurinë e syve të Ljubinkës për Ivanën, kur ato pozojnë përpara fotografëve tanë.

Dragani dhe Ljubinka jetojnë të lumtur dhe mes Sarës dhe Ivanës egziston një lidhje e fortë. Ajo mësoi menjëherë të komunikojë me prindërit dhe motrën e saj. Dragani punonte për "Rumijatrans" dhe merrte pensionin e aftësisë së kufizuar. Aktualisht ai punon si tapicier. Ai është shumë i përkushtuar dhe shumë punëtor. – Gjithmonë është dikush që ka nevojë për të riparuar diçka dhe Ljubinka ka gjithmonë punë –thotë nëna e Draganit, Branka, familia e së cilës e ka origjinën nga Podgorica, por që prej 50 vitesh jeton në Sutomore.

Ndërsa kalon pushimet e verës dhe noton çdo ditë me miqtë e saj Ivana nuk e humbet lidhjen me dashurinë e saj të madhe – modën, ajo ishte të enjten në mbrëmje mes të ftuarve të nderit në Spektaklin e IX Ndërkombëtar të Modës në Kotor. Ajo nuk heq dorë as nga aktrimi, dhe ka interpretuar me sukses në shfaqjen "Magjia e Heshtjes" të vënë në skenë nga seksioni i dramës së institutit të Kotorit.

–Po përgatisim një shfaqje të re për në nëntor. Kam interpretuar tashmë dy herë në seksionin e dramës, një herë në Itali dhe një herë në Zvicër. Po përgatitem për të marrë pjesë përsëri në një konkurs bukurie – thotë vajza më e bukur e botës së heshtur, që ishte mikpritur ngrohtësisht javën e shkuar në Mirošica.

Pas kthimit të saj nga Praga për Ivanën u organizua një festë e vogël dhe me këtë rast të gjithë fqinjët e saj u mblodhën për ta përgëzuar për suksesin e aritur.

Krenaria e prindërve dhe mësuesve të saj.

- Ivana është studente e shkëlqyer, ajo ka hyrë në institut kur ishte 5 vjeç dhe është vështirë të thuhet nëse është më e mirë në aktivitetet jashtëshkollore apo ato të organizuara nga shkolla. Ne jemi të gjithë të lumtur dhe krenarë për këtë rezultat që në të njëjtën kohë është edhe sukses i prindërve dhe mësuesve të saj, dhe kujdesatarëve që morrën pjesë në zhvillimin e personalitetit të saj. Ne do të vazhdojmë tu japim studentëve tanë më të mirën e mundëshme, thotë drejtori i institutit të Kotorit Borislav Kascelan, diuke komentuar suksesin e promovueses më të madhe të këtij institucioni unik në Malin e Zi të krijuar 60 vjet më parë.

Në një shembull tjetër shkrimi ilustron qartë stereotipin «Super Crip» pasi personi i intervistuar është përshkruar gati si supernjeri. Gazetari përdor terma të tillë si «guximtar» dhe «kurajoz» gjatë të gjithë shkrimit duke shkruar në një mënyrë mitizuese për këtë individ, duke përdorur një ton tepër emotiv që në fakt është i zakonshëm për këtë lloj historie «Super Crip».

**“ARRITJE E PAZAKONTË: NGA PRILEPI NË PEKIN NË KARRIKE ME RROTA. MILE STOJKOSKI GUXIMTAR SYNON TË MARË PJESË NË LOJRAT OLIMPIKE NË METROPOLIN KINEZ NË VITIN 2008”,
Oslobodnje, 15.12.06**

Forca e vullnetit është shpesh më e fortë se vetë aftësia e kufizuar, pavarësisht se sa e madhe apo e rëndë mund të jetë ajo. Këtë e vërtetoi 2 vjet më parë Mile Stoikoski. Në karriken e tij me rrota ai udhëtoi më shumë se 700 km nga Prilepi i Maqedonisë lindore deri në Athinë, vetëm për të marrë pjesë në lojrat olimpike në Greqi në 13 gusht 2004. Këtë herë ai po përgatit një ndërmarrje më të madhe dhe më të rrezikshme. Në karriken e tij me rrota, duke u nisur sërish nga Prilepi, ai synon të ndëmarrë një udhëtim të gjatë dhe të pasigurt drejt Kinës për të marrë pjesë në hapjen e lojrave të njëzetënta verore olimpike më 8 gusht 2008.

I nxitur nga historia e jetës së tij, por edhe nga përvojat negative që personat me aftësi të kufizuara, si ai, duhet të ndeshin, Mile Stoikoski kërkon të tërheqë vëmendje e publikut lokal dhe atij botëror dhe të nxjerrë në pah të drejtat dhe gjendjen e personave me nevoja të veçanta. Me këtë ndërmarrje të pazakontë ai shpreson të bëhet maqedonasi i parë që udhëton në një rrugë kaq të gjatë dhe të rrezikshme në karrike me rrota, mjaftueshëm e përshtatshme për librin e rekordeve botërore Gines.

Megjithatë, për këtë 40 vjeçar qytetar të Prilepit, as libri i rekordeve botërore Gines dhe as fama nuk janë objektivat kryesore, përkundrazi ai synon të mbledhë paratë e mjaftueshme për një operacion kompleks dhe të shtrenjtë që kryhet në Shtutgart për të implantuar një elektrostimulator. Ai shpresoon që kjo pajisje do ti mundësojë të ngrihet sërish në këmbë. 10 vjet më parë, Stoikoski pësoi një aksident të rëndë rrugor që e detyroi të përdorë karriken me rrota. Pavarësisht nga kjo Mileja nuk u dorëzoiua. Dëshira e fortë e mposhti dëmtimin e tij. Ai filloi të merret me sport dhe sot është një nga lojtarët më të mirë të ping pongut mes personave me aftësi të kufizuara në Maqedoni.

Dy vite më parë ai ia doli mbanë të arrinte në kohë në Lojrat Olimpike të Athinës, por dëshira e tij për ti dhuruar karriken e tij me rrota njeriut më të pasur të botës, Bill Geits, nuk arriti të realizohej. Ai do të përpiqet ta bëjë këtë në Pekin.

Për udhëtimin e tij në Kinë, Stoikoski duhet të nisët nga fundi i shkurtit të vitit 2008. Duke lëvizur karriken me rrota me duart e tij, ai duhet të përshkruajë 16.000 km dhe të kalojë rreth 36 shtete, përfshirë Afganistanin, që të realizojë ëndrrën e tij.

“Udhëtimi im do të jetë edhe një lloj misioni paqeje, pasi në çdo 100 km do të mbjell një pemë si simbol të paqes. Kjo do të jetë lutja ime për paqe në botë,” tha Stoikoski.

Institucione nga të gjitha shtetet ku do të kalojë ky prilepas i guximshëm do ti dhurojnë pemë për të cilat më pas do të kujdesen vetë ata në kujtim të triumfit të arritur nga një njeri që mposhti gjymtimin e tij me forcën e dëshirës.

Për të parandaluar atë që i ndodhi 2 vjet më parë në Athinë, kur iu desh të shihte hapjen e ceremonisë në një restorant për shkak të problemeve të organizimit, këtë herë komiteti organizator i Lojrave Olimpike të Pekinit është informuar tashmë për misionin dhe objektivat e tij.

“Me anë të këtij udhëtimi unë dëshiroj të inicoj ndërtimin e qendrave rehabilituese, spitaleve madje edhe objekteve për rishoqërimin e personave me nevoja të veçanta” tha ai.

Ai shpreson se do të arrijë ta kryejë këtë aventurë për në Kinë, pasi ai mbështet fuqimisht nga e shoqja dhe vajza adoleshente. Mileja do të udhëtojë për në Gjermani ku është planifikuar të kryhet ky operacion i komplikuar.

Gjatë realizimit të këtij studimi kemi vënë re disa shembuj nga jeta e personave me aftësi të kufizuara që ndahen nga stereotipet. Më poshtë japim ekstraktet nga një reportazh që përshkruan jetën e disa personave me aftësi të kufizuara dhe që është një shembull i mirë i raportimit që nuk përdor stereotipin “Super Crip” për të përshkruar arritjet e tyre. Shumë ndryshe nga portretizimi “Super Crip” këta individë nuk përshkruhen si heronj ose supernjerëz. Përkundrazi çdonjëri përdor fjalët e tij për të përshkruar jetën e vet. Edhe pse terminologjia nuk është gjithmonë konsistente dhe toni shpesh është tepër emotiv, është kontrast i mirë i përdorimit të gjerë të modelit “Super Crip”.

**VULLNETI LËVIZ MALET (Volja pokreće planine), Nezavisne novine
10.03.2004**

Pasuniversitar i suksesshëm: *Sasha Grbić nga Karanovac pranë Banja Lukës është i verbër që në lindje. Ky 24 vjeçar është sot studenti i diplomuar për letërsi në Banja Lika... “Disa profesorë nuk mund ta besonin që një i verbër të arrinte të studionte letërsi. Megjithatë unë nuk hezitova, e dija se me kalimin e kohës gjithshka do të shkonte në vendin e duhur,” thotë Sasha. Gjatë dy viteve të para të studimeve ai përballoi detyrimet shkollore me të atin, i cili ishte mbështetje e fortë për të. E thënë ndryshe, i ati lexonte librat dhe Sasha regjistronë gjithçka sikurse dhe leksionet. Vështirësitë e udhëtimit nga Karanovac në Banja Luka u kapërcyen. “Babai im më çonte fillimisht në shkollë me makinë pasi autobuzët ishin shumë të rrallë dhe më duhej pak kohë për të mësuar rrugët e qytetit. Por shpejt unë arita t’ia dilja mbanë vetë.” Tha Sasha. Si një nga pesë studentët më të mirë të brezit të tij, Sasha shpjegon se vendosmëria është thelbësore për të arritur suksesin. “E dija që duhet të përpiqesha shumë nëse doja të arrija diçka. Por kisha mbështetjen e familjes dhe të miqve të mij dhe nuk u dorëzoza” thotë Sasha me krenari. Pas përfundimit të studimeve me sukses ai vendosi të regjistrohej në studimet pasuniversitare. Një kompjuter i përshtatur me programe të specializuara audio/zanor i bëri studimet e tij më të lehta. Miqtë e Sashës thonë se ai ka një personalitet të fortë dhe se është shumë komunikues dhe i thjeshtë mës kolegëve. Sasha dëshiron të përfundojë me sukses studimet e tij master dhe ndoshta dizetracioni i doktoraturës mund të vinte më pas.*

.....
VULLNETI LËVIZ MALET: *Olivera Mastikosa, M.A. në shkencat teknologjike vuan nga distrofia muskulare dhe është aktualisht drejtore ekzekutive e organizatës humanitare “Partner”. Përcakto qartë objektivat e tua, futu në ritmin e jetës, thotë ajo, këto janë kyçi i kapërcimit të aftësisë së kufizuar. Të kyçesh brënda mureve të shtëpisë, kjo nuk është zgjidhje. “Eshtë më e thjeshtë të tërhiqesh sesa të luftosh me jetën. Shumë persona thjesht dorëzohen me pretekstin se aftësia e kufizuar i pengon të përmbushin ëndërat e tyre. Por problemi qëndron te personaliteti dhe jo te aftësia e kufizuar, “beson Olivera. Në fakt pas një operacioni sëmundja e saj avancoi më tej. Megjithatë kjo nuk e pengoi për tu bërë aktive dhe për të krijuar një organizatë humanitare që merret me një numër nevojash të personave me aftësi të kufizuara, si edhe me gratë e pamartuara me fëmijë. “Aktualisht ne po përurojmë një qendër informacioni për të rinjtë më aftësi të kufizuara, si dhe shërbimin e asistencës personale në bashkëpunim me institutin për distrofinë dhe qendrën për punë sociale. Kemi një numër seminaresh; jemi aktivë në fushat e mbrojtjes sociale, shëndetit dhe arsimit. E gjithë kjo me dëshirën e mirë dhe me një buzëqeshje” thotë me krenari Olivera. Ajo ka arritur shumë në të shkuarën dhe ka plane të shkëlqyera për të ardhmen. “Një person me vullnet të fortë, personalitet të fortë dhe vendosmëri mund të lëvizë mallet. Nuk ka aftësi të kufizuar që të mund të na ndalë.” Olivera Mastikosa është e vendosur.*

.....
TRAGJEDIA SI MOTIVIM: *Faruk Sabanović, student i vitit të fundit të Akademisë së Arteve të Bukura në Sarajevë thotë se ai nuk e sheh aftësinë e tij të kufizuar si një kufizim dhe se ai nuk e ndan jetën e tij mes para dhe pas karrikes me rrota. “Isha 18 vjeç kur një snajper më goditi pikërisht në fund të luftës. Që atëhere jam lidhur në karriken me rrota. Nuk e morra atë ngjarje tragjike si fundin e botës; madje tragjedia më dha forcë dhe motivim për tu përpjekur më shumë në jetë. Para se të plagosesha isha një djalë i shkujdesur nën krahët e prindërve të mij. –plagosja më shkundi fort dhe më dha krahë” thotë Shabanović, 27 vjeç që ka marrë tashmë një numër çmimesh për punën si grafik dizajner.*

VI. KËSHILLA NGA TERRENI PËR PASQYRIM TË SUKSESSHËM MEDIATIK

Në këtë seksion të raportit, advokuesit e aftësisë së kufizuar japin eksperiencat e tyre se si kanë realizuar fushata mediatike të suksesshme dhe se çfarë është e rëndësishme në drejtim të punës me median.

Intervistë me InfoPart, Banja Luka, Republika Srpska, Bosnje Hercegovinë

InfoPart është një shoqatë e të rinjve me aftësi të kufizuara në Banja Luka, Republika Srpska në Bosnjë Hercegovinë që punon për mundësi të barabarta për të rinjtë me aftësi të kufizuara në arsim dhe punësim. E krijuar në 2005 si dega rinore e organizatës humanitare Partner, InfoPart ka një përvojë solide në punën me median dhe realizimin e fustave mediatike.

Vanja Colić, zëvendës presidente dhe kordinatore e marrëdhënieve publike për InfoPart jep disa këshilla se si arriten të punojnë me median për të siguruar pasqyrim në median e shkruar:

- ⇒ Me qëllim që të sigurohet pasqyrim nga media është e rëndësishem të krijoni një reputacion të fortë të organizatës në komunitet për të arritur vëmendjen e medias drejt jush.
- ⇒ Organizoni konferenca shtypi dhe i përdorni ato si mundësi për të prezantuar arritjet e organizatës suaj si edhe planet për veprimtaritë në të ardhmen.
- ⇒ Është tejet e rëndësishme të keni një Kordinator të përkushtuar të Marrëdhënieve me Publikun në organizatën tuaj që të mund të vendosë komunikim me median dhe të monitorojë çështjet që lidhen me aftësinë e kufizuar në median e shkruar.
- ⇒ Për ti mbështetur veprimtaritë në media, ne zhvillojmë vetë mesazhe promocionale dhe përpqemi të sigurojmë kohë transmetimi si në radio, ashtu edhe në televizor.
- ⇒ Ide për një fushatë të suksesshme në media: si pjesë e fushatës me titull “Nuk jam në këmbë, por mendoj, prandaj dhe egzistoj” për mbledhjen e fondeve për shërbimet e asistencës personale, InfoPart organizoi një program televiziv në të cilin shikuesit mund të mernin në një numër telefoni nëse dëshironin të jepnin kontribute. Në këtë mënyrë u mbledhën 7500 KM (3750 euro),
- ⇒ Gjatë një fushate ndërgjegjësuere, përdorni mesazhe promocionale në radio dhe televizion. Do të ishte mirë të publikoni shkrime në median e shkruar ku përshkruhen ngjarje nga jeta më qëllim që të mbahet i interesuar dhe të kujtohet publiku për fushatën në fjalë.

“Cilat janë të drejtat e mija? Fushatë e organizuar nga Sumero, Unioni i Personave me Vonesa Mendore në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës.

Unioni i Shoqatës për Ndhimë ndaj Personave me Vonesa Mendore në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës, “Sumero”, organizoi një fushatë të gjerë mediatike për ndërgjegjësim si edhe informim të vendimmarrësve mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara intelektuale. Projekti u realizua në vitin 2004 me një grant të programit Share-EJL brënda Handicap International të Europës Juglindore, së bashku me donatorë dhe sponsorë të tjerë. Projekti zgjati 8 muaj me objektiv informimin e publikut mbi shërbimet dhe reformat që nevojiten për ti mbështetur më mirë personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe për të promovuar përfshirjen. Si pjesë e projektit, Sumero vuri në zbatim një fushatë mediatike të mirë planifikuar duke u dërguar rregullisht njoftime për shtyp të gjitha mediave kryesore të shkruara, televizioneve dhe radiove.

Në një intervistë me një përfaqësues të Sumero-s, znj. Indira Spiljak, ajo shpjegon se çelësi i suksesit të fushatës janë:

- ⇒ Të fillosh fushatën në media duke vendosur kontakte me mediat që janë të gatshëm të bashkëpunojnë në projekt dhe të transmetojnë mesazhin e tyre.

- ⇒ Kontaktet personale me gazetarët janë shumë të rëndësishme. Sapo ti keni vendosur kontaktet, është mirë që gazetari që do të pasqyrojë veprimtaritë tuaj të jetë i njëjti person në mënyrë që të jetë i familjarizuar me temën dhe me ngjarjen.
- ⇒ Ndërto një databazë të kontakteve egzistuese me median dhe përditësojeni atë vazhdimisht.
- ⇒ Përzgjidhni llojin e medias që doni të targetoni si për shembull programe televizive specifike apo radiostacione dhe gazeta të caktuara. Pastaj zgjidhni llojin më të përshtatshëm të medias në përputhje me projektin që po zbatoni. Zakonisht është më e lehtë të sigurosh pasqyrim nga media lokale pasi për të tërhequr vëmendjen e medias kombëtare duhet të keni një veprimtari të madhe.
- ⇒ Për televizionin, praktika është ta telefonosh stacionin në mëngjes dhe ta ftoni në veprimtarinë tuaj.
- ⇒ Për median e shkruar, ftojini gazetarët me e-mail ose njoftim për shtyp dhe më pas përpikuni të siguroni një gazetar të caktuar që i pasqyron veprimtaritë tuaja që ta ndjekë çështjen.
- ⇒ Mund të filloni kontaktet duke u shkruar një letër dhe duke u shpjeguar se kush jeni dhe se cili është projekti juaj dhe i ftoni gazetarët ose redaktorët për një takim kokë më kokë. Gjëja më e mirë është të vendosni kontakte personale dhe të ngjallni interesin e një gazetari të caktuar nga secila media, i cili bëhet më pas “ekspert” në këtë çështje.
- ⇒ Është e rëndësishme të programoni veprimtaritë në një ditë e cila nuk është e mbushur me veprimtari të tjera që mund të tërheqin vëmendjen e gazetarëve larg projektit tuaj.
- ⇒ Është e rëndësishme që titulli i veprimtarisë të tingëllojë bukur për të tërhequr vëmendjen e gazetarëve dhe ftesat përgjithësisht ua jepni në dorë ose ua dërgoni me email. Më pas shoqëroni ftesën me një telefonatë për tu siguruar që e kanë marrë.
- ⇒ Ftesa është e ngjashme me njoftimin për shtyp. Ajo përmban informacionin më të rëndësishëm dhe të gjithë emrat dhe titujt e personave që do të marrin pjesë. Pas veprimtarisë, gazetari zakonisht e përdor këtë mundësi për të bërë disa pyetje dhe ne u dërgojmë mediave fotografi dhe njoftime për shtyp në formë elektronike.
- ⇒ Shumë e rëndësishme për të siguruar një pasqyrim të mirë nga media është të kesh krijuar emër të mirë dhe të njihesh në komunitet për punën që bën.
- ⇒ Gjithmonë trainoni stafin tuaj mbi marrëdhëniet me publikun dhe përfshini edhe punonjës ose vullnetarë të rinj në veprimtari të marrëdhënieve me publikun.
- ⇒ Përpikuni ta bëni zërin e anëtarëve tuaj të dëgjohet në media duke i ftuar gazetarët në mjediset tuaja për ti intervistuar anëtarët tuaj, me qëllim që të mos mbeten vetëm në intervistimin e krerëve të organizatave.
- ⇒ Kur vijnë gazetarët në Sumero, i nxisim ata që të marrin mendime nga vetë fëmijët me aftësi të kufizuara.
- ⇒ Gjithmonë egziston nevoja për ti trainuar gazetarët dhe për ti sensibilizuar ata mbi çështje që lidhen me personat me aftësi të kufizuara.

Intervistë me Božidar Denda, redaktor dhe Drejtues i programit radiofonik “Zvukom do Svijetlosti” në Malin e Zi

Për pesë vjet, Božidar Denda, është redaktor i programit radiofonik “Zvukom do svijetlosti”, “Me zë drejt dritës” që pasqyron çështjet e aftësisë së kufizuar në përgjithësi dhe në mënyrë më specifike, për personat me vështirësi shikimi. Programi transmetohet në një radio private me mbulim të madh në Malin e Zi të quajtur “Antena M” çdo të shtunë nga ore 14 deri në orën 15.

Iniciativa për këtë program erdhi nga Unioni i të verbërve të Malit të Zi. Në fillim ata iu drejtuan radios shtetërore “Radio Mali i Zi” për ti mbështetur, por në atë kohë radioja shtetërore nuk i kishte mundësitë për ta realizuar këtë ide. Prandaj Unioni arriti një marrëveshje me “Antena M” që mbulon rreth 90% të Malit të Zi. Transmetimi i këtij programi filloi në shkurt 2003 dhe drejtohet nga Božidar Denda, një gazetar i trainuar.

Kostot financiare të prodhimit të emisionit mbulohej nga Unioni dhe pagesa e honorarit që i bëhet gazetarit Božidar Denda për punë vullnetare iu pagua gjatë vitit të parë të transmetimit nga “Antena M”. Nuk ishte detyrim

i radiostacionit një gjë e tillë por ishte thjesht një vepër në mbështetje të programit. Pas përfundimit të vitit të parë të transmetimit, Unioni i mori mbi vete të gjitha shpenzimet përfshi këtu edhe honorarin e gazetarit.

Ideja kryesore e Unionit kishte të bënte me krijimin e një programi radiofonik që do të informonte një audiencë të gjerë mbi veprimtaritë e tyre, qëllimin e punës së tyre, arritjet si edhe problemet me të cilat ndëshen anëtarët. Emisioni përbëhet nga disa rubrika, secila me gjatësi 5 deri 6 minuta, dhe temat përfshijnë:

- **Aktualitet** – lajme që lidhen me aftësinë e kufizuar dhe vëzhgim i përgjithshëm mbi ngjarjet që lidhen me aftësinë e kufizuar
- **Informacion** mbi veprimtarinë aktuale të Unionit në nivel kombëtar dhe një vëzhgim mbi veprimtaritë e Komitetit Konsultativ të Ballkanit, Unioni Botëror i të Verbërve, Bashkimi Evropian, dhe organizatat lokale të personave të verbër. Programi informon mbi OPAK-ë të tjerë, veçanërisht kur ndodhin ngjarje të rëndësishme.
- **Shkenca dhe teknologjia** –informacion dhe lajme nga fusha e mjekësisë, informacion mbi pajisjet tiftoknike, (pajisje për personat me vështirësi shikimi) dhe arritjet më të fundit teknologjike.
- **Kultura dhe arsimit** – lajme nga këto fusha.
- **Sporti dhe shahu** – informacion nga aktivitetet sportive.
- **Të verbrit gjatë historisë.**

Programi i fundit i çdo muaji i kushtohet një të ftuari special dhe titullohet “Portret”. I ftuari është zakonisht person me aftësi të kufizuara që jeton në mënyrë të suksesshme në komunitet dhe ashtu siç thekson edhe Denda, nuk është e nevojshme që i ftuari të ketë arritur diçka të jashtëzakonshme, si për shembull të ketë fituar medalje apo vend nderi. Kriteri bazë është që i ftuari të jetë person me aftësi të kufizuara ose dukush i përfshirë në çështjet e aftësisë së kufizuar si ekspert apo punjës social.

Lidhur me vazhdueshmërinë e programit dhe gjatësinë e tij në të ardhmen, Denda tregoi se Unioni ka interes të madh në vazhdimin e këtij programi. Nga ana tjetër, është e rëndësishme të jemi realistë dhe të mbajmë në mendje se programi mund të ndërpritet nga radiostacioni në të ardhmen. Megjithatë, në Malin e Zi, si edhe në shumë vende të tjera të rajonit, Ligji mbi Informimin thekson se është detyrim për të gjitha mediat elektronike që të përcaktojnë një numër të caktuar orësh për çështje që lidhen me aftësinë e kufizuar. Për shembull, Radiotelevizioni i Malit të Zi transmeton një program mbi aftësinë e kufizuar një herë në muaj. Edhe Radio Mali i Zi transmeton program një herë në javë, si edhe disa radio lokale (p.sh. radio Herceg Novi, Budva, Bar, etc.)

Në çdo rast, Unioni i të Verbërve në Malin e Zi ka vullnetin dhe motivimin ta vazhdojë transmetimin e programit radiofonik “Zvukom do svijetlosti” në “Antena M”. Unioni merr të ardhura financiare për emisionin nga fondi për informim dhe komunikim të dhënë nga Ministria e Kulturës, Sporteve dhe Medias. Ai e përdor këtë buxhet për të siguruar informacion të aksesueshëm për pjesëtarët e tij, si edhe për të paguar emisionin.

Intervistë më Vesna Nestorović themeluese dhe presidente e Beli Stap, Serbi

Organizata Bastuni i Bardhë (Beli Stap) u themelua në vitin 2003 si OPAK me tre fusha kryesore: të promovojë mundësi për të verbrit dhe personat me vështirësi shikimi që të trainohen për të lëvizur më shumë me qëllim arritjen e lirisë më të madhe në lëvizje, edukim mbi çështje që lidhen me aftësinë e kufizuar dhe ndërgjegjësim; si edhe ndikim mbi median.

Për sa i përket medias, projekti i parë që ndërmorën ishte një program televiziv në bashkëpunim me ANEM, shoqatën e Mediave Elektronike të Pavarura. ANEM përbëhet nga 28 stacione radios dhe 16 stacione televizive që përpiqen për cilësi dhe profesionalizëm maksimal. Misioni i ANEM-it është të krijojë një kornizë ligjore të pavarur politikisht për median elektronike dhe përmirësimin e standarteve profesionale në industrinë e medias për të plotësuar siç duhet interesat e publikut.³¹ Programi televiziv i titulluar “Edukacija sire drustvene zajednice putem TV emisija “upoznajte nas bolje” filloi në vitin 2003 dhe vazhdon ende të transmetohet një herë në javë në të gjithë stacionet lokale pjesë e rrjetit ANEM në oraret e darkës. Qëllimi i emisionit është të informojë mbi dëmtimet e shikimit dhe aftësi të tjera të kufizuara në nivel lokal. Emisioni përpiqet gjithashtu të rrëzojë paragjykimet mbi personat e verbër dhe ata me dëmtime shikimi duke treguar se ata janë të aftë të

³¹ ANEM website: <http://www.anem.org.yu/cms/item/oanemu/en/O+nama.html>

realizojnë programe televizive cilësore. Të gjithë drejtuesit e emisionit janë të verbër. Emisioni fokusohet në tre tema kryesore:

- Veprimtaria e OPAK-ve lokale
- Histori nga jeta e personave me aftësi të kufizuara
- Puna e institucioneve shtetërore që merren me çështjet e aftësisë së kufizuar

Emisioni financohet nga Ministria e Punës, Punësimi dhe Çështjeve Sociale dhe ANEM. Ministria paguan për gjysmën e programit dhe ANEM mbulon gjysmën tjetër të kostos. Në total emisioni transmetohet në 24 Bashki të ndryshme brënda rrejtësimit të ANEM. Në fillim u kërkua nga ana e ANEM ngritja e një kanali për aftësinë e kufizuar, por u refuzua pasi sipas tyre ky lloj transmetimi i specializuar do të ishte një formë segregacioni. Sipas Vesna Nestorović, drejtore e Bastunit të Bardhë, ajo beson se duhet të ketë programe speciale për aftësinë e kufizuar në kanalet kryesore, por programet për aftësinë e kufizuar nuk duhet të segregohen në një kanal të veçantë. Ajo e ndjen se emisionet e veçanta mbi aftësinë e kufizuar janë të nevojshme për atë kohë sa aftësia e kufizuar të mos jetë rrymëzuar brënda programacionit televiziv. Bastuni i Bardhë po planifikon për ta kaluar këtë emision në qershor në kanalet kombëtare dhe aktualisht po negocion me disa kanale televizive për mbështetjen e tyre.³²

Sipas Bastunit të Bardhë, për emisionin ka interes të gjerë. Në fakt, shikuesit kanë kërkuar që programe të tilla të ritransmetohen dhe shumë të tjerë i kanë drejtuar emisionit pyetje dhe komente. Si rezultat i këtij interesi, Bastuni i Bardhë hapi një listë emali-i që abonentët të mund të vazhdojnë diskutimet e tyre dhe tu përgjigjen pyetjeve të shikuesve.

Ndryshime në pasqyrimin e aftësisë së kufizuar nga ana e medias

Si gazetarë e trainuar, Vesna është shumë e familiarizuar me median dhe në opinionin e saj, ajo mendon se klima e sotme e bën të mundshëm trajtimin më të mirë të aftësisë së kufizuar në televizion dhe në radio. Ajo mendon se mund të gjenden shembuj ku aftësia e kufizuar të diskutohet nën këndvështrimin e modelit social dhe në termat e të drejtave të njeriut, si në radio është edhe në televizion. Dhjetë vjet më parë, ajo mendon se nuk ishte kështu dhe se atëherë mund të gjeje shembuj ku aftësia e kufizuar përshkruhej vetëm nën këndvështrimin mjekësor apo ajo e bamirësisë. Sot kemi filluar të shohim se si modeli social dhe këndvështrimi i të drejtave të njeriut po përdoren nga ana e gazetarëve, por shtypi i shkruar është më problematiku. Sipas Vesnës, ka ende më shumë paragjykime të shprehura nga ana e gazetarëve të medias së shkruar. Pra mbetet ende shumë punë për tu bërë për të ndryshuar mënyrën se si shkruan shtypi për aftësinë e kufizuar.

Të fitosh shikueshmëri

Si organizatë, ata kanë trainuar lidhur median dhe marrëdhëniet me publikun të gjithë anëtarët e tyre. Ata kanë një ekip të veçantë që punon me median dhe që i ndihmon të kenë shikueshmëri të mirë në media. Plus kësaj, përvoja e Vesnës si gazetarë i ka dhënë kontakte të mira me redaktorët dhe gazetarët.

Sipas Bastunit të Bardhë, kyçi i shikueshmërisë nga media varet nga një numër faktorësh:

- ⇒ Duhet ta bësh organizatën dhe punën tënde interesante për median.
- ⇒ Duhet të përdorësh aktivitete në data fikse si për shembull 3 dhjetori, 1 maji apo 15 tetori (dita e Bastunit të Bardhë) ku ka pjesëmarrje nga media dhe organizo aktivitete rreth këtyre datave.
- ⇒ Ji përfshirës në sensin që duhet gjithmonë të ftosh aktorë të ndryshëm të marrin pjesë në aktivitetet tuaja. Për shembull, kur organizohet dita e simulimit për të verbërit është ide e imrë që të ftohen shumë persona të interesuar në këtë aktivitet, përfshi këtu anëtarë të qeverisë dhe përfaqësues të medias.
- ⇒ Nëse organizohet një tryezë e rrumbullakët ose seminar, përpuni që jo vetëm të hidhet vështrim mbi problemet, por edhe tek zgjidhjet dhe kjo është diçka që medias i pëlqen ta pasqyrojë.

³² Beli Stap ka patur gjithashtu një program radiofonik mbi çështjet e aftësisë së kufizuar nga 2004 në 2006 në stacionin radiofonik të Beogradit 202. Ky program targetonte prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe transmetohej natën për të rritur audiencën. Ministria e Kulturës financoi 10 emisione në vit dhe vetë stacioni radiofonik pëballoi pjesën tjetër të kostos.

- ⇒ Është shumë e rëndësishme që jo vetëm të ketë kontakte me gazetarët, por edhe me kryeredaktorët dhe Bastuni i Bardhë është përpjekur të krijojë rrjetin e gazetarëve dhe të redaktorëve.

Përvoja e tyre në ndikimin mbi median

Sapo organizata zbulon një portretizim jo të përshtatshëm të një personi me aftësi të kufizuara në median e shkruar, i dërgohet një letër redaktorit. Fillohet duke falenderuar që kanë shkruar për një person me aftësi të kufizuara dhe u shpjegohet se pse dhe se si pjesë të artikullit ishin ofendues dhe se si mund të jetë ndryshe në të ardhmen. Për shembull, mund ti thuhet redaktorit të mos përdorë termin sakat, por person me aftësi të kufizuara duke i shpjeguar se përdorimi i terminologjisë së duhur do ti ndihmojë njerëzit ta kuptojnë aftësinë e kufizuar nga një kendvështrim tjetër. Çelësi, sipas Vesnës, është të mos ti drejtohesh medias me inat, por të përpiqesh të bashkëpunosh me të. Është e rëndësishme të mos e bësh median të ndihet injorante, por të përpiqesh ta mbështesësh me kritikën tënde.

Ata kanë përgatitur një letër me format të gatshëm për t'ia dërguar medias se si ti bëjnë faqet e tyre të internetit të aksesueshme. Kur faqja e internetit u del e paaksesueshme ata thjesht firmosin letrën dhe e nisin tek redaktori. Ata i dërguan letra Studios B (stacion televiziv kombëtar), B92 (stacion televiziv kombëtar), dhe PTT (kompanisë shtetërore të telekomunikacionit) dhe si rezultat, Studio B dhe PTT po i bëjnë të aksesueshme faqet e tyre në internet.

Në rast të ndërrimit të mesazhit të aftësisë së kufizuar ose të modelit të aftësisë së kufizuar në media, organizatat e kanë shumë të vështirë një gjë të tillë. Organizatat mund të kenë përvojë në pasqyrimin e veprimtarive të tyre, por ndryshimi i mënyrës së pasqyrimin të aftësisë së kufizuar nga ana e gazetarëve është një detyrë e vështirë. Prandaj, Vesna mendon se është shumë e rëndësishme që të organizohen trainime mbi median për mënyrën e komunikimit të mesazhit në media dhe si të tërheqësh vëmendjen e medias.

Këshilla e saj është që të përpiqesh ti njohësh realisht dhe personalisht gazetarët dhe redaktorët me qëllim që ti bësh ftesat personale. Të tërheqësh vëmendjen e tyre dhe të bësh që të vijnë në aktivitetet e organizuara. Për të krijuar partneritet me përfaqësuesit e medias është thelbësore që të mbahesh mend. Ajo takohet herë pas here ma rrjetin e saj dhe i përditëson për punën, lajmet dhe ne informacion, dhe nuk mbështetet vetëm në njoftime për shtyp në rast aktivitetesh.

REKOMENDIME

Pas vëzhgimit të tendencave kryesore të raportimit të medias në Bosnje Hercegovinë, Malin e Zi dhe Serbi, ka shumë gjëra që mund të bëhen për të ndryshuar përshkrimin dëmtues që i bën media e shkruar personave me aftësi të kufizuara. Si profesionistët e medias, ashtu edhe advokuesit e aftësisë së kufizuar kanë rol në ndryshimin e mënyrës se si pasqyrohet aftësia e kufizuar duke ju larguar stereotipeve stigmatizuese dhe u zhvendosur te raportimit fuqizues.

Personat me aftësi të kufizuara duhet të punësohen në median e rrymëzuar. Pamjet denigruese, terminologjia fyese dhe paradigmat e dala kohe do të zhduken më shpejtë kur më shumë persona me aftësi të kufizuara të punojnë në media.

Aktorët e medias duhet të marrin Trainim mbi Barazinë e Aftësisë së Kufizuar³³, në të cilën të prezantohen modeli social dhe ai i të drejtave të njeriut.

Trainim mbi gjuhën dhe terminologjinë- i gjithë personeli i medias duhet të jetë i ndërgjegjshëm mbi ndikimin e gjuhës që përdoret për aftësinë e kufizuar dhe shmangien e përdorimit të terminologjisë së papërshtatëshme.

Organizatrat e aftësisë së kufizuar duhet tu japin producentëve TV dhe gazetarëve më të mirë të medias së shkruar emrat e ekspertëve të tyre, në mënyrë që ata të përdoren si burim lajmi. Shpesh, gazetarët dhe producentët as nuk dinë emrat e grupeve kombëtare të aftësisë së kufizuar apo ekspertëve kombëtarë të aftësisë së kufizuar.³⁴

Profesionistët e medias duhet të bëjnë të mundur që media të përgatitet në formate që janë të aksesueshme për të gjithë përfshirë gjuhën e shenjave ose nëntitujt për personat me probleme dëgjimi dhe Braille ose formate audio për personat me dëmtime shikimi.

Redaktorët duhet të skedojnë ankesat kur në shtypin e shkruar gjenden raportime fyese. Tërhiqni vëmendjen e redaktorëve mbi protretizimet negative ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe u kërkoni që të bëjnë korrigjimet e duhura kur është përdorur terminologji e papërshtatëshme.

Advokuesit e aftësisë së kufizuar duhet të përdorin vazhdimisht slogenin mbi të drejtat e aftësisë së kufizuar :”Asgjë për ne, pa ne” dhe të bëjnë të mundur që zëri i tyre të jetë prezent në lajmet mbi aftësinë e kufizuar dhe që mesazhi i tyre të jepet i saktë.

Gazetarët duhet të shkojnë tek personat me aftësi të kufizuara dhe advokuesit e aftësisë së kufizuar si burime të lajmit për të garantuar që lajmi të tregojë “anën e aftësisë së kufizuar”.

Organizatrat e aftësisë së kufizuar duhet të jenë më shumë proaktivë në përfshirjen e çështjeve të aftësisë së kufizuar në lajme dhe tu japin ngjarje të aftësisë së kufizuar gazetarëve dhe redaktorëve.

Është e qartë se duhet investuar më shumë në trainimin e profesionistëve të medias mbi raportimin me respekt të aftësisë së kufizuar. Trainimet janë thelbësore për të ndihmuar gazetarët, redaktorët dhe producentët që të kuptojnë aftësinë e kufizuar nga një prespektivë e ndryshme dhe tu japë atyre mjetet që u duhen, të tilla si terminologjia e saktë dhe kuptimi i modelit social, me qëllim që të pasqyrojnë çështjet e aftësisë së kufizuar në një mënyrë fuqizuese.

³³ Modeli i Trainimit mbi Aftësinë e Kufizuar: <http://www.leeds.ac.uk/disability-studies/archiveuk/Gillespie-Sells/dis%20equality%20training.pdf>

³⁴ Haller, ibid: 32.

Trainimi i advokuesve të aftësisë së kufizuar mbi marrëdhëniet publike dhe puna me median është gjithashtu gjerësisht e nevojshme për të garantuar që pjestarët e lëvizjes së aftësisë së kufizuar janë të mirëpajisur për ta përhapur mesazhin e tyre në mënyrë efektive në media. Të dish të punosh me median është thelbësore për të garantuar që çështjet e aftësisë së kufizuar të jenë pjesë e axhendës së medias dhe që ato prezantohen sipas prespektivës së vetë personave me aftësi të kufizuara.

Gjatë realizimit të kësaj analize, ishte e dukshme se më shumë studime mbi aftësinë e kufizuar dhe median në rajon janë të nevojshme për të monitoruar realisht ndryshimet në mënyrën se si aftësia e kufizuar dhe personat me aftësi të kufizuara prezantohen në media. Do të jetë jashtëzakonshme e frytshme të ketë studime cilësore dhe sasore mbi median dhe aftësinë e kufizuar në mënyrë që të targetohen çështjet kryesore dhe të monitorohen ndryshimet në praktikën e medias. Për ta bërë këtë në mënyrë efektive, duhet të ketë më shumë arkiva elektronike me pasqyrën e medias në rajon, atje ku ato nuk egzistojnë (P.sh në Malin e Zi, në Provincën e Kosovës të administruar nga OKB).

Tani më shumë se kurrë, advokuesit e aftësisë së kufizuar kanë nevojë ta kenë median aleate në promovimin e Konventës së OKB mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Është thelbësore, për rrjedhojë, që këto dy grupe të punojnë bashkë duke ecur përpara dhe duke ju dhënë fund raportimeve negative dhe duke trajtuar çështjet e aftësisë së kufizuar sipas prespektivës fuqizuese dhe protretizimit me dinjitet të personave me aftësi të kufizuara.

BIBLIOGRAFIA

ANEM legal department and Zivkovic and Samardzic Law Office, ANEM and IREX. 2005. "Overview of Media Regulations in South East Europe from 2003-2005". Sarajevo: Media Plan Institute.

Albert, Bill. 2004. "Briefing note: The Social Model of Disability, Human Rights and Development". Disability KaR Research Project.

Barnes, Colin. 1992. "Disabling Imagery and the Media: An Exploration of the Principles for Media Representations of Disabled People". Halifax: Rynborn Publishing.

Cooke, Caroline; Daone, Liz; Morris, Gwilym. 2000. "Stop Press: How the Press Portrays Disabled People" Scope: London.

Hellar, Beth. 1999 "News Coverage of Disability Issues: Final Report for the Center for an Accessible Society". San Diego: The Center for an Accessible Society.

Haller, Beth and McCombs, Maxwell. 1992. "Explorers and surveyors: Expanding strategies for agenda-setting research". *Journalism Quarterly*.

Shoemaker, Pamela. 1987. "The Communication of Deviance" in B.Dervin (Ed.) Progress in Communication Science. Norwood, NJ: Albex.

Swedish Disability Federation, "People with Disabilities: As Depicted by the Media" (Stockholm: Swedish Disability Federation).

Faqe në Internet:

Disability Equality Training model : <http://www.leeds.ac.uk/disability-studies/archiveuk/Gillespie-Sells/dis%20equality%20training.pdf>

IREX, Media and Sustainability Index for Bosnia, 2006/2007:
http://www.irex.org/programs/MSI_EUR/2006/bh.asp

IREX, Media and Sustainability Index (MSI) Montenegro 2006/2007:
http://www.irex.org/programs/MSI_EUR/2006/montenegro.asp

IREX, Media and Sustainability Index (MSI) Serbia 2006/2007,
http://www.irex.org/programs/MSI_EUR/2006/serbia.asp

SHTOJCA I: BURIMET PËR RAPORTIM TË PËRGJEGJSHËM MBI AFTËSINË E KUFIZUAR DHE PASQYRIM ME RESPEKT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË MEDIAN E SHKRUAR

Kjo shtojcë synon të ndihmojë profesionistët e medias, si dhe advokuesit e aftësisë së kufizuar në ndryshimin e mënyrës së protretizimit nga media e shkruar të aftësisë së kufizuar dhe personave me aftësi të kufizuara. Informacioni vjen nga burime të ndryshme dhe synon të jetë një udhëzues për hulumtime të mëtejshme për ata që janë realisht të interesuar të ndryshojnë mënyrën se si media prezanton aftësinë e kufizuar. Të gjithë ne kemi fuqinë për të ndryshuar diçka dhe me pak ndihmë praktike, mund të përmbushim detyrën me lehtë.

Të gjeshtë gjuhën e duhur:

Gjuha luan një rol të jashtëzakonshëm në ndikimin mbi mënyrën se si mendojmë dhe në përcaktimin e sistemit tonë të vlerave. Nga ndryshimi i fjalëve që përdorim ne mund të sjellim një ndikim të madh mbi mënyrën se si shihen personat me aftësi të kufizuara dhe mund të ndihmojmë në ndryshimin e mënyrës se si shoqëria mendon për aftësinë e kufizuar. Më poshtë është një listë termash që duhen shmangur dhe sygjerime për të zëvendësuar terminologjinë fyese. Lista synon të ndihmojë gazetarët që të largohen nga përdorimi i termave pasivë dhe i portretizon personat me aftësi të kufizuara si viktime dhe ofron fjalë që respektojnë personat me aftësi të kufizuara. Lista e termave vjen nga komuniteti i aftësisë së kufizuar në MB si pjesë e një studimi mbi median dhe aftësisë e kufizuar, realizuar nga Scope, një organizatë e aftësisë së kufizuar, e quajtur "Ndal Media e Shkruar! Si i portretizon media e shkruar personat me aftësi të kufizuara"³⁵

³⁵ Cooke, Caroline, Daone, Liz, Morris, Gwilym, "Stop Press! How the Press Portrays Disabled People" (Scope: London) 2000: 35-41.

ang	or në vend të saj
ikapët	onat me aftësi të kufizuar
kur nga, vuan nga, viktimë e	(gjendjen ose dëmtimin)
kur pas karriges mo rrota,	orues i karriges me rrota
ikapë mendor, i vonuar mendor, me zhvillim të aftueshëm mendor	on me aftësi të kufizuar në të mësuar ose person ftësi të kufizuara intelektuale
t, invalid	on me një aftësi të kufizuar
ftë	on me aftësi të kufizuar
tik	on me paralizë cerebrale
	ftësi të kufizuara
ër, shurdh,	ona të verbër, persona që nuk dëgjojnë, persona lëmtime shikimi, persona me dëmtime dëgjimi

“The Broadcasting and Creative Industries Disability Network” (BCIDN) nga MB krijoi një udhëzues praktik mbi median dhe aftësinë e kufizuar për vetë profesionistët e medias për ta përdorur në punën e tyre të përditëshme. Udhëzuesi është hartuar kryesisht për televizionin dhe transmetimin e filmave, por megjithatë mund të jetë i përdorshëm nga gazetarët dhe profesionistët të tjerë të medias që punojnë në forma nga më të ndryshmet.

Udhëzues mbi median dhe aftësinë e kufizuar

Kush e Krijoi këtë Udhëzues?

Ky udhëzues u përgatit nga “The Broadcasting and Creative Industries Disability Network” (BCIDN) me qendër në Londër, Mbretëri e Bashkuar. Ai e ka bazën tek eksperiencia kolektive e Network dhe anëtarët e tij që kanë punuar bashkë duke u përpjekur dhe përmirësuar elementët për personat me aftësi të kufizuara në transmetime, filma dhe reklama për dhjetëvjeçarin e kaluar.

BCIDN u krijua nga transmetuesit më në zë, producentët filmikë dhe televiziv dhe organizatat e industrisë audio-vizive në MB për të rritur përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në punën e tyre. Edhe pse konkurrentë për audiencën, këto organizata bashkërisht themeluan Rrjetin për të lehtësuar shkëmbimin dhe përhapjen e praktikave më të mira në këtë industri dhe për anagazhuar personat me aftësi të kufizuara si bashkëtransmetues, prodhues programesh, të punësuar të mundshëm, shikues dhe vendimarrës.

Në një Manifest të publikuar në 2002 organizatat anëtare të Rrjetit (BBC, ITV, C4, Five, BSkyB, Discovery Networks Europe, Turner Broadcasting System, the UK Film Council, Producers’ Alliance for Cinema and Television (PACT), dhe Zyra Qendrore e Informacionit (COI)) janë bashkërisht të angazhuara për:

- Të rritur prezencën e personave me aftësi të kufizuara në transmetim dhe ekran.
- Të rritur numrin e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat e forcës së punës.

- Rritjen e aksesit tek shërbimet në transmetim dhe jashtë transmetimit.
- Të agrantuar aksesin tek të gjitha ndërtesat.
- Përgatitjen dhe publikimin e një plani veprimi, në nivelin e bordit, në të cilin do të detajohen se si do të zbatohen këto angazhime.

The Broadcasters' and Creative Industries' Disability Network është një rrjet specialistësh të forumit të Punëdhënësve mbi Aftësinë e Kufizuar: www.employers-forum.co.uk

Për kë është ky udhëzues?

Ky udhëzues në faqe në internet është për të gjithë transmetuesit dhe producentët, përfshi ata nga ju që punojnë në fushat e programeve të rrymëzuara, nga lajmet deri te programet argëtuese, nga drama te dokumentarët. Nuk është thjesht për prodhuesit e programeve që punojnë si specialistë për aftësinë e kufizuar. Edhe pse përdorim termin prodhues “programesh”, pjesa më e madhe e udhëzuesit është e përshtatshme edhe për ata që punojnë në fusha të tjera audio-vizuale si në prodhimin e filmave, reklamave, videove, pop promo, dhe produkte interaktive mediatike. Një pjesë e udhëzuesit është e përshtatshme edhe për menaxherët e burimeve njerëzore, stafin teknik dhe stafin që punon drejtpërdrejt me dëgjuesit dhe shikuesit.

Përse duhet ta përdorësh këtë udhëzues?

Ky udhëzues është hartuar tu ndihmojë të mendoni se si të jeni më përfshirës në bërjen e programit tuaj. Një pjesë e informacionit lidhet gjithashtu me mënyrën se si organizata juaj mund të bëhet më e dukshme për aftësinë e kufizuar.

Personat me aftësi të kufizuara janë një pjesë e konsiderueshme e audiencës suaj – qofshin dëgjues, shikues apo përdorues të faqes së internetit. Megjithatë ata janë pothuajse të padukshëm në programe dhe dukshëm të nënpërfaqëuar në fuqinë punëtore të kësaj industrie. Përmirësimi i kësaj situatë është së pari detyrë e menaxherëve të sektorit dhe të producentëve. Mënyra se si raporton dhe i portretizon personat me aftësi të kufizuara do të ndikojnë mbi qëndrimin e shoqërisë ndaj aftësisë së kufizuar. Më e rëndësishme, mënyra më e mirë për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara pasqyrohen në ekrane dhe në eter është pasqyrimi i tyre sa më i përshtatshëm në fuqinë punonjëse të prodhimit të programeve. Neglizhimi i këtij fakti do të thotë se po lini pa përfshirë një grup kolegësh të talentuar që janë persona me aftësi të kufizuar edhe ata.

Njerëzit e lexojnë dhe e përdorin këtë udhëzues, i cili pasqyron kombinimin e përvojës së shumë transmetuesve dhe prodhuesve të programeve. Ai është i mbushur me këshilla pozitive, realiste dhe praktike për t'iu ndihmuar të jepni edhe ju kontributin tuaj për tu siguruar se programet tuaja pasqyrojnë rëndësinë e personave me aftësi të kufizuara si për industrinë audio-vizuale dhe për shoqërinë. Personat me aftësi të kufizuara janë individë me historitë e tyre personale për ti treguar dhe këndvështrimet e tyre për jetën që do ti pasurojnë programet tuaja. Pa dyshim, ju do të pasuronit edhe vetë përvojat tuaja jetësore. Edhe një producent i vetëm mund të bëjë shumë.

Si ta përdorim këtë udhëzues

Ky udhëzues është i përbërë nga 6 rubrika informative:

- Hyrja prezantuese ku përfshihet edhe ligji
- Personat me aftësi të kufizuara pjesëmarrës në programe
- Punësimi i personave me aftësi të kufizuara si prodhues programesh
- Akses për aftësinë e kufizuar në shërbimet transmetuese
- Përshtatje dhe pajisje ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara specifike
- Komunikimi me personat me aftësi të kufizuara

Ky udhëzues është ndarë në një numër më të vogël nënrubrikash me qëllim që të mund të kaloni nga njëra te tjetra në përputhje me interesat dhe nevojat tuaja. Informacioni jepet si një seri sugjerimesh që mund ti zgjedhësh dhe ti zbatosh në përputhje me prodhimet tuaja. Ka njëfarë përsëritje nga njëra rubrikë te tjetra për sqarim, ndërkohë që edhe pse nuk është e nevojshme ta lexoni të gjithë udhëzuesin menjëherë, këshillohesh të përdorësh si referencë rubrikat e tjera.

Idetë në këtë udhëzues vijnë nga hartuesit e programeve të lajmeve, atyre argëtuese, dramatizimeve dhe dokumentarëve. Ato u drejtohen të gjithë hartuesve të programeve, jo vetëm atyre që punojnë në prodhime ekskluzive për aftësinë e kufizuar.

Shumë transmetues dhe producentë tashmë e kanë përmirësuar mënyrën se si portretizojnë ose punësojnë personat me aftësi të kufizuara. Ashtu siç shprehet edhe një producent i rëndësishëm: “Mos shqetëso u nëse je apo nuk je politikisht korrekt, thjesht vepro, dhe do ta shohësh se MUND të sjellësh ndryshim!”

Ligji mbi aftësinë e kufizuar

Të gjitha vendet evropiane kanë legjisllacionin e tyre mbi aftësinë e kufizuar. Edhe pse këto ligje janë bazuar mbi legjisllacionin e BE, ato mund të ndryshojnë pak në fushën e mbulimit. Në Mbretërinë e Bashkuar, për shembull, Akti i Diskriminimit për Aftësinë e Kufizuar mbulon punësimin, aksesin fizik, të mirat dhe shërbimet, trianimin dhe arsimin. Megjithatë, egziston edhe legjisllacion shtesë, Akti i Komunikimeve 2003, i cili kontrollon transmetimet. Ky përfshin kërkesa për krijimin e aksesit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara (për shembull, jep dispozitat për përqindje të caktuara që duhet të subtitrohen ose të përshkruhen në audio). Të dy aktet zbatohen nga dy organizma të veçantë – Komisioni i të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (DRC) dhe Zyra Qeveritare e Komunikimeve (Ofcom). Sigurisht që nëse legjisllacioni nuk imponohet ai ka efekt të kufizuar.

Portretizim

Steriotipet dhe realizimi i duhur

E mbani mend herën e fundit që patë apo dëgjuat një person me aftësi të kufizuara në radio apo televizion? Nëse mbani mend ndonjërin, ka shumë të ngjarë të ketë ndodhur në një program që fliste për aftësinë e kufizuar. Është e vështirë të përlllogarit se sa persona me aftësi të kufizuara marrin pjesë nëpër programet e zakonshme, sidomos kur aftësia e kufizuar është e padukshme. Megjithatë, shumë producentë do ta pranonin se nuk u ka shkuar kurrë në mendje të punësojnë një aktor me aftësi të kufizuara, të kërkojnë një “ekspert” ose kontribues me aftësi të kufizuara, të marrin një intervistë në rrugë një personi me aftësi të kufizuara, ose që me qëllim ta zgjerojnë përbërjen e audiencës në studio. Transmetuesit tani janë tepër të ndërgjegjshëm mbi rëndësinë e sigurimit të një përzierje gjinie dhe racash në transmetime radio dhe televizive. Pra përse të mos sigurojmë që edhe programi ta pasqyrojë siç duhet shoqërinë si një të tërë?

Është e lehtë ti injorosh të tjerët për të kursyer kohë dhe shpjegime gjatë programeve. Por kjo gjë rrezikon të të vendosë në rolin e atyre që përforcojnë steriotipet egzistuese, kështu që personat me aftësi të kufizuara, edhe në ato raste që shfaqen, vazhdojnë që gjerësisht të portretizohen ose si të veçantë e heroikë, ose si viktima të varur te të tjerët. Në fillim të viteve 1990, një studiues analizoi portretizimin e personave me aftësi të kufizuara në televizion dhe zbuloi se ata bien në një prej 11 kategorive, 10 prej të cilave ishin negative. Ato e përcaktonin personin me aftësi të kufizuara si “për tu mëshiruar dhe patetik”, si “të paaftë”, si “barrë”. Meshkujt me aftësi të kufizuara midis 25 dhe 40 vjeç kishte më shumë të ngjarë të përfaqësoheshin në krahasim me të tjerë persona me aftësi të kufizuara, pavarësisht faktit se numri i femrave me aftësi të kufizuara e tejkalon atë të meshkujve.

Disa forma të aftësisë së kufizuar kanë një përfaqësim veçanërisht të dobët. Sëmundjet mendore shumë shpesh (dhe në mënyrë disproporcionale) lidhen nëpër programe me krimet e dhunshme, edhe pse nuk ka prova për ta mbështetur këtë portretizim të gabuar.

Korporata e Transmetimeve Australiane u kërkon producentëve të saj ti bëjnë vetës katër pyetje për portretizimin e personave me aftësi të kufizuara në ekran:

- A e **patronalizon** portretizimi personin me aftësi të kufizuara?
- A e **viktimizon** portretizimi personin me aftësi të kufizuara?
- A e **demonizon** portretizimi personin me aftësi të kufizuara?

Ose, përkundrazi

- A e **normalizon** portretizimi personin me aftësi të kufizuara, pra, a e konsideron personin me aftësi të kufizuara në të njëjtën mënyrë si gjithë të tjerët?

Shumë reportazhe dhe seriale i përshkruajnë pjesëtarët e publikut si kontribues. Merr në konsideratë përfshirjen e më shumë personave me aftësi të kufizuara me qëllim që programi juaj të paraqesë një pasqyrë më të plotë të shoqërisë. Por për të bërë këtë, është shpesh e nevojshme të kërkes personat me aftësi të kufizuara. Mos harroni se meshkuj dhe femra, persona të racave, feve, sekseve të ndryshme, si edhe me orientime seksuale të ndryshme mund të jenë edhe ata persona me aftësi të kufizuara.

- Mos e egzagjeroni me kujdesin dhe mos u përpiqni të jeni shumë korrekt politikisht – duke qenë super sensitiv për përdorimin e gjuhës se duhur apo jo të duhur dhe përshkrimin e personave me aftësi të kufizuara, mund të mos arrini të bëni dot asgjë. Të gjitha imazhet mund të luajnë rol të rëndësishëm në rritjen e shikueshmërisë – edhe ato të quajtura negative.
- Konsideroni në skenar ato karakteristika të personave me aftësi të kufizuara që mund të jenë të zakonshme për personat pa aftësi të kufizuara. Për shembull, të shfaqësh një person me aftësi të kufizuara të pushohet nga puna për shkak të neglizhencës dhe jokompetencës mund të jetë një përshkrim pozitiv pikërisht pasi mund të sfidojë një arsye shpeshherë të cituar lidhur me punëdhënësit për të mos marrë në punë personat me aftësi të kufizuara – supozimin se nuk mund të pushosh një person me aftësi të kufizuara pa i hapur vetes telashe juridike për disriminim.
- Konsideroni personat me aftësi të kufizuara si persona kompleksë me cilësi të mira dhe të këqija. Duke shfaqur një person me aftësi të kufizuara si të lig apo të pakëndshëm mund të shkaktojë probleme, por mendoni se sa persona të “mire” kemi pa aftësi të kufizuara? Një person me aftësi të kufizuara mund të nxehet, të jetë i hidhur, herë-herë depres, por mund të jetë edhe i mençur, seksi dhe qendra e muhabetit. Ndoshta një nënë me aftësi të kufizuara nevrifikoset me të birin që nuk do të lajë dhëmbët, por kjo ka të bëjë me të qenit nënë, dhe jo me aftësinë e kufizuar. Përcaktimi i qartë i kontekstit të lejon ta bësh një gjë të tillë. Shpesh herë janë personat pa aftësi të kufizuara që janë më të ndjeshëm lidhur me këto çështje krahasuar me personat me aftësi të kufizuara.
- Rolet e vogla ofrojnë mundësi të mëdha për ti ndihmuar personat me aftësi të kufizuara të shkojnë në role më të mira. Mund t’iu duket se është e papërshtatshme ta kesh një personazh me aftësi të kufizuara në rolin kryesor, por mos e përjashtoni automatikisht një person me aftësi të kufizuara në një rol ku ata portretizohen si personazhe dytësore ose të parëndësishme. Kjo mund të jetë më e mirë se sa thjesht një rol “ekstra” dhe mund të japë mundësi që ta vendosë një person me aftësi të kufizuara në një situatë ose rol që nuk ka të bëjë me aftësinë e kufizuar. Ti vendosësh personat me aftësi të kufizuara në rolet e menaxherëve dhe kolegëve të punës, për shembull mund të tregojë përfshirje reale.
- Mos e mendoni aftësinë e kufizuar vetëm si karriker me rrota. Është më e thjeshtë pasi është më e dukshme dhe më e njohur si aftësi e kufizuar, por bëhet klishe. Më pak se 8% e personave me aftësi të kufizuara janë përdorues të karrikeve me rrota, pra merni në konsideratë të përshkruani një aftësi tjetër të kufizuar.
- Jeni i kujdesshëm kur përshkruani personat me aftësi të kufizuara në rolin e “viktimës”. Ndërkohë që është i vërtetë fakti se disa persona janë me aftësi të kufizuara për shkak të aksidenteve, akte terroriste apo lufta, ka shumë më shumë persona me aftësi të kufizuara të

cilët nuk e konsiderojnë veten aspak si viktime. Ata duan të gëzojnë të njëjtin respekt si gjithë të tjerët dhe jo të mëshirohen.

- Në mënyrë të ngjashme shmangni edhe ekstremin tjetër atë të “heroit” – që i përshkruan vazhdimisht personat me aftësi të kufizuara si njerëz që kanë bërë të paarrtshmen. Një sportist me aftësi të kufizuara që ka fituar një medalje nuk është më shumë përfaqësues i personave me aftësi të kufizuara sesa futbollisti David Beckham është për personat pa aftësi të kufizuara. Njerëzit e jashtëzakonshëm egzistojnë në të gjitha fushat e jetës, por arrijtjet heroike mund të mbulojnë realitetin e përditshëm për personat me aftësi të kufizuara, duke i dhënë mundësi shikuesit që ta shikojë këtë aritje si kompensim të aftësisë së kufizuar. Kjo krijon idenë se personi e ka “mposhtur” dëmtimin dhe se nuk ka më nevojë për interesim të mëtejshëm.
- Është gjithashtu patronizues fakti kur personat me aftësi të kufizuara konsiderohen si heronj pasi janë me aftësi të kufizuara, prandaj shmangni përcaktime për personat me aftësi të kufizuara si “heronj” që përballen me dëmtime të tyre.
- Mendoni se shfaqni ngjarje nga jeta e përditshme që përfshijnë persona me aftësi të kufizuara në vend të shfaqni situata që lidhen me aftësinë e kufizuar. Kjo gjë krijon një imazh më pozitiv integrimi duke i shfaqur personat me aftësi të kufizuara që ndërveprojnë me personat pa aftësi të kufizuara. Kur i shfaq personat me aftësi të kufizuara të izoluar në mjedisin e tyre të ngushtë mund të krijojnë përshtypjen se ata janë të veçuar nga pjesa tjetër e shoqërisë.
- Nuk ka pse të keni frikë të shfaqni personat me aftësi të kufizuara që i bëjnë gjërat ndryshe nga personat pa aftësi të kufizuara, por shfaqin personat me aftësi të kufizuara si të barabartë.

Konsultimi i organizatave të aftësisë së kufizuar

Kur kërkoni kontribues të programeve për aftësinë e kufizuar mund të vendosni të konsultoni një organizatë të specializuar të aftësisë së kufizuar për ndihmë. Konsultimi është i rëndësishëm, dhe gjithmonë është e këshillueshme që të kontaktoni me më shumë se një organizatë, nëse mundeni, për të patur një pamje sa më të gjerë. Gjatë viteve janë zhvilluar një sërë organizatash të ndryshme të aftësisë së kufizuar. Zakonisht ato specializohen në një dëmtim të caktuar dhe të ofrojnë këndvështrime të ndryshme. Këto organizata mund të përfshijnë ato të cilat japin mbështetje në formë bamirësie, këshillimi dhe informimi, dhe ato që janë të përfshira politikisht, dhe që llojnë për të ndryshuar gjendjen e status-kuosë. Ja vlen të përmendet se disa organizata që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara menazhohen nga persona pa aftësi të kufizuara, dhe jo gjithmonë mund të pasqyrojnë në mënyrë të saktë këndvështrimet e vetë personave me aftësi të kufizuara.

Kur konsultoheni me grupe të ndryshme, do të mund t’iu duhet të sqaroni disa nga mesazhet ose informacionet kontradiktore si edhe politika të brendshme ose të jashtme. Do të humbisni persona të rëndësishëm nëse, për ngjarje interesante dhe kënvështrime interesante punoni vetëm me organizatat më të mëdha dhe më të njohura, dhe nëse e kufizoni veten për të punuar vetëm nëpërmjet këtyre agjensive.

Disa grupe mund të jenë më të interesuara për promovimin e kauzës së tyre sesa të përshtaten me specifikat editoriale të programit tuaj. Që në fillim jeni i qartë me ta për atë që po përpiqeni të arrini. Përpiqui ti sillni organizatat në një fazë të herëshme, mbajini me vete dhe mos i harroni kur të transmetohet programi. Sigurohuni që e dinë ditën e transmetimit dhe sigurohu që të marësh opinionet e pjestarëve të tyre dhe përfituesve pas transmetimit të programit.

Respekt për dinjitetin njerëzor dhe trajtim të minoriteteve

Shikuesit kanë të drejtën të presin që transmetuesit dhe hartuesit e programit të reflektojnë përgjegjësinë e tyre për të mbrojtur dinjitetin njerëzor, sa më shumë që kjo të jetë e mundur, në respekt si të vetë individëve ashtu dhe të individëve si pjestarë të grupeve. Individët nuk duhet të merren nën mbrojtje ose të trajtohen si heronj pa qenë e nevojshme, apo tu shkaktohet stres i panevojshëm. Në mënyrë të veçantë duhet të vlerësohet trajtimi i

minoriteteve të pambrojtura, duke patur parasysh efektet e mundshme si mbi keqintepretimet ashtu dhe mospërfaqësimin në nivelin e duhur.

Humori

Humori është një fushë për të cilën është debatuar shumë, por mund të jetë shumë i fuqishëm për të normalizuar çështjet. Nëse më parë çdo humor që i referohej aftësisë së kufizuar mund të ketë shkaktuar fyerje ose tek personat me aftësi të kufizuara ose tek personat pa aftësi të kufizuara, tashmë ka më shumë humoristë që janë të gatshëm të shfritëzojnë në mënyrë aktive potencialin komik të personave me aftësi të kufizuara. Kjo është mundësuar nga rritja e numrit të humoristëve me aftësi të kufizuara që vetë ata kanë prezantuar pjesë të fuqishme që sfidojnë sjelljet tradicionale duke përdorur material satirik, të mrpehtë, dhe shpesh me qëllim edhe shokues. Ka një traditë të gjatë të humorit të bazuar tek shtypja dhe pabarazia. Duhet tu jepet mundësia personave me aftësi të kufizuara të përfshihen në programet e këtij lloji, veçanërisht kur humori do të thotë të qeshësh me njerëzit dhe jo ta tellesh me ta.

Komunikimi me Personat me Aftësi të Kufizuara

Aftësitë komunikuese janë thelbësore në zhvillimin e marrëdhënieve me audiencën e personave me dhe pa aftësi të kufizuara dhe me punonjësit.

Sjellja dhe llogjika na thonë:

- Tregohu i duruar dhe dëgjo me kujdes
- Përdor një ton zëri normal kur tregon gadishmëri
- Mos u përpiq të flasësh ose të përfundosh fjalinë për një person me të cilin po flet
- Asnjëherë mos pyesni “Çfarë të ka ndodhur? Frenoje kuriozitetin.
- Drejtojuni një personi me aftësi të kufizuara me emër vetëm nëse i drejtoheni edhe personave të tjerë me të njëjtin familiaritet.
- Flitini personit me aftësi të kufizuara drejtpërdrejt, edhe në ato raste kur ata shoqërohen nga përkthyesi apo shoqëruesi.
- Asnjëherë mos supozoni se çfarë mund apo nuk mund të bëjë dikush.

Njerëzit po bëhen gjithmonë e më shumë të ndjeshëm ndaj mënyrës së si “gjuha e aftësisë së kufizuar” mund të përforcojë në mënyrë të paqëllimshme stereotipet. Fjalë apo shprehje të caktuara mund të përbëjnë ofendim. Edhe pse nuk ka rregulla konkrete, është mirë të kuptohet se përse disa terma janë të preferueshme në krahasim me të tjera. Por preferencat janë të ndryshme, dhe në rast se dyshoni jeni të përgatitur ta pyesni individin.

Shumica e personave që e shohin aftësinë e kufizuar si çështje barazie preferojnë fuqishëm termin “persona me aftësi të kufizuara” pasi ajo pasqyron më mirë qëndrimin se personat me dëmtime ose kushte mjekësore të caktuara janë me aftësi të kufizuara për shkak se shoqëria nuk i heq pengesat e panevojshme. Disa persona me aftësi të kufizuara preferojnë termin “persona me aftësi të kufizuara” pasi termi person përdoret i pari. Të tjerë persona me aftësi të kufizuara mund të mos e shohin fare vetën si me aftësi të kufizuar, edhe pse mund të përkufizohen si të tillë nga ligji – përfshi këtu ata që nuk dëgjojnë që në lindje dhe që përdorin Gjuhën e Shenjave, ata me një situatë mjekësore afatgjatë, ose ata që kanë kaluar një sëmundje nervore.

Disa pika të përgjithshme:

- Personi me aftësi të kufizuara nuk përcaktohet nga dëmtimi i tij apo i saj. Askujt nuk i pëlqen ti vihet një emërtim mjekësor.
- Emërtimet mjekësore nuk thonë asgjë për personin; ata thjesht përforcojnë stereotipin se personat me aftësi të kufizuara janë “të sëmurë” dhe të varur nga mjeku.

- Përcaktime të tilla si “epileptik” apo “diabetik” janë depersonalizuuese. Nëse dëshironi ti referoheni gjëndjes së personit, thoni një person me epilepsi ose me diabet.
- Mos u vini në siklet nëse përdorni shprehje të tilla që mund të lidhen me dëmtimin e dikujt, për shembull, “Shihemi më vonë” ose “po të jap një dorë.”
- Shmangni përdorimin e gjuhës që sugjeron se personat me aftësi të kufizuara janë gjithmonë të dobët dhe të varur të tjerët, ose që mund ti kthejnë personat me aftësi të kufizuara në objekt për tu mëshiruar, si për shembull, “që vuan nga” apo “viktimë e.”
- Mos përdorni emra kolektivë të tillë si “invalidët”, “të verbrit” ose “të shpërfytyruarit”. Këto terma përfshijnë persona si pjesë e një grupi uniform që është disi i veçuar nga shoqëria.

Etiketimi i aftësisë së kufizuar

- Një rregull i përgjithshëm është që kurrë të mos supozosh se çfarë asistence, nëse është e nevojshme, i duhet një personi me aftësi të kufizuara. Pyesni nëse, dhe çfarë, asistence mund ti nevojitet.
- Trajtojeni një person me aftësi të kufizuara në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtin respekt që do të trajtonit çdo person tjetër.
- Trajtojini të rriturit si të rritur.
- Mos bëni supozime mbi egzistencën apo mungesën e aftësisë së kufizuar; shumë persona kanë aftësi të kufizuara të padukshme ose që bien në sy menjëherë.
- Përdorni kontakt fizik të përshtatshëm, si për shembull, shtrëngim dore, ashtu si do ta bënit me çdo njeri tjetër.
- Një person me aftësi të kufizuara mund të mos iu prezantojë me asistentin personal ose ndihmësin në komunikim (për shembull përkthyesin). Merrni vetë iniciativën për tu prezantuar me të.
- Qentë ndihmës (për personat me vështirësi dëgjimi ose shikimi, përdoruesin e karrikes me rrota, ose dikë me epilepsi) janë qen shoqëruar. Ata nuk duhet të trajtohen si kafshë të zakonshme shtëpiake. Megjithatë edhe ata kanë nevojë të pijnë ujë si edhe një vend për tualet.
- Mësoni se ku ndodhen tualetet, çezmat, dhe telefonat e aksesueshëm.

Kur takon persona që nuk shikojnë ose me dëmtime shikimi

- Identifikohuni qartësisht dhe prezantoni persona të tjerë që janë prezent. Tregoni qartë se ku ndodhen personat e tjerë. (Në situata pune është e rëndësishme që ta bëni këtë që në fillim të takimit.)
- Nëse flisni në grup është mirë që të identifikoni me emër personin të cilit po i flisni. Personat duhet të prezantojnë vetën përpara se të fillojnë të flasin.
- Kur të shtrëngoni dorën thoni “A mund ti shtrëngojmë duart?”
- Përpara se të ofroni asistencë, pyeteni individin se në ç’mënyrë mund ta ndihmoni. Nëse personi kërkon asistencë, pyeteni, “Do mbështeteni te krahu im? Në vend që ta kapni nga krahu pa e pyetur. Kjo të krijon mundësinë ta udhëhiqni dhe jo ta “shtyni”.
- Mbani mend se shumë persona me vështirësi në shikim shohin në një farë mase.
- Nëse jeni duke udhëzuar dikë, u thoni se ku ndodhen shkallët, platformat e pjerrëta ose pengesa të tjera të mundshme, dhe nëse janë në drejtimin për lart apo për poshtë.
- Kur udhëzoni dorën e personit të kurrizi apo mbështetësja anësore e karrikes i thoni atë që po bëni.
- Nëse e lini një person me vështirësi shikimi në një zonë që ai ose ajo nuk e njeh, informojeni personin se po largoheni dhe e lidhni me dikë tjetër.
- Kur hyni në një zonë të panjohur, jepni një përshkrim të shkurtër të vendit.
- Në ato raste kur shumëkush do të mbante shënim, pyesni nëse do të duan ta inçizojnë takimin ose bisedën.
- Siguroni komunikim të shkruar në format të aksesueshëm dhe, nëse është e mundur, në formatin e preferuar nga personi, në gërma të mëdha, në audiokasetë ose në Braille.

- Dokumentat e takimeve duhet të jenë dërguar që më përpara, përfshi edhe procesverbalet dhe dokumentat që do të vendosen në tavolinë. (këto mund të dërgohen me email nëse personi në fjalë është përdorues i kompjuterit të aksesueshëm ku mund të lexohen tekstet me zë apo të lidhur me printer në Braille).

Kur takon persona që nuk dëgjojnë ose me vështirësi dëgjimi

Egzistojnë nivele dhe lloje të ndryshme pamundësie për të dëgjuar dhe mënyra të ndryshme që personat që nuk dëgjojnë ose me vështirësi dëgjimi të komunikojnë. Disa persona që nuk dëgjojnë plotësisht (zakonisht që në lindje) përdorin Gjuhën e Shenjave si gjuhë të parë.

- Përpiquni të mos ndjeheni të sikletosur që po komunikoni me një person që nuk dëgjon ose që ka vështirësi në dëgjim, edhe pse komunikimi mund të jetë i vështirë në fillim.
- Nëse nuk e kuptoni atë që dikush iu tha, i klërkoni ta përsërisë fjalinë. Mos pretendoni se e keni kuptuar kur në të vërtetë nuk e keni kuptuar.
- E pyesi personin tu thotë se si preferon të komunikojë.
- Gjatë mbledhjeve e takimeve flisni me radhë. Kjo krijon mundësinë që të kryhet leximi i buzëve ose të kryhet përkthimi.
- Shënimet e shkruara mund t'iu ndihmojnë të paraqesni informacion të ndërlikuar.
- Sigurohuni që personi që nuk dëgjon t'iu shohë përpara se të filloni të flisni pasi ai ose ajo mund të ketë nevojë që t'iu lexojë buzët. Një prekje e lehtë mbi sup ose në krah mund t'iu tërheqë atyre vëmendjen.
- Përpiquni që zhurmat e mjedisit të jenë sa më të pakta
- Kontrolloni herë pas here nëse jeni kuptuar
- Përmbajuni programit
- Prenotoni që më përpara përkthyes ose persona ose pajisje ndihmëse
- Për intervista dhe takime përdor përkthyes të kualifikuar të gjuhës së shenjave.
- Nëse është prezent përkthyesi i gjuhës së shenjave, drejtojuni personit që nuk dëgjon dhe jo përkthyesit.
- Përdorni rrjetin special, që u lejon personave me vështirësi dëgjimi që të lidhen me pajisjet e tyre të dëgjimit drejtpërdrejt me folësit dhe të minimizohet zhurma e mjedisit.

Kur takon persona që lexojnë buzët

Shumë persona e përforcojnë atë që dëgjojnë duke lexuar buzët. Pak persona që nuk dëgjojnë plotësisht e përdorin këtë teknikë. Kjo është një teknikë e vështirë dhe e lodhshme.

- Shiko drjetpëdrejt personin me të cilin po flet
- Mos fol me kurriz nga një dritë e fortë pasi kjo mund ti vërë buzët në hije
- Sigurohuni që të jeni lidukshëm dhe i ndriçuar mirë kur flisni
- Flisni qartë dhe me një ritëm normal, por mos egzagjeroni me lëvizjen e buzëve
- Nëse duhet të ktheheni në drejtim tjetër duhet të ndaloni së foluri
- Mos përdorni gjeste të egzagjeruara
- Mos e bllokoni gojën me duar, cigare ose ushqim.

Kur takon persona që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë

Meqënëse kjo gjendje është kombinim i dëmtimeve në dëgjim dhe shikim, mbani mend këta persona nuk janë gjithmonë plotësisht shurdh apo të verbër. Në fakt, shumica e tyre shohin pak, dëgjojnë pak ose shohin dhe dëgjojnë pak. Këshilla që u dhanë në seksionet për personat që nuk shohin apo nuk dëgjojnë mund të jenë të vlefshme.

- Personi që nuk shikon dhe dëgjon mund të të flasë por nuk ta dëgjon zërin. Bëjani me dije personit që jeni aty. Afrojuni nga përpara dhe prekeni personin lehtë në krah apo në sup për ti tërhequr vëmendjen.
- Shumë persona që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë kanë nevojë për ti drejtuar. Këta persona mund të kenë preferencat e tyre personale mbi mënyrën se si duan të drejtohen. Disa persona që nuk dëgjojnë dhe shikojnë përjetojnë edhe mungesë drejtpeshimi të trupit.
- Një person që nuk shikon dhe nuk dëgjon mund të mbështetet nga një udhëzues ose interpret. Kujdesuni që ti flisni individit dhe jo asistentit.
- Mos e kapni ose “shtyni” personin. U bëni me dije se doni ti shoqëroni duke ua vendosur dorën në bërylin tuaj.

Kur takon persona me vështirësi në të folur

- Jeni të vëmendshëm, inkurajues dhe të duruar, por jo patronizues
- Ngadalësia apo vështirësia në të folur nuk pasqyron shkallën e intelektit të personit.
- Mos korrigjoni dhe mos flisni në emër të personit. Prisni me qetësi ndërsa personi flet dhe rezistoini tundimit për ti përfunduar fjalitë në vend të tij apo të saj.
- Nëse keni nevojë për më shumë informacion, ndajini pyetjet sipas pikave përbërëse që kërkojnë përgjigje të shkurtra.
- Nëse nuk e kuptoni se çfarë thotë dikush, i kërkonte personit ta thotë edhe një herë. Asnjëherë mos bëni sikur kuptoni ndërkohë që nuk keni kuptuar.

Kur takoni persona me dëmtime në lëvizje

- Mos u mbështesni mbi karriken me rrota. Karrikja me rrota është hapësira personale e përdoruesit të saj.
- Nëse flisni disi më gjatë me dikë që është përdorues i karrikes me rrota, përpuni të merrni një pozicion që të mund të jeni në të njëjtin nivel, ose kërkojini personit nëse ai/ajo dëshiron që ju të uleni.
- Keni kujdes me mënyrën se si përkulni gjunjët ose përkuleni për ti folur personit. Mos e ndryshoni mënyrën e trajtimit të personit. Trajtojini të rriturit si të tillë.
- Nëse ka një tavolinë apo banak të lartë, dilni përpara.
- Asnjëherë mos i prekeni apo lëvizni patericat, bastunin, ose shtyni karriken me rrota pa miratimin e përdoruesit.
- Ofroni ndënjëse sikur do ta bënit me këdo.
- Përdoruesit të karrikes me rrota flitini drejtpërdrejt, dhe jo nëpërmjet shoqëruesit.
- Nëse e dini se nuk është shumë e lehtë të lëvizësh lirisht nëpër godinë me karrike me rrota, ofroni ndihmë. Dyert e rënda ose tapetet e trashë janë disa nga gjërat që duhet të keni kujdes. Mos merrni me mend se platformat e pjerrëta mund të zgjidhin gjithçka; ato mund të jenë tepër të pjerrëta apo të rrëshqitshme.
- Mos ofroni të ndihmoni nëse oferta të refuzohet. Shumë përdorues të karrikeve me rrota dëshirojnë të shkojnë nga do në mënyrë të pavarur.

Kur takoni persona me vështirësi në të mësuar

Shumë persona të lindur me vështirësi në të mësuar, personat në fazat e hershme të demencës ose personat që kanë pësuar dëmtime në tru, jetojnë jetë të plotë dhe të pavarur në komunitet. Shumica miund të marrin vetë vendimet, me nivele të ndryshme mbështetje. Pikat në vijim mund të aplikohen për këta individë:

- Filloni duke menduar se personi do t'iu kuptojë
- Flisni me personin sikur ti flisni çdokujt. Mos u përpuni ta merrni me mend që në fillim se personi do t'iu kuptojë apo jo.
- Gjithë komunikimi duhet të jetë i thjeshtë. Shmangni përdorimin e zhargonit.

- Merni në konsideratë prezantimin e informacionit me shkrim, përfshi këtu emrin tuaj dhe numrin e telefonit.
- Ofroni përmbledhje të drejtpërdrejta të informacionit të shkruar.
- Mund ti ofroni personit një rregjistrim të bisedës (për shembull, një version elektronik, ose shënime “të lehta për tu lexuar”) të cilat personi mund ti konsultojë më vonë dhe ti mbajë si të dhëna.

Kur takon persona me probleme të shëndetit mendor

Dikujt që po përjeton shqetësime emocionale dhe konfuzion të shoqëruar me probleme të shëndetit mendor mund ti duken të vështira edhe aktivitetet e jetës së përditëshme. Shpeshherë aftësia e kufizuar që përjetojnë personat me probleme të shëndetit mendor krijohet për shkak të qëndrimit të të tjerëve.

- Ji i duruar dhe joparagjykses
- Jepini personit kohë që të marrë vendime
- Ofroni informacion të qartë me qëllim që personi të mbërijë në takim sa me më pak stres që të jetë e mundur.
- Largoni çdo burim stresi dhe konfuzioni, për shembull, zhurmat, blicet.
- Personi mund të ketë nevojë për advokues për ta ndihmuar me informacionin, ose që ti ndjekë takimet apo intervistat.

Kur takon persona me shpërfytyrim facial

Disa persona janë lindur me shpërfytyrime dhe të tjerë i fitojnë ato për shkak të aksidenteve apo sëmundjeve. Shpërfytyrimi përgjithësisht është vetëm në lëkurë, por mund të shoqërohet edhe me paraliza faciale ose dëmtime të tjera si për shembull vështirësi në të folur. Ashtu si me çdo lloj tjetër aftësie të kufizuar, ajo nuk do të thotë se personi është ndryshe dhe se kjo nuk ndikon mbi inteligjencën e tij/saj. Shumicën e vështirësive, dhe diskriminimin, personat me shpërfytyrim facial e marrin nga qëndrimi i të tjerëve.

- Vendosni kontakt me sy, ashtu siç do të bënit me çdo person tjetër. Mos e shikoni me ngulm. Buzëqeshini ashtu siç do të bënit me çdo person tjetër.
- Dëgjojeni me vëmendje, dhe mos lejoni që pamje e personit t’ua tërheqë vëmendjen.

Intervistat

- Kur përgatiteni të merrni në intervistë një person me aftësi të kufizuara, mund të duhet të adaptoni rregullimet e zakonshme. Mos e merni me mend se çfarë mund t’iu duhet. Pyeteni personin.
- Çdo kandidat duhet të pyetet nëse kanë kërkesa specifike në lidhje me intervistën.
- Edhe pse duhet të jesh i përgatitur për të bërë përshtatje, mos e merr me mend se çfarë mund apo nuk mund të bëjë personi. Personat me aftësi të kufizuara shpesh zhvillojnë zgjidhje kreative për vështirësi që hasin gjatë punës.
- Fokusohuni te detyra dhe kërkesat kryesore të punës dhe të aftësitë e personit.
- Mos u shpërqëndroni nga çështje që nuk lidhen me punën, si për shembull gjinia, mosha, aftësia e kufizuar ose prejardhja etnike.
- Kufizojni pyetjet mbi efektin e aftësisë së kufizuar të personit vetëm tek ato që ndikojnë potencialisht mbi aftësinë e tij apo të saj për ta kryer këtë punë.
- Mund të jetë, “Si mund t’iu ndihmojmë të jeni të suksesshëm në këtë punë?”
- Bëjini personit për jetën jashtë pune ashtu siç do t’ia bënit edhe çdo kandidati tjetër.
- Mos pyesni, “Çfarë të ka ndodhur?”

Masat për intervistat

Shembuj të masave që mund të merrni për një intervistë përfshijnë:

- Ndërimi i vendit në një mjedis intervistimi më të aksesueshëm për përdoruesien e karrikes me rota.
- Rregullimi i ndenjësive dhe ndriçimit me qëllim që një person që nuk dëgjon të mund ti lexojë buzët më lehtë.
- Gjetja e një personi që do t'iu ndihmojë të lehtësoni komunikimin, për shembull, interpret i gjuhës së shenjave.
- Ti jepni mundësi personit të sjellë një asistent ose shoqërues në intervistë. Ata mund të mos duan që ata të futen kështu që mund të nevojitet edhe një sallë pritjesh.

Takimet dhe aktivitetet

Kur planifikoni një takim apo aktivitet mbani mend se “akses” do të thotë lehtësi si edhe godinë. Kjo përfshin rrugët, hyrjet, dyshemetë, ashensorët, podiumet, gatimin dhe tualetet, si edhe mbështeten me interpretë dhe komunikim, shënimet në Braille ose në audiokaseta, programet me printim të madh si edhe pajisje ndihmëse si pajisjet e dëgjimit.

- Nëse mendoni se mund të ketë probleme me aksesin, ose paralajmëroni për problemin, ose më mirë, gjeni një mjedis më të përshtatshëm.
- Njoftoni se vendi është i aksesueshëm plotësisht, duke dhënë edhe detaje, ose personat me aftësi të kufizuara mund të mos vijnë.
- Sigurohuni që stafi pritës të jetë në dijeni se prisni persona me aftësi të kufizuara. U kërkoni atyre ta lexojnë këtë udhëzues dhe i sqaroni për çdo lloj kërkesash të veçanta.
- Sigurohuni se ka hapësirë të mjaftueshme për personat me dëmtime shikimi ose lëvizje që ata të lëvizin lirisht, si gjatë takimit ashtu edhe gjatë koktejlit.
- Sigurohuni që të jenë në dispozicion asistentë dhe disa ndenjësive dhe tavolina. Është e vështirë të bësh shenja me një gotë shampanje në dorë!
- Pakësoni ose eliminoni çdo zhurmë në mjedis.
- Ofrojeni përdoruesve të karrikeve me rota mbeështetëse për të shkruar.
- Sigurohuni që të merren masat e duhura për parkim. Siguroni që të ofroni udhëzime drejtimi dhe nëse është e nevojshme edhe persona për për të parkuar automjetet.
- Vendosni shenja të qarta për tualetet e aksesueshme dhe siguroni që stafi të dijë vendndodhjen e tyre.
- Stafi duhet të njohë planin e evakuimit, përfshirë pikat e strehimit dhe procedurat e evakuimit.
- Do të ishte shumë mirë që ndërtesa të ishte e pajisur me “alarm për personat që nuk dëgjojnë” (pra, vizual) alarm zjarri.

Intervista për personat me vështirësi shikimi dhe dëgjimi

- Personat e intervistuar me vështirësi shikimi: përpara intervistës vendosni me të intervistuarin se si ju apo i intervistuari do të përdorni gjuhën e trupit si çelës komunikimi. Në radio një dorë e vendosur në shpatull është një mënyrë efektive për të sinjalizuar nevojën për të mbaruar një përgjigje.
- Nëse po intervistoni një person me probleme dëgjimi, kuptoni paraprakisht se çfarë tipi komunikimi preferon ai (gjuha e shenjave), leximi i buzëve, e folura normale me ndihmën e një pajisje ndihmëse për dëgjim, etj)
- Nëse intervistoni një person me probleme dëgjimi përmes një interpreti të gjuhës së shenjave, flisni me personin si me këdo tjerër. Interpreti duhet të përdorë më pas gjuhën e shenjave për ti drejtuar pyetjen. Personi me probleme dëgjimi do t'iu përgjigjet drejpërsëdrejti

juve, dhe interpreti do të përdorë zërin në mënyrë simultane (pra siguroni që interpreti ka mikrofon).

- Nëse intervistoni një person me probleme dëgjimi, që lexon buzët, drejtojuni atij drejtpërsëdrejti, dhe ai do t'iu përgjigjet juve drejtpërsëdrejti. Fol në mënyrë të qartë dhe mos e largo shikimin prej tij. Është gjithashtu e rëndësishme që shpina juaj të mos jetë në drejtim të kundërt me dritën ose dritaren. Leximi i buzëve është i lodhshëm prandaj bëni pushime të herëpashershme nëse është e mundur.
- Nëse intervistoni një person, që përdor pajisje ndihmëse për dëgjim, ajo që e zgjidh situatën është sistemi i radios. Sistemet e radios janë gjithashtu të përshtatshme për personat me sistem dëgjimi të impjantuar. Sistemi i radios dërgon tinguj në një frekuencë të përcaktuar përmes një transmetuesi radio tek një antenë e veçantë të cilën përdoruesi e ka me vete, i cili është në gjëndje të dëgjojë zërin të tij/saj si edhe zërin e një personi tjetër.

Aktorët

Ka dy çështje kryesore që duhet të merren në konsideratë nga producentët e dramave. E para ka të bëjë me përdorimin e personave më aftësi të kufizuara për role që kanë aftësi të kufizuara sesa të përdoren aktorë pa aftësi të kufizuara. Regjisorët dhe producentët duhet gjithmonë të marrin në konsideratë aktorët me aftësi të kufizuara në radhë të parë për rolet e shkruara për persona me aftësi të kufizuara. (në fund të fundit nuk konsiderohet e pranueshme të përdoren aktorë “të lyer me bojë të zezë” për të luajtur personazhe me ngjyrë si për shembull Otellon e Shekspirin.). E thënë kështu aktori më i mirë duhet të fitojë edhe rolin.

Frances Higson, Producent, Antonine Films, UK

“Një nga personazhet kryesore në filmin tonë “jetimët” kishte paralizë cerebrale. Ne vendosëm të gjenim dikë në gjëndje për ta luajtur rolin sesa të kishim një aktore që të shtrej si e tillë.... Kontaktova me grupet e aftësisë së kufizuar dhe qendrat komunitare në të gjithë Skocinë.... Ishte një eksperiencë jashtëzakonisht e vlefshme dhe ajo që u pa në ekran ishte plotësisht e besueshme. Mendoj se nëse producentët kanë një personazh me aftësi të kufizuara ata duhet të shohin mundësinë për të punuar me një person me aftësi të kufizuara. Përfitimi padyshim që i justifikon vështirësitë.”

Çështja e dytë ka të bëjë me trupa aktorësh të integruar, që nënkupton përdorim i aktorëve me aftësi të kufizuara në role që nuk kanë lidhje me aftësinë e kufizuar. Në deklaratën e tij mbi nënpërfaqësimin e aktorëve me aftësi të kufizuara në industrinë e filmit advokuesit e barazisë (Bashkimi i aktorëve të MB) deklarojnë se përzgjedhja e aktorëve duhet të jetë në bazë të aftësive të tyre individuale si artistë dhe, pavarësisht nga aftësia e tyre e kufizuar. Ky këndvështrim, i cili është zbatuar gjithashtu për aktorët pavarësisht nga raca nuk ka marrë ndonjë vëmëndje të veçantë.

Asnjëra prej këtyre nuk është përgjegjësi e skenaristëve. Gjatë përcaktimit të aktorëve përse të mos merret parasysh se çdo rol duhet të luhet nga një person pa aftësi të kufizuara? Përse të mos mendohet dhënia e një roli personit me aftësi të kufizuara pa u shqetësuar për integrimin në skenar të aftësisë së kufizuar.

Rritja e shikueshmërisë

Në transmetime personat me aftësi të kufizuara zënë më pak se 1% të popullsisë që shfaqet në ekranin e televizionit. Në teatër, aktorët me aftësi të kufizuara (sidomos në interpretim të roleve të personazheve pa aftësi të kufizuara) janë shumë të rrallë. Spektakli edhe më pak, pavarësisht modës së televizionit “reality”.

Redaktorët dhe Producentët Komisionues kanë një rol të rëndësishëm në ndryshimin e tablosë dhe në gjetjen e talenteve me aftësi të kufizuara, në rastin e aktorëve profesionistë apo në rast të pjesëmarrësve në lojrat televizive apo intervistat e zakonshme.

Në Mbretërinë e Bashkuar janë kryer disa studime që tregojnë se publiku dëshiron të shohë më shumë persona me aftësi të kufizuara në ekran, dhe në një shumëllojshmëri rolesh, për shembull, lexues lajmesh. Ky seksion jep disa ide mbi mënyrën se si të arrihet kjo.

Çfarë mund të bëni....

- Mendoni për aftësinë e kufizuar më herët gjatë planifikimit të fushatës, me qëllim që ta integroni atë në mesazhin tuaj dhe jo të përqipeni më voni ti gjeni ndonjë vend diku.
- Përfshini imazhe të aftësisë së kufizuar si normë, në të njëjtën mënyrë si me gjininë dhe kombësinë.
- Nëse shqetësoheni se mos imazhi i aftësisë së kufizuar mund ta dëmtojë reklamën tuaj, mbani mend se në të vërtetë ai mund ta përforcojë mesazhin.
- Sigurohuni që t'ia bëni me dije kolegëve se si ti përfshijnë imazhet e aftësisë së kufizuar në propozimet e tyre marketuese dhe në mesazhet e fushatave.
- Mos kini frikë se mund të ofendoni dikë duke përdorur një imazh të aftësisë së kufizuar. Studimet tregojnë se njerëzve u pëlqen të shohin portretizimin e një personi me aftësi të kufizuar më shumë se sa të mos ketë asnjë të tillë.
- Mbani mend se shpeshherë barrierat krijohen nga qëndrimet ndaj personave me aftësi të kufizuara sesa vetë dëmtimi. Mendoni për mënyra që mund të promovoni të mirat e diversitetit social.
- Merrni mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara dhe të organizatave të tyre. Diskutoni çështjet dhe idetë krijuese më ta.
- Në fushatat tuaja përdorni aktorë me aftësi të kufizuara.

Falenderim për Imazhet Grupit Drejtues të Aftësisë së Kufizuar www.imagesofdisability.gov.uk

Programet speciale të aftësisë së kufizuar

Në shumë raste ekipet prodhuese i përfshijnë personat me aftësi të kufizuara kur realizojnë programe speciale për aftësinë e kufizuar. Ky mund të jetë një rast shumë i mirë për zhvillimin e personave me aftësi të kufizuara si realizues programesh. Programet speciale të aftësisë së kufizuar luajnë rol, për shembull, në mbajtjen e personave me aftësi të kufizuara të lidhur me botën që i rrethon. Të tilla programe informojnë (dhe argëtojnë) të tjerë dëgjues dhe shikues jo me aftësi të kufizuara. Një program radiofonik i BBC-së i titulluar "In touch", që i drejtohet audiencës me dëmtime shikimi, është tepër i ndjekur për shkak të mënyrës se si ngjarjet e përzgjedhura përmbushin funksionin e tyre. Në mënyrë të ngjashme, një dramatizim që u drejtohet personave që nuk dëgjojnë dhe ku çdo personazh përdor gjuhën e shenjave, mund të jetë shumë i parapëlqyer nga kjo audiencë.

Megjithatë, sa më e integruar që të bëhet aftësia e kufizuar në transmetimet e zakonshme, aq më saktësisht ajo e pasqyron shoqërinë tonë. Shumica e realizuesve të programeve me aftësi të kufizuara nuk do të dëshironin të kufizoheshin vetëm në realizimin e programeve speciale për aftësinë e kufizuar, por do ta mirëprisnin mundësinë të punonin edhe në zhanre të tjera. Sa më shumë persona me aftësi të kufizuara të punojnë në programet e rrymëzuara, aq më të mëdha do të jënë dhe mundësitë për portretizime të sakta.

Punësimi i personave me aftësi të kufizuara në prodhime programesh

Qëllimi i këtij seksioni të udhëzuesit

Qëllimi i këtij seksioni të udhëzuesit është tu ofrojë disa ide dhe këshilla praktike që të jeni më të suksesshëm në gjetjen dhe punën me personat me aftësi të kufizuara si kolegë, pra, si bashkëprodhues programesh. Ne dëshirojmë të nxisim pjesëmarrjen e sa më shumë personave me aftësi të kufizuara në këtë industri duke u ofruar vende pune dhe mundësi trainimi, duke përfshirë sa më shumë persona me aftësi të kufizuara në ekran dhe për të siguruar se procesi i marjes në punë që përdorim ne të mos jetë diskriminues kundër personave me aftësi të kufizuara.

Çfarë iu ndalon të punoni me personat me aftësi të kufizuara?

Personat me aftësi të kufizuara mund dhe punojnë në industrinë tonë. Ata janë po aq produktivë, të sigurt dhe të besueshëm sa të gjithë personat e tjerë. (Në fakt të dhënat nga një numër studimesh të kryera nga menaxherët nga një sërë biznese tregojnë se pjesëmarrja dhe cilësia në punë e personave me aftësi të kufizuara është e njëjtë, ose më e mirë se ajo e punonjësve të tjerë). Megjithatë, ka mjaft njerëz të mirë të cilëve nuk u është dhënë mundësia që ta tregojnë veten. Zgjidhja e problemeve është një nga përgjegjësitë kryesore në prodhimin e programeve. Si producentët dhe personat me aftësi të kufizuara janë mësuar tu gjejnë zgjidhje problemeve pavarësisht numrit të tyre, pra së bashku, me një frymë pozitive, mund të kapërcehet çdo vështirësi. Vëzhgimet në mënyrë të përsëritur tregojnë se organizatat që kanë marrë në punë persona me aftësi të kufizuara janë të gatshme të marrin dhe të tjerë.

Egzistojnë edhe konsideratat ligjore. Kur merrni në punë stafin duhet të siguroheni që procedurat tuaja të punësimit janë në përputhje me legjislacionin mbi mosdiskriminimin e aftësisë së kufizuar dhe se ju nuk po përjashtoni apo diskriminoni personat me aftësi të kufizuara.

Së fundi, nuk mund të ketë justifikim moral për përjashtimin e këtij grupi të madh dhe të rëndësishëm të popullsisë nga aksesimi në punë, portretizimi i tyre në ekran dhe në skenë. Në këtë drejtim aftësia e kufizuar nuk është e ndryshme nga gjinia ose raca. Duhet të jetë e mundur që personat me aftësi të kufizuara të punësohen në çdo aspekt dhe në çdo nivel të prodhimit të programeve në këtë industri, dhe të jenë plotësisht të integruar në të gjithë procesin e prodhimit. Transmetues si BBC tani punësojnë një numër të madh personash me aftësi të kufizuara në një shumëllojshmëri pozicionesh që lidhen me prodhimin ose edhe jo me prodhimin e programeve.

Kryeredaktorët dhe komisionerët e programeve janë referues parësorë të rëndësishëm në përmirësimin e përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara në ekran. Ata janë të vetmit që mund ti nxisin producentët që të përpiqen më shumë për të punësuar persona me aftësi të kufizuara si reporterë, prezentatorë, etj.

Ja vlen të pyesni vetën nëse po i mohoni vetes aksesin tek një rang i gjerë talentesh, idesh dhe përvojash.

Punësimi i stafit për prodhim programësh

Shumë vende pune në industrinë audiovizuale, veçanërisht ato në produksion, tani mbushen përmes rrjetit të njohurve. Për fat të keq kjo nuk nxit barazimin e mundësive dhe punësim të barabartë. E qartë, nëse kompania ose transmetuesi juaj për të cilin po punoni bëhet i njohur si miqësor ndaj aftësisë së kufizuar, kjo do t'iu ndihmojë të tërhiqni aplikantë, persona me aftësi të kufizuara.

Nëse jeni seriozë me punësimin e personave me aftësi të kufizuara që do të punojnë bashkë me personat pa aftësi të kufizuara, ka shumë gjëra që mund të bëni:

- Mos punësoni vetëm përmes njohjeve. Njihni efektet e tregut rastësor të punës dhe përhapni metodat që përdorni për të reklamuar vendet bosh. Mbështetuni më shumë tek reklamimet në median e rrymëzuar dhe bëjeni të qartë se ju nxisni aplikimet e personave me aftësi të kufizuara. Mund të përdorni gjithashtu median e shkruar të aftësisë së kufizuar nëse ajo ekziston tek ju.
- Rishikoni procedurat e punësimit për të siguruar që ata nuk diskriminojnë personat me aftësi të kufizuara. Në këtë seksion keni një udhëzues specifik për këtë.
- Kujdes me procedurat e punësimit përmes internetit, të cilat mund të përjashtojnë personat me aftësi të kufizuara nëse faqet në internet nuk janë të aksesueshme apo janë konceptuar keq.
- Realizoni studime me menaxherin tuaj të burimeve njerëzore për të kuptuar përse personat me aftësi të kufizuara mund të mos aplikojnë për punë dhe vlerësoni si mund të targetoni më mirë këta persona në njoftimet tuaja.

- Përcaktoni fokusin e punësimit (për shembull, të punësoni një prodhues filmi me aftësi të kufizuar deri vitin tjetër).
- Nxisni përmes njoftimeve në televizion dhe në radio dhe përmes internetit se ju synoni të keni aplikantë persona me aftësi të kufizuar dhe se ata janë të mirëpritur për të aplikuar.
- Ofroni formate aplikimi me modele alternative. Bëni të mundur që personat me aftësi të kufizuara të aplikojnë për punë duke bërë ndryshime të arsyeshme. Kjo në çdo rast është dhe kërkesë e legjislacionit evropian, por është gjithmonë e sigurt të punoni me praktikatat më të mira pavarësisht nga ligji.
- Nxisni të gjithë producentët të marrin në konsideratë personat me aftësi të kufizuara në stafet e tyre të prodhimit, jo vetëm ata që merren me programet për aftësinë e kufizuar. Kërkojuni producentëve të tjerë sugjerime, përfshirë ata që kanë përvojë në punën me aftësinë e kufizuar.
- Identifikoni organizatat që mund të jenë në gjendje t'u ndihmojnë në rritjen e kërkesave për punë nga personat me aftësi të kufizuara dhe dërgojuni detaje të vendeve të lira.
- Merrni mendimin e specialistëve për ti bërë mjediset tuaj më të aksesueshme. Nga kjo mund të përfitojnë të gjithë.
- Kërkoni talente mes personave me aftësi të kufizuara njësoj si edhe për personat pa aftësi të kufizuara. Filloni të mbledhni emra dhe që lidhen me ta dhe ndërtoni një databazë.
- Risni punësimin duke e ndihmuar një grup personash me aftësi të kufizuara në industrinë përmes skemave të trainimit, grumbullimit të përvojës me qëllim që të keni kandidatë të përshtatshëm që mund të merren në konsideratë.
- Garantoni një intervistë pune për të gjithë aplikantët me aftësi të kufizuara që plotësojnë kriteret minimale për këtë vend pune, dhe punësojini për shkak të meritës). Në disa vende egzistojnë kuota për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, dhe në këto raste, ligji duhet të zbatohet. Megjithatë, mbani mend se kuotat mund të kufizojnë mënyrën se si perceptohen personat me aftësi të kufizuara. Ato mund të përjashtojnë disa aftësi të kufizuara, dhe mundet gjithashtu të kontribuojnë në një shikim tashmë të dalë jashtë mode të aftësisë së kufizuar, si persona që kanë nevojë për bamirësi dhe mbrojtje. Personat me aftësi të kufizuara duan të punësohen për shkak të meritave dhe aftësive të tyre. Ata nuk kanë nevojë për trajtim të veçantë; ata kërkojnë trajtim të ndershëm dhe të barabartë.
- Përgatituni të bëni rregullime për të punësuarit e rinj nëse është e nevojshme. Kjo mund të jetë edhe diçka shumë e vogël (si për shembull, modifikim i vendit të punës ose mund të jeni fleksibilitet në orar, ose mund të jetë diçka edhe më e madhe (si për shembull, një pajisje e re e teknologjisë së informacionit, ose një punonjës nbështetës si për shembull, përkthyes i gjuhës me shenja). Një nga mënyrat më të mira për të mësuar se çfarë rregullimesh nevojiten (dhe shumë nga punonjësit me aftësi të kufizuara nuk kanë nevojë fare për asgjë të tillë), është thjesht ta PYESËSH punonjësën se çfarë mund ti nevojitet për ta bërë punën sa më mirë. (shih gjithashtu informacionin shtesë në seksionin Rregulime dhe Pajisje.)
- Bëni rregullime për të mbajtur edhe punonjës të vjetër të cilët mund të jenë bërë me aftësi të kufizuara. Mbajtja në punë e stafit të vlefshëm është tejet më efektive sesa marrja në punë dhe trainimi i stafit të ri.
- Konsultoni punonjës egzistues me aftësi të kufizuara herë pas here për të parë se si mund ti përmirësoni shërbimet për personat me aftësi të kufizuara – si shikues apo dëgjues, punonjës apo kontribues.
- Nisni ndërgjegjësimin dhe shtoni njohuritë mbi aftësinë e kufizuar në organizatën tuaj në çdo nivel.
- Kontrolloni progresin e arritur çdo vit dhe bëni plane për të ardhmen.

Pezantuesit

Aktualisht shumë pak persona me aftësi të kufizuara paraqesin programe që nuk lidhen me aftësinë e kufizuar. Ndërkohë që kualifikimet që i nevojiten një personi me aftësi të kufizuar për tu bërë prezantues janë të njëjta me ato që i nevojiten çdo personi tjetër – personalitet i fuqishëm, besim në vetvete dhe aftësi për të komunikuar me të ftuarit dhe audiencën.

Kjo industri ka bërë përparime të dukshme kur bëhet fjalë për femrat në ekran (dhe në disa vende evropiane) të personave me prejardhje etnike nga pakicat. Prandaj punësimi i një personi me aftësi të kufizuara të talentuar si drejtues programi apo reporter nuk do të jetë gjë e re- por do të ketë shumë vlerë në ndryshimin e qëndrimit ndaj aftësisë së kufizuar. Nuk është e vërtetë se personave me aftësi të kufizuar u mungon talenti, por është e vërtetë se producentët nuk u kanë dhënë atyre mundësinë për ta demonstruar këtë talent. Mos u shqetësoni nga aftësia e kufizuar – por përpiquni për cilësinë artistike të shfaqjes.

Mat Fraser, aktor dhe prezantues me aftësi të kufizuara në Mbretërinë e Bashkuar: “Përfshirja e një personi me aftësi të kufizuara në ekipin e prodhimit mund të zgjerojë fuqishëm bazën e përvojës së këtij ekipi. Kjo mund të japë producentit një këndvështrim të pa menduar më parë për një film ose serial. Nëse programi meret posaçërisht me aftësinë e kufizuar atëherë personi me aftësi të kufizuara që është edhe pjesëtar i ekipit është i paçmuar lidhur me kontaktet me komunitetin në fjalë dhe në të kuptuarit e këndvështrimeve si të kontribuesve dhe të publikut.”

Helen Smith, gazetare televizive, Mbretëria e Bashkuar: “Nuk dëgjoj nga njëri vesh që në moshën 6 vjeçare. Kam punuar si operatore dhe redaktore për dy vjet dhe tani jam producente dhe regjizore. Zbulova një sistem radioje të ri që më ndihmon të kaloj direkt nga tingulli dixhital stereo në mono; në këtë mënyrë mund ta lidh sistemin e zërit hi-fi drejtpërdrejt me pajisjen time të dëgjimit. “

Aksesi i Personave me Aftësi të Kufizuara tek Shërbimet e Transmetimit

Si transmetues ju duhet të vlerësoni se si personat me aftësi të kufizuara mund të aksesojnë të gjitha shërbimet tuaja, jo vetëm programet tuaja. Ka tashmë një numër transmetuesish që përdorin disa ose të gjitha mënyrat që vijojnë për të garantuar që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses të plotë në shërbimet e tyre:

Nëse përdorni voice-mail ose ndonjë sistem tjetër përgjigjeje automatike (të tilla si linja telefoni me folës që i kërkojnë përdoruesit të zgjedhë butona specifike për të marrë pjesë të ndryshme informacioni) ju duhet të ofroni një metodë alternative për personat me aftësi të kufizuara që nuk mund të përdorin këtë lloj sistemi.

Duhet të merrni në konsideratë ngritjen e një linje ndihmëse me ekip të trainuar mirë për t’iu përgjigjur telefonatave.

Sigurohuni që faqet tuaja në internet që kanë lidhje me programet të jenë tërësisht të aksesueshme dhe të plotësojnë standartet ndërkombëtare të aksesit.

Vlerësoni përdorimin e një adrese email për të marrë informacion nga klientët me aftësi të kufizuara.

Duhet të ofroni shërbimin tekst-telefon për ta bërë më të lehtë për personat që nuk dëgjojnë, kanë probleme dëgjimi dhe klientët me dëmtime në të folur për t’ju kontaktuar.

Krijoni një faqe të interesit tërësisht të aksesueshme me sub-titrimet e përditësuar, programe me përshkrime audio dhe vizuale, si dhe asistencë teknike për klientët që dëshirojnë të kenë akses tek sub-titrimi dhe përshkrimet audio në televizion.

Revistë në format audio për klientët me dëmtime shikimi.

Përgatisni letra dhe informacione në formate me gërmë të madhe.

Reklamoni dhe tregtoni tek personat me aftësi të kufizuara për tu siguruar që kanë akses tek shërbimet dhe publiciteti.

Sigurohuni që organizatave të aftësisë së kufizuar u janë dërguar informacione dhe materiale promovuese.

Organizoni disa udhëtime speciale ose shfaqje në rrugë për ti bërë publicitet shërbimeve tuaja të aksesit të aftësisë së kufizuar.

Programe mbështetëse

Dëgjuesit dhe shikuesit ftohen gjithnjë të telefonojnë për informacione të mëtejshme, këshilla etj. Ata shpesh rregjistrohen në faqet në internet që kanë lidhje me programe specifike. Transmetuesit duhet të garantojnë se të gjitha këto programe mbështetëse janë tërësisht të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Nëse po promovoni një numër telefoni, atëherë nënvizoni çdo numër faksi dhe telefoni për personat me vështirësi në komunikim, ose dëmtime sensoriale. Duhet të ofroni materiale mbështetëse në formate alternative (të tilla si kaseta audio, literaturë apo fletëpalosje elektronike ose me gërma të mëdha). Nuk duhet të ofroni saktësisht formatin e kërkuar. Për shembull, një dëgjues me dëmtime shikimi mund të kërkojë një informacion në Braille, por duke diskutuar dëgjuesi mund të jetë dakort që kaseta video mund të jetë alternativë e arsyeshme, ose një CD me informacion që ai e vendos në kompjuter, dhe që lexohet nga një lexues përmes një programi për të folurin.

Aksesi tek programet

Ndjekja e televizorit mund të jetë e vështirë për shumë shikues që kanë probleme me dëgjimin, ose për shikuesit që janë të verbër ose me probleme shikimi. Numri i personave me dëmtime shikimi ose dëgjimi rritet me rritjen e moshës, prandaj një përqindje e lartë e audiencës tënde mund të mirëpresë shërbimet shtesë, edhe nëse nuk e konsiderojnë veten persona me aftësi të kufizuara. Ka tre tipe të shërbimeve të aksesit që e bëjnë shikimin të mundshëm dhe të kënaqshëm. Ato janë:

- **Përshkrimi audio**
- **Shenjat**
- **Sub-titrimi**

Përshkrimi audio

Përshkrimi audio është një element shtesë që përshkruan pamjet vizive dhe veprimet, duke u dhënë mundësinë personave që nuk shikojnë të ndjekin artet vizive, TV, filmat, teatrin ose evenimente të ngjashme.

Përshkrimi audio jepet me kujdes përgjatë transmetimit në mënyrë që të mos interferojë me dialogun. Ai shtohet pas përgatitjes së filmit. Kjo është e thjeshtë në rastin e një DVD, por për videot duhet të prodhohet një video përshkruese e audios.

Edhe nëse ju nuk jeni përfshirë në përshkrimin audio të programit, mirë është të mendoni për pjestarët me probleme shikimi të audiencës suaj, gjatë përgatitjes së programit. Përpiquni të shmangni ose të minimizoni përdorimin e titujve në ekran pa u shoqëruar me zë, dhe kur është e mundur siguroni si sub-titrimin ashtu edhe zërin për kontribuesit e gjuhës së huaj.

Nëse nuk keni provuar kurrë përshkrimet audio, mund të tentoni në:

www.bbc.co.uk/ouch/closep/audiodescription_guideto.shtml

Shenjat

Shikuesit që nuk dëgjojnë ose që nuk dëgjojnë pjesërisht dhe ata që përdorin gjuhën e Shenjave për të komunikuar mund të aksesojnë disa programe TV në të cilat shfaqet (zakonisht në një kuti në ekran) interpreti i gjuhës së shenjave, i cili shpjegon ato që thuhet.

Sub-titrimi

Sub-titrimi është kur një tekst fjalësh shfaqet në ekranin e TV. Kjo përdoret zakonisht për prodhimet në gjuhë të huaj, por kur ofrohet për shikuesit me probleme dëgjimi, sub-tritmi mund të përfshijë gjithashtu përshkrimin e efekteve me tinguj ose detaje të vogla të muzikës.

Faqet në internet

Të gjitha faqet në internet duhet të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, por për fat të keq shumica e tyre nuk janë të tilla. Nuk është e drejtë që personat me aftësi të kufizuara e kanë të vështirë aksesin në internet. Përdoruesit e kompjuterit mund të përdorin Web browser sipas preferencës për madhësinë e tekstit, ngjyrës së ekranit dhe tipit të shkrimit. Për të qenë e përshtatshme për audiencën me aftësi të kufizuara, programuesit e faqeve në internet duhet të ndjekin parimet e dizajnit me printim të qartë dhe gjithashtu:

Të shmangin grafikat e ngarkuara, me ndriçim të bezdisshëm ose të lëvizshme.

Të ofrojnë variante për të parë versionin e paformatuar, vetëm tekst, në mënyrë që audienca të mund të përdorë një sintetizues zanor ose të printojë në Braille ose të riformatojë.

Të lehtësojë marrjen e reagimeve nga audienca duke ofruar lidhjen me email dhe duke nxitur komente mbi aksesueshmërinë.

Për Udhëzime mbi Aksesueshmërinë të “the World Wide Web Consortium” (Konsorciumi Botëror i Web) (W3C) shih www.cast.org

Për informacione të mëtejshme për prodhimin e informacioneve të tjera të aksesueshme përfshirë faqet në internet, Forumi i Punëdhënësve mbi Aftësinë e kufizuar publikon udhëzues të ndryshëm: www.employers-forum.co.uk

Shih gjithashtu PAS 78:2006 Udhëzues i praktikave të mira në komisionimin e websiteve të aksesueshme nga website i DRC: <http://www.drc.gov.uk>

Të sjellësh ndryshimin

Një tjetër mjet ndihmës i raportit “Ndal media e Shkruar! Si i portretizon Media e shkruar personat me aftësi të kufizuara” është guida se si ne si gazetarë, profesionistë të medias, qytetarë dhe advokues mund të bëjmë diçka për të ndryshuar portretizimin fytes ndaj personave me aftësi të kufizuara.

UDHËZUES I PRAKTIKAVE TË MIRA PËR GAZETARËT DHE REDAKTORËT:

10 sygjerimet e mëposhtme janë hapa praktike përmes të cilave redaktorët mund të përmirësojnë pasqyrimin e çështjeve të aftësisë së kufizuar;

- Kuptoni se personat me aftësi të kufizuara janë lexuesit tuaj. Një nga katër gazetatat tuaja përfundon në shtëpinë e një personi me aftësi të kufizuara.
- Përditësoni stilin e të shkruarit- duke shmangur fjalë tepër negative si “ person i panevojshëm”, “vuajtës”, “i pavlerë”. Rishikime periodike do të garantojnë saktësi në raportim.
- Analizoni kontekstin- a do të detajoni në të njëjtin kontekst etnicitetin apo gjininë e këtij personi? A është pjesë integrale e ngjarjes të flasësh për dëmtimet e personit?
- Jepini zëvendës-redaktorit tuaj një udhëzues praktikash të mira për të shkruar kryelajmin dhe titujt e fotove.
- Ndalo dhe mendo kur raporton ngjarje personale mbi aftësinë e kufizuar. A ndjeni negativitet?
- A janë të nevojshme aq shumë detaje mjeksore për lajmin? Nuk ka asgjë të keqe të flasësh për vështirësitë e një personi, por përpiqu të shmangësh sencacionin- pse të mos

përmendësh zgjidhjet ndaj dëmtimit se sa të përdorësh fjalë të tilla si “e pamundur”, “ i paaftë”, “varet nga të tjerët” etj.

- Tregohu i kujdesshëm dhe mos merr të mirëqënë se vlerësimi yt për dëmtimin e një personi është i drejtë. Pyet personin.
- Përfshi informacion të aksesueshëm për aftësinë e kufizuar në pjesët argëtuese, në elementë që kanë të bëjnë me udhëtimet apo ngrënie.
- Mos harro pas politikës personat me aftësi të kufizuara: thashethemet e politikës janë kryetituj të mire, por mos harro se si çdo ditë jeta e personave me aftësi të kufizuara mund të ndryshojë përmes politikës.
- Vlerëso ngjarjet mbi aftësinë e kufizuar- kujto se një ndër katër lexues ka interes personal në të.

UDHËZUES I PRAKTIKAVE TË MIRA PËR MEDIAN E SHKRUAR TË INDUSTRIJË

- Të ngrihen njësi trainuese mbi raportimin për aftësinë e kufizuar në kualifikimet industriale.
- Të ngrihet trainim i karrierës për stafin e reporterëve dhe bashkëpunëtorëve.
- Të ngrihet dhe përmirësohet trainimi i gazetarisë ‘fast-track’ për të diplomuarit persona me aftësi të kufizuara (të ngjashme me ato që kryeshin për grupet e minoriteteve në të shkuarën)
- Të trainohen redaktorët mbi çështje të punësimit të personave me aftësi të kufizuara duke i informuar ata për mbështetjen qeveritare që egziston dhe praktikat e mira të marrjes në punë.

UDHËZUES I PRAKTIKAVE TË MIRA PËR ZYRTARËT E MEDIAS SË SHKRUAR DHE PROFESIONISTËT E MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN

- Mbani parasysh këtë raport dhe përdorni të njëjtat udhëzime për gazetarët kur përgatisni kopje ose njoftime për shtyp.
- Gjithmonë synoni dhe përdorni citime nga personat me aftësi të kufizuara kur ata janë subjekte të punës suaj.

VËZHGIM

Ka disa rrugë përmes të cilave **ju** mund të ndihmoni në mënyrën se si media e shkruar pasqyron aftësinë e kufizuar dhe personat me aftësi të kufizuara. Mënyra e parë dhe më e thjeshtë është të shkruani një letër ankesë. Jo gjithmonë funksionon, por mund të habiteni se sa shpesh personat i përgjigjen kritikave konstruktive. Mund t’ t’u duhet të shkruani më shumë se një herë. Përfshini të tjerët nëse asgjë nuk ndryshon dhe filloni një fushatë lokale. Nëse asnjë prej këtyre nuk jep rezultat atëherë mund t’ia drejtoni ankesën tuaj Komisionit të Ankesave mbi Median e Shkruar.

Hapi 1

Nëse lexoni një shkrim që diskriminon personat me aftësi të kufizuara ahëre gjëja e parë që duhet të bëni është ti shkruani redaktorit përkatës. Në letrën tuaj shpjegoni përse mendoni se shkrimi ishte i papërshtatshëm dhe se çfarë mund të bëhet për të ndryshuar situatën. Përpikuni, nëse është e mundur, të sugjeroni një mënyrë alternative të trajtimit të çështjes specifike. Vendosni diku në letër ditën e publikimit të shkrimit. Nëse shkrimi përdor vazhdimisht një fjalë negative, të tillë si ‘handikap’ është e rëndësishme që ju ti jepni redaktorit alternativën pozitive. Ju mund ti dërgoni edhe një kopje të terminologjisë së përshtatshme.

Shënoni qartë në letrën tuaj “për publikim” dhe vendosni edhe adresën tuaj. Nëse nuk doni që adresa juaj të publikohet atëherë shkruani në krah të saj (‘Mos publiko adresën’). Shumë gazeta nuk i publikojnë letrat anonime, por të gjitha do të respektojnë të drejtën tënde për të mos e publikuar adresën. Fotokopjoni letrën përpara se ta nisni në mënyrë që ta keni si referencë. Mund ta gjeni adresën e redaktorit që do ti shkruani diku në gazetë. Vendi më i mirë për ta gjetur është rubrika e letrave në gazetë. Kjo është zakonisht në qendër të gazetës.

Mos harroni kur i shkruani redaktorit:

1. Shkruani sa më shkurt që të jetë e mundur
2. Shkruajeni letrën sa më shpejt që të mundeni
3. Përpquni të jeni pozitiv për disa aspekte të gazetës
4. Nëse letra juaj nuk publikohet, shkruajini sërish dhe i kërkoni përgjigje

Shembulli 1

The Westchester Chronicle ka një ngjarje mbi një shfaqje të re të shoqërisë amatore të qytetit. Një nga aktorët e shfaqjes, Z. T. Jones, është një person me aftësi të kufizuara në të mësuar të cilit gazeta i referohet si “handikap mendor”. Ata japin citime nga prestatet e trupës mbi lojën në skenë bashkë me një person me aftësi të kufizuara, por nuk citojnë asgjë nga z. Jones.

Letra juaj mund të jetë:

I dashur redaktor,
Edhe pse isha i interesuar të lexoja lajmin mbi shfaqjen e re të Shoqërisë Amatore të Dramës së Westchester (publikuar më 11/4/1999) u zhgënjeva që asnjë citim për z. Jones nuk ishte përfshirë në të, ndërkohë që z. Jones ishte një nga aktorët kryesorë të shfaqjes. Jam i sigurt që lexuesit tuaj do të ishin po aq të interesuar për eksperiencën e tij sa edhe të aktorëve te tjerë.
Ju gjithashtu ju referuat z. Jones si një: “handikap mendor” një termn që shumë perosna me aftësi të kufizuara e konsiderojnë fyes. Një shprehje më e përshtatëshme mund të kishte qenë “perosn me aftësi të kufizua në të mësuar”. Mirëpres përgjigjen tuaj pozitive ndaj kësaj kritike konstruktive.
Me besim tek ju

Shembulli 2

Ekipi britanik paralimpik mori më shumë medalje se sa ekipi olimpik i perosnave pa aftësi të kufizua, megjithatë gazeta juaj kombëtare, Daily Planet, nuk e pasqyroi këtë arritje.

Letra juaj mund të ishte:

I dashur redaktor,
Mbeta i habitur që Daily Planet nuk përmendi arritjen fantastike të ekipit olimpik (paralimpik) britanik. Javën e kaluar ata fituan më shumë medalje të arta se sa janë fituar medalje ndonjëherë nga ekipi pa aftësi të kufizuara. Si një gazetë shumë e repektuar për pasqyrimin e gjerë sportiv, mendoj se ishte turp që ju nuk gjetët hapësirë të pasqyroni suksesin e këtij ekipi britanik.

Unë shpresoj gjithashtu që shembulli i dhënë nga këta atletë mund t’ju nxiste të rivlerësonit pasqyrimin e personave dhe sportistët me aftësi të kufizuara.

I juaji sinqerisht,

Hapi 2

Letra juaj mund të publikohet dhe redaktori mund të marrë në konsideratë ndryshimin e mënyrës se si pasqyrohen çështjet e personave me aftësi të kufizuara. Ai ose ajo mund t’ju pyesë nëse ju dëshironi të kontribuoni për gazetën në të ardhmen.

Hapi 3

Padyshim që redaktori nuk do t’ju kushtojë vëmendje. Nëse kjo ndodh atëherë ju mund të përpqeni të organizoni një fushatë lokale. Kjo nuk ka për të qenë shumë e komplikuar. Nëse ju i përkisni një grupi personash, të tillë si një grup i kishës, ose sindikatë, atëherë mund tu kërkosh atyre ti shkruajnë redaktorit për

të mbështetur ankesën tënde. Sa më shumë njerëz të keni aq më mirë është. Përpiqu që personalitete të tilla si deputetë, ose kryetarë bashkie do ti bashkohen fushatës suaj.

Hapi 4

Hapin tjetër, nëse nuk jeni i suksesshëm, mund të merrni në konsideratë ti kërkoni grupit të bojkotojë dokumentin. Sërish nxitni këdo ti shkruajë redaktorit, këtë herë kontaktoni gjithashtu ata të cilëve u përket dokumenti duke u treguar atyre përse po e bëni këtë.

Hapi 5

Deri tani mund të kesh qenë i suksesshëm, por nëse nuk e ke arritur ka edhe një opsion të fundit. Mund të ankohesh tek Komisioni i Ankesave të Medias së Shkruar³⁶.

Burime të vlefshme mbi median dhe aftësinë e kufizuar:

[http://www.media-diversity.org/downloaded%20articles/Greater%20London%20Action%20on%20Disability%20\(GLAD\).htm](http://www.media-diversity.org/downloaded%20articles/Greater%20London%20Action%20on%20Disability%20(GLAD).htm)

http://www.media-diversity.org/articles_publications/Tips%20for%20Journalist_Interviewing%20People%20with%20Disabilities.htm

<http://www.mediaanddisability.org/guide.htm>

³⁶ Ky udhëzim vjen nga: Cooke, Caroline, Daone, Liz, Morris, Gwilym, "Stop Press! How the Press Portrays Disabled People" (Scope: London) 2000: 35-41.

SHTOJCA II: KLIMA E PËRGJITHSHME NË MEDIA NË VENDET E STUDIUARA

Klima e medias në Bosnje Hercegovinë

Bosnjë-Hercegovina ende mbetet një vend specifik me nivele të shumta të qeverisjes që është i vështirë për tu krahasuar me vendet e tjera jo vetëm në fushën e medias, por edhe në përgjithësi. Për shkak të presionit të madh nga zyra e Përfaqësuesit të Lartë, ka një numër ligjesh që rregullojnë aktivitetin e medias që në letër duken të mira por në praktikë nuk zbatohen gjithnjë. B-H ishte një nga vendet e para në rajon që miratoi një ligj për fyerjen që lejon rastet civile të përfundojnë në gjykatë. Megjithatë, për gazetarët fyerja dhe etiketimi nuk quhen krime, por ligji parashikon gjoba të rënda.³⁷ Interpretimi i ligjit megjithatë ka qenë kontradiktor veçanërisht për median e shkruar. Media e shkruar në

B-H është e vetërregullueshme ndërsa media elektronike është nën kontrollit e Agjencisë Rregullatore të Komunikimit. Si vetërregullim nuk ka funksionuar mirë në këtë vend, media e shkruar është lënë të bëjë çka dashur dhe shembujt më tipikë të sjelljeve të papërgjegjshme të saj janë të zgjedhjeve të tetorit 2002 kur një gjuhë gjithë urrejtje u shfaq në median e shkruar në të gjithë vendin. Akti i Lirisë së Informimit u miratua në 2004 por zbatimi i aktit ka mbetur në vend. B-H, megjithatë është i pari vend në rajon që ka ngritur një Këshill të Medias së Shkruar dhe neni 4, mbi diskriminimin në Këshillin e Media së Shkruar thotë se: 'gazetat dhe periodikët duhet të shmangin referencat paragjyquese ose fyese ndaj grupit etnik, kombësisë, racës, fesë, gjinisë, orientimit seksual, ose sëmundjes fizike ose mendore, ose aftësisë së kufizuar të një personi. Referencat ndaj grupit etnik, kombësisë, racës, fesë, gjinisë, orientimit seksual, ose sëmundjes fizike ose mendore, ose aftësisë së kufizuar të një personi, duhet të behën vetëm kur ka lidhje të drejtpërdrejtë me veprimtarinë që raportohet³⁸.

Në drejtim të promovimit të lirisë së fjalës, rolin më të madh në këtë fushë e ka Komiteti i Helsinkit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Bosnje-Hercegovina është unike në rajon pasi ka dy Komitete Helsinki, njëra me seli në Sarajevë dhe tjetra në Bijeljina. Puna e disa organizatave të tjera në këtë fushë është gjithashtu e rëndësishme, të tillë si Transparencë Internacional në B-H, instituti Media Plan, qendra e Medias në Sarajevë, Qendra për Akses të lirë tek informacioni, Fondi i Shoqërisë së Hapur B-H³⁹.

Ka 7 gazeta të përditshme dhe të paktën 5 revista të rëndësishme të përjavshme dhe një herë në dy javë në B-H. Tirazhi për të gjitha gazetat e përditshme vlerësohet të jetë rreth 80,000 kopje të shituar në ditë për një popullsi prej 3.8 milion njerëz. Arsyeja e një tirazhi kaq të ulët shiqtësh janë aftësia e ulët blerëse si dhe konkurrenca e fortë nga fqinjët, Serbi dhe Kroaci, të cilat bashkë shpërndajnë 13 gazeta të përditshme në B-H. "Pellg i vogël me shumë krokodilë brenda" mund të jetë përshkrimi më i mirë i tregut të medias së shkruar në Bosnje sipas specialistëve të Treguesit të Medias dhe Qëndrueshmërisë (MSI) të IREX për B-H në 2006/2007. Bashkë me dy të përditshmet kryesore, konkurrenca fuqizohet nga gazetat e vendeve fqinje Serbi dhe Kroaci. Janë 13 gazeta të përditshme nga këto vende dhe më shumë se 60 revista javore dhe mujore që qarkullojnë në Bosnje. Sipas Treguesit të Medias dhe Qëndrueshmërisë (MSI) të IREX për B-H në 2006/2007, aspekti më dekurajues i industrisë së medias ishte tregu i pazhvilluar për shkak të fuqisë së kufizuar blerëse të popullsisë, fragmentarizmit mes linjave etnike dhe numrit të madh të mediave që konkurrojnë në një treg të kufizuar⁴⁰. Megjithatë, specialistët janë dakord se progres i ndjeshëm është arritur në drejtim të profesionalizmit gazetaresk kryesisht për shkak të pagave të dhëna më rregullisht. Së fundi, specialistët arrijnë në konkluzionin se numri i madh i mediave nuk reflekton shumëllojshmërinë e zërave dhe opinionëve. Në fakt, ata vënë në dukje se ka një pasqyrim të kufizuar të grupeve të ndryshme të minoriteteve në Bosnjë-Hercegovinë.

³⁷ Njeri u miratua në Republika Srpska në 2001 dhe një në Federatë në 2002.

³⁸ ANEM legal department and Zivkovic and Samardzic Law Office, ANEM and IREX "Overview of Media Regulations in South East Europe from 2003-2005 (Media Plan Institute: Sarajevo, 2005): 14.

³⁹ Ibid: http://www.irex.org/programs/MSI_EUR/2006/bh.asp

⁴⁰ IREX, Media and Sustainability Index for Bosnia, 2006/2007: http://www.irex.org/programs/MSI_EUR/2006/bh.asp

Klima e medias në Serbi

Sipas Indeksit të Medias dhe Qëndrueshmërisë (MSI) IREX të Serbisë për 2006/2007 të realizuar nga specialistët nga disa organizata të mediave lokale, specialistët ndjejnë se ka shumë punë për tu bërë derisa një spektër i gjerë i interesave sociale të reflektohet në median e shkruar. Në përgjithësi, rregullat mediatike në Serbi janë koherente me standardet evropiane por nuk zbatohen në praktikë. Në 2006, specialistët konstatuan një rritje të presionit mbi pavarësinë e medias dhe profesionalizmit për shkak të ndikimit të fortë nga koalicioni qeverisës. Klima e medias ndikohet nga presioni i fortë politik që ndikon mbi lirinë e fjalës si dhe licencimin e transmetimit. Në drejtim të gazetarisë specialistët janë dakord se raportimi përgjithësisht nuk është i drejtë ose objektiv dhe në se në një numër mediash ka shumë raste të sjelljeve jo etike. Së fundi, specialistët arrijnë në përfundimin se shteti dhe media publike nuk reflektojnë spektrin e gjerë politik dhe se shpesh nuk reflektojnë interesat publike të grupeve të minoritetit dhe shoqërisë civile. Në fakt, specialistët nxjerrin në pah se ka ligje të mira mbi pasqyrimin e çështjeve të minoritetit por ato zbatohen rrallë. Ata sugjerojnë se problemi qëndron tek fakti që media dhe qeveria kanë pak interes tek problemet e minoritetit dhe për rrjedhojë ato pasqyrohen pak⁴¹.

Në drejtim të legjislacionit, etiketimi dhe fyerja nuk janë më krime, por si edhe në Bosnje dhe Mal të Zi, gazetarët janë subjekte të gjobave të rënda. Në 2004 Parlamenti Serb miratoi ligjin Aksesi i Lirë tek Informacioni me Rendësi Publike që u jep si gazetarëve ashtu edhe publikut akses tek informacioni nga njësitë shtetërore përmes zyrtarëve të informacionit. Një udhëzues u përgatit nga një staf ekspertësh të përbërë nga 10 organizatat joqeveritare më me ndikim në Serbi me synimin për ta bërë zbatimin e tij më të efektshëm⁴². Në ligjin mbi Aksesin e Lirë tek Informacioni me Rendësi Publike neni 5 thotë se shteti së bashku me njësitë autonome dhe vetëqeverisjen lokale janë të detyruara të ofrojnë pjesë të burimeve ose kushtet për të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të pasur akses tek informacioni publik përfshirë të drejtën për të marrë ide, informacione dhe opinione. Sipas këtij ligji, personat që nuk janë prezantuar me korrektesë në media kanë të drejtën një hartojnë një ankesë drejtuar redaktorit përgjegjës për keqinterpretimin dhe mund të depozitojnë një ankesë ndaj medias nëse problemi nuk është zgjidhur. Në ligjin mbi informimin publik, neni 47 garantohet se personi të cilit mund ti preket interesi apo e drejta për shkak të transmetimit të ndonjë informacioni, ka të drejtën ti kërkojë redaktorit përgjigje në të cilin duhet ti shpjegohet se informacioni që u transmetua është jo i plotë ose i pasaktë. Nëse redaktori përgjegjës e nuk publikon përgjigjen, për arsye objektive, ose nëse përgjigja nuk njoftohet në mënyrë të papërshtatshme, personi mund të kërkojë ndëshkimin e medias në gjykatë⁴³.

Në ligjin mbi Radion dhe Televizionin, neni 78 i detyron të gjithë transmetuesit radiofonikë publikë që të prodhojnë programe kushtuar të gjithë sektorëve të shoqërisë duke marrë në konsideratë grupe të veçanta të shoqërisë si për shembull fëmijët dhe të rinjtë, minoritetet dhe grupet etnike, personat me aftësi të kufizuara, personat pa përkrahje dhe shurdh-memecët (me detyrim transmetimin e teksteve paralele të shkruara që përshkruajnë segmentet audio të veprimit dhe të dialogut). Ky nen garanton gjithashtu që shërbimet transmetuese publike duhet të sigurojnë një kohë të përshtatshme për transmetimin e informacionit që lidhet me aktivitetet dhe punën e kryer nga shoqëria civile si edhe nga ana e komuniteteve fetare.⁴⁴

Klima mediatike në Malin e Zi

Mali i Zi në vitin 2006 u bë shtet i pavarur pas një referendumi që fitoi në favor të pavarësisë. Ashtu siç pritej kjo çështje morri vëmendjen maksimale të medias por atmosfera politike në shtetin e ri u ftoh pas pavarësisë dhe media iu kthye pasqyrimin të çështjeve që i takonin zhvillimit demokratik dhe ekonomik të vendit. Sipas IREX Indeksi për Qëndrueshmërinë e Medias (MSI) për vitet 2006/2007 për Malin e Zi, penalistët kanë vlerësuar se legjislacioni mbi median është në përputhje me standardet evropiane por problemi qëndron te zbatimi i tij. Ashtu siç vuri re edhe Asistenti për Informacionin pranë Ambasadës amerikane në raportin e IREX, rastet e pazgjidhura të sulmeve mbi gazetarët "hedhin hije mbi mjedisin mediatik në Malin e Zi.....Është e qartë se liria e fjalës nuk mbrohet sa duhet, dhe kemi ende shumë punë për të bërë." Penalistët e MSI vunë re se trupat gjykues reagojnë mjaft butë ndaj sanksionimit të gjuhës së urrejtjes në shtypin e shkruar. Megjithatë, penalistët ishin të kënaqur me miratimin e Aktit të Lirisë së Informimit në vitin 2005 që përbënte një progres të përgjithshëm në drejtim të një ligji mbi median në linjë me

⁴¹ IREX, Media and Sustainability Index (MSI) Serbia 2006/2007, http://www.irex.org/programs/MSI_EUR/2006/serbia.asp

⁴² ANEM legal department and Zivkovic and Samardzic Law Office, ANEM and IREX "Overview of Media Regulations in South East Europe from 2003-2005 (Media Plan Institute: Sarajevo, 2005): 70.

⁴³ "Official Gazette of the Republic of Serbia", no. 43/03, 61/05

⁴⁴ "Official Gazette of the Republic of Serbia", no. 42/02, 97/04, 76/05

standardet evropiane por vunë re se zbatueshmëria e këtyre ligjeve është thelbësore për lirinë e fjalës për një gazetari të përgjegjshme.

Penalistët ishin dakord se ndërsa gazetaria nuk ka arritur ende nivelin e dëshiruar të profesionalizmit në përputhje me Kodin e Etikës, mësohet se ekziston një tendencë në rritje për respektimin e rregullave. Për sa u përket marrëdhënieve midis organizatave joqeveritare (OJQ-ve) dhe sektorit të medias, mendimi i përgjithshëm i penalistëve ishte se ekziston komunikim cilësor midis të dy palëve dhe se media është e gatshme të pasqyrojë veprimtarinë e OJQ-ve që janë me rëndësi për publikun e gjerë. Megjithatë, Dino Ramović, kryeredaktor i televizionit shqiptar, TV Teuta në Ulqin, shpjegon se shteti nuk po e siguron mbështetjen e duhur financiare për programet e pakicave. Ai shpjegon se, "Mediat private që nxisin interesin publik në fushën e të drejtave të minoriteteve nuk e gëzojnë mbështetjen për projektet e tyre mediatike. Kjo flet për boshllëqet në fushën ligjore kur bëhet fjalë për trajtimin nga ana e medias të minoriteteve në Malin e Zi. Për më tepër, mediat private janë në një pozitë më pak të favorshme, krahasuar me shërbimet publike lokale."⁴⁵

Në vitin 2002 u miratuan nga Parlamenti tre ligje rregullatorë për median që përfshijnë: Ligjin mbi Median, Ligjin mbi Transmetimet dhe Ligji mbi Transformimin e Televizionit Shtetëror në Televizion Publik, që u përgatitën me asistencën e OSBE-së. Aktet mbi shpifjen dhe mashtrimin ishin nuk përbënin më krim sipas edhe standardeve të Bashkimit Evropian por gazetarët përsëri mund të përballen me gjopa të rënda. Sipas raportit të ANEM, në vitin 2005 u regjistruan 13 raste akuzash kundër gazetarëve dhe të gjitha këto raste i takonin medias së shkruar. Akti i Lirisë së informimit u hartua që në vitin 2004 nga një grup pune i përbërë nga aktorë të ndryshëm, por iu propozua Ministrisë së Kulturës e cila e ndryshoi draftin duke përjashtuar në të masat kyçe që kishin të bënin me sigurimin e mbrojtjes së abuzimit me shtypin e lirë.⁴⁶

Në Ligjin për Median, neni 3 përcakton detyrimin që ka shteti për të siguruar pjesë të mjeteve financiare me qëllim që të gjithë qytetarët të gëzojnë të drejtën për informim pa u diskriminuar, gjë që garantohet nga Kushtetuta. Ligji përcakton se shteti duhet të sigurojë mjetet për programet që kontribuojnë në zhvillimin e shkencës dhe arsimit dhe që promovojnë kulturën dhe që sigurojnë informacion për personat me dëmtime shikimi dhe dëgjimi. Kur flitet për të drejtën e personit për të paraqitur ankesë kundër shtrembërimeve nga ana e medias, neni 26 i këtij ligji garanton të drejtën e çdo individi ose entiteti ligjor të kërkojë korrigjimin e informacionit nga ana e medias nëse është dhunuar e drejta e tyre kushtetuese ose ligjore. Nëse media nuk jep përgjigje në kohën e përcaktuar, domethënë 30 ditë, pala e dhunuar ka të drejtë ta paraqesë çështjen në gjyq.⁴⁷

Ligji mbi Radio Difuzionin, i ngjashëm me Ligjin serb, rregullon detyrimet e transmetuesve radiofonikë publikë për të prodhuar dhe transmetuar programe që u drejtohen të gjitha segmenteve të shoqërisë pa shkaktuar diskriminim veçanërisht duke marrë në konsideratë grupe specifike shoqërore si fëmijët dhe të rinjtë, minoritetet dhe grupet etnike, personat me aftësi të kufizuara, të pambrojturit dhe personat shurdh-memec (me detyrimin që të transmetohen tekste të shkruara paralelisht që përshkruajnë audio segmente të veprimit apo dialogut.)⁴⁸ Neni 100, në përputhje me nenin 3 të Ligjit mbi Median në Malin e Zi, thotë se buxhetet e autoriteteve republikane apo lokale sigurojnë pjesë të mjeteve financiare për sigurimin e të drejtës kushtetuese të qytetarëve për informim pa u diskriminuar, veçanërisht për programe që janë me rëndësi të madhe për zhvillimin e shkencës dhe arsimit si edhe ato që promovojnë kulturën dhe sigurojnë informacion për personat me dëmtime shikimi dhe dëgjimi. Kushtet për sigurimin mjeteve financiare për programe të tilla nuk duhet të ndikojnë mbi pavarësinë editoriale dhe në pavarësinë e shërbimeve transmetuese publike.⁴⁹

⁴⁵ IREX, Media and Sustainability Index (MSI) Montenegro 2006/2007: http://www.irex.org/programs/MSI_EUR/2006/montenegro.asp

⁴⁶ ANEM legal department and Zivkovic and Samardzic Law Office, ANEM and IREX "Overview of Media Regulations in South East Europe from 2003-2005 (Media Plan Institute: Sarajevo, 2005): 55.

⁴⁷ Ligji mbi median ("Gazeta Zyrtare e republikës së Malit të Zi", nr. 51/02)

⁴⁸ Neni 95 i Ligjit mbi Radio Difuzionin ("Gazeta Zyrtare e republikës së Malit të Zi", nr. 51/02)

⁴⁹ Neni 100 i Ligjit mbi Radio Difuzionin ("Gazeta Zyrtare e republikës së Malit të Zi", nr. 51/02)